

Enti Rregullator i Ujit



RAPORTI VJETOR

2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

RAPORTI VJETOR 2023

VEPRIMTARIA E ENTIT RREGULLATOR
TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
DHE
GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS KANALIZIME

Shkurt, 2024

PËRMBAJTJA

Shkurtime	3
Parathënie	4
Përmbledhje	7
1 Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit	14
1.1 Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë.....	14
1.2 Detyrime ndaj Rekomandimeve të “Progres-Raportit të BE-së për Shqipërinë”	14
1.3 Struktura Organizative e ERRU-së	15
1.4 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese	16
1.4.1 Licencimi i Operatorëve UK	16
1.4.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor	18
1.4.3 Statusi i Ankimeve Gjyqësore	21
1.4.4 Mbrojtja e Konsumatorëve.....	23
1.4.5 Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Shoqërive UK.....	25
1.5 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERRU-së	26
1.5.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare	26
1.5.1.1 Me Kuvendin e Shqipërisë.....	26
1.5.1.2 Me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë	27
1.5.1.2.1 Me AKUK (Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve)	27
1.5.1.2.1 Me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU).....	27
1.5.1.3 Me Autoritetin e Konkurrencës.....	27
1.5.1.4 Me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.....	28
1.5.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare	28
1.5.2.1 ERRU Anëtare e Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare	28
1.5.2.2 Bashkëpunimi me Donatorë dhe Aktorë Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë	29
1.5.2.3 Artikuj Studimorë, Botimet	30
1.6 Transparenca dhe Marrëdhëniet e ERRU-së me Publikun dhe Median	31
1.7 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së	31
1.7.1 Të Ardhurat.....	31
1.7.2 Shpenzimet Operative	32
2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për Vitin 2023	34
3 Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura nga Ekzekutivi	40
4 Ecuria e Reformës në Sektorin UK sipas VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 dhe Problematikat ...	43
5 Objektivat dhe Planet e Veprimit të Punës së ERRU-së dhe Sektorit të Ujit për Vitin 2024	45
6 Gjendja e Performancës së Sektorit UK për Vitin 2023	46
Investimet në Sektorin e Ujësjetës Kanalizimeve.....	54
Subvencionet	55
7 Rekomandime për Përmirësimin e Performancës së ERRU-së dhe të Sektorit të Ujit	57
Aneks 1 - Aplikimet e Shoqërive dhe Situata e Licencimit për Vitin 2023	58
Aneks 2 - Tarifat për Shërbimin e FU dhe Largimit të UN - Viti 2023	60
Aneks 3 - Subvencionet e Shoqërive UK, Vitet 2022-2023 (në lekë)	61
Aneks 4 - Treguesit e Performancës së Shoqërive UK, Viti 2023	62
Aneks 5 - Mbledhjet dhe Vendimet e KKRR - Viti 2023	63
Aneks 6 - Referencat Ligjore të Aktivitetit të ERRU-së	65

Shkurtimet

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të FU dhe Largimit e Përpunimit të UN
UK	Ujësjetllës Kanalizime
U	Ujësjetllës
UN	Ujërat e Ndotura
FU	Furnizimi me Ujë
KUN	Kanalizimi i Ujërave të Ndotura
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KVPTM	Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
KM	Këshilli i Ministrave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
SHA	Shoqëri Aksionere
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUK	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve
IWA	Shoqata Ndërkombëtare e Ujit
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
SHUKALB	Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë
SHUKOS	Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Kosovës
WAREG	Shoqata e Rregullatorëve të Ujit të Evropës
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
NER	Rrjeti i Rregullatorëve Ekonomik
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën
TKP	Treguesit Kryesorë të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
O&M	Kosto Operative dhe Mirëmbajtjeje
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
UPA	Uji Pa të Ardhura
CEI	Nisma e Evropës Qendrore

Parathënie

Enti Rregullator i Ujit (ERRU), në përmbushje të detyrimit që e ngarkon ligji harton Raportin Vjetor të aktivitetit të institucionit. Raporti pasqyron aktivitetin dhe performancën e institucionit të realizuar gjatë vitit, përfshirë dhe përmbushjen e rekomandimeve, të cituara në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për tu realizuar për ERRU-në gjatë vitit 2023. Gjithashtu, Raporti pasqyron zhvillimet kryesore në sektorin ujësjellës kanalizime në Shqipëri dhe jep rekomandime për përmirësimin e performancës së sektorit dhe të vetë institucionit.

Gjatë vitit 2023, sektori UK është karakterizuar nga ndryshime thelbësore sa i përket riorganizimit dhe operimit të tij, në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 *“Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të FU dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të UN”*, i cili në përfundim agregon sektorin UK në 15 shoqëri UK rajonale si Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta nga 58 shoqëri UK që ofronin më parë shërbimin e FU dhe KUN në 61 bashki të vendit. Objektivi kryesor i reformës është që nëpërmjet ekonomisë së shkallës të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve UK.

Procesi i riorganizimit deri në fund të vitit 2023 rezultoi në konkretizimin e 14 shoqërive UK Rajonale nga 15 të parashikuara sipas reformës. Konkretisht janë krijuar shoqëritë UK Rajonale *Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Durrës, Fier, Lushnje, Sarandë, Elbasan, Korçë, Pogradec, Berat, Gjirokastrë dhe Vlorë*, 13 prej të cilave e kanë filluar ushtrimin e aktivitetit në fillim të vitit 2023 ndërsa UK Rajonale *Vlorë* pritet të licencohet dhe të fillojë aktivitetin në fillim të vitit 2024. Për arsye teknike, akoma nuk është krijuar shoqëria Rajonale *UK Tiranë* që përfshin bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë.

Referuar VKM nr. 302 dhe në përmbushje të detyrimeve që i ngarkon ligji nr.8102, ERRU ka luajtur një rol aktiv në zbatim të tij, në drejtim të licencimit dhe tarifave të reja të propozuara nga shoqëritë rajonale, si dhe në realizimin me sukses të reformës duke aplikuar zgjidhje elastike të problematikave komplekse që shoqërojnë zbatimin e saj.

Në këtë kuadër, referuar kërkesës së AKUK mbi nevojën e shoqërive për të aplikuar për nivel të ri tarifor, si dhe të pamundësisë së tyre për të bërë aplikimin brenda afatit 30 qershor të përcaktuar në metodologjinë e tarifave, ERRU, përjashtimisht për vitin 2023, mori dy vendime për shtyrjen e afatit të aplikimeve për nivel të ri tarifor, fillimisht deri më 31 gusht dhe më pas deri më 30 shtator.

Aktiviteti i ERRU-së për vitin 2023 ka konsistuar në drejtimet kryesore të mëposhtme, përkatësisht:

- Licencimi i Shoqërive UK
- Analiza dhe miratimi i propozimeve për tarifa të reja nga Shoqëritë UK;
- Monitorimi i Performancës së Shoqërive UK;
- Mbrojtja dhe Trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve ndaj shoqërive UK;
- Pjesëmarrje aktive fizike dhe online në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Raportime dhe Analiza mbi Aktivitetin e ERRU-së, etj.

Gjatë vitit 2023, ERRU ka miratuar licencat për 16 shoqëri UK, nga të cilat 11 si shoqëri të reja rajonale të krijuara sipas reformës, përkatësisht: *UK rajonale Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Kukës, Lushnje, Pogradec, Sarandë, Shkodër*, të cilat së bashku me *UK Rajonale Korçë dhe Lezhë* të licencuara në vitin 2022 e çojnë në 13 numrin e shoqërive rajonale të licencuara nga 15

që parashikon reforma. Mbeten akoma për tu licencuar dy shoqëri rajonale, përkatësisht *UK Tiranë*, *Vorë*, *Kamëz*) dhe *UK Vlorë* (*Vlorë*, *Selenicë*, *Himarë*). Kjo e fundit pritet të licencohet nga ERRU në fillim të vitit 2024.

Për vitin 2023 janë paraqitur pranë ERRU-së aplikime për tarifa të reja nga 7 shoqëri UK, nga të cilat 6 shoqëri UK Rajonale, përkatësisht: *UK Shkodër*, *Lezhë*, *Durrës*, *Elbasan*, *Berat*, *Fier* dhe shoqëria individuale *UK Vlorë*. KKRR ka marrë vendim për refuzimin e pranimit të 3 aplikimeve për shoqëritë Rajonale *UK Shkodër*, *Elbasan*, *Berat*, të cilat referuar metodologjisë së tarifave në lidhje me kërkesat mbi plotësimin e dokumentacionit në aplikim kishin mangësi thelbësore, si dhe vendosi fillimin e procedurës së analizimit të aplikimit për nivel të ri tarifor për shoqëritë Rajonale *UK Durrës*, *Lezhë*, *Fier*, si dhe për shoqërinë individuale *UK Vlorë*. Deri në mbyllje të vitit 2023, KKRR ka marrë vendim përfundimtar për tarifa vetëm për shoqërinë *UK Vlorë*, ndërsa 3 shoqëritë e tjera janë akoma në proces të analizës tekniko ekonomike.

Monitorimi i performancës së shoqërive UK vijon të mbetet në fokus kryesor të ERRU-së, ku gjatë vitit 2023 është ndjekur një politikë komunikimi ndëraktive me shoqëritë me qëllim mbështetjen e tyre gjatë procesit të riorganizimit. Në këtë kuadër janë realizuar takime dhe vizita monitoruese në vend me shoqëritë UK Rajonale me tematikë problematikat e licencimit, nevojës dhe alternativave të mundshme për tarifa të reja, pagesat rregullatore, identifikimi i problematikave në mbajtjen dhe bashkimin e të dhënave të sakta dhe të besueshme si shoqëri rajonale, identifikimin e rrugëve për përmirësimin e performancës financiare etj.

Në zbatim të misionit në mbrojtje të interesave të konsumatorëve, përveç zgjidhjes së ankesave të tyre me shoqëritë UK, gjatë vitit 2023, si pjesë e grupit ndërinstucional, ERRU ka dhënë kontributin e saj në finalizimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2023 – 2030. Konkretisht, kontributi i saj në dokumentin strategjik ka konsistuar në hartimin e dokumentit strategjik dhe planit të veprimit për mbrojtjen e konsumatorit, në drejtim të zbatimit të të drejtave të konsumatorëve dhe zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorëve dhe shoqërive UK. Gjithashtu, si pjesë raportuese e Grupit Ndërinstucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për nën kapitullin 28 “Mbrojtja e Konsumatorit”, ka kontribuar në hartimin e Progres Raportit për Shqipërinë për vitin 2023 mbi harmonizimin e akteve tona rregullatore me direktivën 2013/11/EU “Zgjidhja alternative të mosmarrëveshjeve”, si dhe krijimit të mekanizmave lehtësuese dhe sa më efikase në trajtimin e ankesave të konsumatorëve, për të cilat ka raportuar edhe pranë Bashkimit Evropian.

Gjatë vitit 2023, ERRU ka konsideruar si prioritet të veprimtarisë së tij bashkëpunimin me institucionet dhe aktorët kryesorë të fushës, përkatësisht me Kuvendin e Shqipërisë, me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKUK, me AMBU, me Autoritetin e Konkurrencës si dhe me donatorët dhe shoqatat duke qenë pjesë aktive gjithashtu në konferenca dhe seminare të ndryshme.

Theksohen si evente të veçanta gjatë vitit 2023 nënshkrimi i dy marrëveshjeve të bashkëpunimit midis AKUK dhe ERRU mbi “Raportimin e të dhënave të shoqërive UK pranë sistemit të integruar të informacionit të performancës (IPIS)”, e cila konsiston në krijimin dhe përdorimin e një sistemi të integruar mbi të dhënat dhe treguesit kryesorë të performancës si dhe marrëveshja mbi “Hartimin dhe miratimin e modelit të planeve pesëvjeçare të biznesit për shërbimet e FU dhe KUN”, e cila lidhet me

përdorimin e një modeli dhe udhëzuesi të unifikuar për Planet 5 Vjeçare të Biznesit sipas modelit që do të hartohet nga ERRU dhe do të jetë i detyrueshëm për zbatim nga operatorët UK.

Bashkëpunimi me WAREG gjithashtu ka vijuar të jetë shumë aktiv përfshirë dhe ato me anë të dy projekteve të financuara nga programi *TAIEX i Komisionit Evropian*, që ofrojnë asistencë teknike për institucionet publike në lidhje me përafrimin, aplikimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE për ujërat dhe ai i financuar nga CEI për ngritjen e kapaciteteve të stafëve rregullatore. Po kështu bashkëpunimi ka vijuar edhe me Programin e Danubit financiar nga Banka Botërore, IWA, UNECE, Komisionin Evropian, me shoqatat UK të Shqipërisë dhe Kosovës SHUKALB dhe SHUKOS.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2023, referuar Raportit të Aktivitetit të Entit Rregullator të Ujit (ERRU), për vitin 2022 përcakton angazhimet në drejtim të institucionit të ERRU-së për vitin 2023, i përmbledhur në 10 pika. Për përmbushjen e këtyre rekomandimeve është raportuar pranë Kuvendit të Shqipërisë në intervale 4 mujore, ku pjesa më e madhe e të cilave është përmbushur, ndërsa për disa prej tyre vazhdon angazhimi nga ERRU për përmbushjen e tyre sepse realizimi përfundimtar për to kërkon një afat kohor përtej një viti kalendarik.

Pjesë e këtij Raporti është edhe performanca e përgjithshme e sektorit UK për vitin 2023, përfshirë dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e performancës së sektorit në të ardhmen.

Gjendja e sektorit UK për vitin 2023, e paraqitur përmes Treguesve Kryesorë të Performancës krahasuar me vitin e mëparshëm, tregon se reforma në sektorin UK ka dhënë impaktin e vet në drejtim të përmirësimit në përgjithësi të situatës financiare të sektorit krahasuar me vitin paraardhës 2022, që ka qenë një ndër objektivat kryesorë të reformës. Këtë impakt e ka dhënë përmirësimi me 13,7% i Mbulimit të Kostove O&M, Normës së Arkëtimit Korrente me 1.6% dhe asaj të Përgjithshme me 4.7%.

Gjithashtu të përmirësuar paraqiten edhe një pjesë e treguesve të tjerë të performancës, si **Niveli i Matjes, Eficenca e Stafit, Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë, Mbulimi me Kanalizime dhe Eficenca e Energjisë**, të cilët gjithashtu kanë patur ndikimin e tyre në përmirësimin e situatës financiare të shoqërive dhe në cilësinë e ofrimit të shërbimit.

ERRU, si institucion i pavarur për rregullimin e sektorit UK dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore kundrejt sektorit UK dhe konsumatorëve, do të vazhdojë të rrisë angazhimin e tij për të forcuar pavarësinë, transparencën, profesionalizmin, bashkëpunimin ndërinstitutional në mënyrë të tillë që me autoritetin e vet rregullator të krijojë ekuilibrin e duhur midis ofruesve të shërbimeve, politikëbërësve dhe konsumatorëve.

Komisioni Kombëtar Rregullator

Përmbledhje

**Raporti Vjetor
2023 i
Aktivitetit të
ERRU-së
Instrument
Informimi dhe
Transparence**

Raporti Vjetor i aktivitetit të ERRU-së paraqet veprimtarinë e këtij institucioni në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8102 dhe të Rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së ERRU-së për vitin 2023”. Qëllimi i Raportit është informimi dhe transparenca ndaj Kuvendit të Shqipërisë, Kryeministrisë, ndaj publikut dhe institucioneve që lidhen me sektorin e ujit në përmbushje të misionit të tij që shoqëritë UK të ofrojnë për konsumatorët shërbime FU dhe KUN me cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm, si dhe të jenë financiarisht të qëndrueshme. Pjesë e këtij raporti është dhe analiza për gjendjen dhe performancën e sektorit të ujit, shoqëruar me rekomandimet përkatëse për rritjen e performancës. Gjithashtu, në raport përcaktohen edhe objektivat e punës së ERRU-së për vitin e ardhshëm në drejtim të forcimit të rolit të tij si institucion i pavarur.

**ERRU, Statusi
Ligjor,
Përgjegjësitë
dhe Struktura
Organizative**

ERRU, si institucion i pavarur ushtron aktivitetin e tij bazuar në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996, i ndryshuar, ligj i cili e ngarkon ERRU-në me këto përgjegjësi:

- Licencimit të shoqërive UK;
- Vendosjes së tarifave për shërbimet UK;
- Përcaktimit të standardeve dhe kushteve të shërbimit;
- Monitorimit të performancës së operatorëve UK;
- Mbrojtjes së interesave të konsumatorëve.

Në përgjigje të kërkesave të kohës për rregullimin e veprimtarisë së sektorit dhe për rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së ERRU-së, pritet që shumë shpejt të miratohet ligji i ri për sektorin e FU dhe largimit e përpunimit të UN, i cili krahas të tjerave parashikon plotësimin në drejtim të përmirësimit të forcimit të rolit rregullator të ERRU-së. ERRU ka një strukturë organike të aprovuar nga Kuvendi i Shqipërisë në total me 29 punonjës, nga të cilët 5 janë anëtarë komisioni, 1 Sekretar i Përgjithshëm, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës.

**Licencimi i
Shoqërive UK**

Sektorin e ujit, prej vitit 2022 është në proces reformimi, ku sektori riorganizohet në 15 shoqëri rajonale nga 58 shoqëri individuale ekzistuese. Deri në fund të vitit 2023 janë licencuar nga ERRU 13 shoqëri rajonale dhe mbeten akoma për tu licencuar në dy shoqëri rajonale, përkatësisht UK Tirana (Tiranë, Vorë, Kamëz) dhe UK Vlorë (Vlorë, Selenicë, Himarë).

Në vitin 2023 kanë aplikuar pranë ERRU-së për licencë të re apo rinovim 16 shoqëri, nga të cilat 11 për herë të parë, si UK shoqëri rajonale: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Kukës, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, dhe për efekt përfundim afati UK Tiranë, ndryshim drejtuesi ligjor UK Shkodër, UK Vlorë dhe UK rajonale Kukës, si dhe UK Malësi e Madhe për ndryshim drejtuesi teknik. Deri në fund të vitit 2023 mbetet e pa licencuar vetëm shoqëria UK Himarë, e cila sipas riorganizimit do të jetë pjesë e shoqërisë Rajonale UK Vlorë që pritet të fillojë operimin gjatë vitit 2024.

**Procesi i
Miratimit të
Tarifave për
Shërbimet UK**

Gjatë vitit 2023 pranë ERRU kanë aplikuar për nivel të ri tarifor 7 shoqëri UK, përkatësisht 6 si shoqëri Rajonale: *Shkodër, Lezhë, Durrës, Elbasan, Berat, Fier* dhe një shoqëri ekzistuese individuale, *UK Vlorë*. KKRR mori vendim për refuzimin e 3 aplikimeve për shoqëritë Rajonale *UK Shkodër, UK Elbasan dhe UK Berat për arsye të mungesës së paraqitjes së dokumentacionit të detyrueshëm sipas parashikimeve të metodologjisë së tarifave, si dhe vendosi për fillimin e*

analizës së aplikimit për tarifat e propozuara për Shoqëritë Rajonale *UK Durrës, Lezhë, Fier* dhe për shoqërinë ekzistuese *UK Vlorë*.

Në fund të vitit 2023 ERRU mori vendimin për tarifat e miratuara vetëm për shoqërinë ekzistuese *UK Vlorë* ndërsa vazhdon analiza për 3 shoqëritë Rajonale *UK Lezhë, Fier dhe Durrës*, vendimi përfundimtar për të cilat pritet të merret nga ERRU brenda 3 mujorit të parë të vitit 2024.

UK Vlorë ka aplikuar me qëllim përmirësimin e gjendjes financiare sepse tarifat e mëparshme kanë qenë në nivele nga më të ulëtat në vend dhe nuk siguronin qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë.

UK Rajonale Lezhë ka aplikuar me synim unifikim e tarifave volumetrike në zonën e shërbimit, si dhe për vendosjen e tarifës fikse për të gjithë klientët në zonën e shërbimit. Tarifat e reja të propozuara synojnë mbulimin 100% të kostove O&M dhe përmirësimin e treguesve financiarë si shoqëri rajonale.

UK Rajonale Fier me aplikimin e saj kërkon unifikim e tarifave volumetrike në zonën e shërbimit duke synuar mbulimin e 100% të kostove të O&M.

UK Rajonale Durrës aplikoi me tarifat e reja të diferencuara në zonën e shërbimit për shkak të diferencave të mëdha të tarifave ekzistuese ndërmjet këtyre bashkive përbërëse të shoqërisë rajonale, duke synuar mbulimin afër 100% të kostove të O&M.

Monitorimi i Performancës së Shoqërive UK

Monitorimi i performancës së shoqërive UK nga ERRU ka vijuar duke ndjekur një politikë komunikimi ndëraktive me shoqëritë me qëllim mbështetjen e tyre gjatë procesit të riorganizimit. Në këtë kuadër janë realizuar takime dhe vizita monitoruese në vend me shoqëritë UK Rajonale mbi problemet e licencimit, të alternativave të propozimeve për tarifa të reja, pagesat rregullatore, mbajtja dhe bashkimin e të dhënave në shoqërinë rajonale, identifikimin e rrugëve për përmirësimin e performancës financiare etj.

Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave të raportuara nga shoqëritë UK mbetet problematike për sektorin. Për këtë, në nëntor të vitit 2023, ERRU nënshkroi me AKUK marrëveshjen e bashkëpunimit për rregullimin e përdorimit të një sistemi të integruar mbi të dhënat dhe treguesit kryesorë të performancës (IPIS), të raportuara nga shoqëritë UK, që pritet të ketë impakt pozitiv në raportimin prej tyre të të dhënave të sakta dhe të besueshme.

Mbrojtja dhe Trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve

Në përmbushje të identifikimit të të gjithë mekanizmave të mbrojtjes së konsumatorit që mungojnë ose që duhet të forcohen dhe në kuadër të procesit të integritimit evropian, përveç trajtimit të ankesave të konsumatorëve dhe monitorimit të shoqërive UK, në vitin 2023, ERRU ka dhënë kontributin e saj në hartimin e dokumenteve strategjike në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit si pjesë aktive e raportimeve në BE për përafrimin e direktivave për mbrojtjen e konsumatorit në sektorin e ujit. ERRU, si pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës ka kontribuar në hartimin e dokumentit strategjik për mbrojtjen e konsumatorit, në zbatim të drejtave të tyre dhe zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve me shoqëritë UK. Harmonizimi me direktivën 2013/11/EU “Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve” e Parlamentit Evropian ka qenë në fokusin e punës së ERRU-së për vitin 2023 si pjesë raportuese e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për nën kapitullin 28 “Mbrojtja e Konsumatorit” pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR) të Bashkimit Evropian.

Gjatë vitit 2023 në ERRU janë depozituar 16 ankesa të ardhura kryesisht nga konsumatorë familjarë, nga të cilat 7 prej tyre kanë marrë zgjidhje përfundimtare në favor të konsumatorit. Natyra e ankesave ka qenë zbatueshmëria e kushteve të kontratës për shërbime UK, cilësia e shërbimit dhe

faturimi aforfe. Trajtimi i ankesave është realizuar me anë të takimeve të drejtpërdrejta me shoqëritë UK dhe me verifikime në terren. Në rolin e saj si ndërmjetësues, ERRU për trajtimin e ankesave, orientimi dhe trajtimi i disa prej ankesave është kryer nëpërmjet strukturës së ngritur pranë ERRU-së për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve. ERRU ka ofruar asistencë me të gjithë konsumatorët që janë drejtuar ERRU-së edhe nëpërmjet konsultimeve verbale apo me telefon. Mekanizmi i ri i pranimin të ankesave, sistemi online nëpërmjet faqes zyrtare të ERRU-së www.erru.al ka sjellë risi në lehtësimin e procedurave për konsumatorët për të drejtuar një ankesë pranë ERRU-së.

Ecuria e Reformës në Sektorin UK sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022 dhe Problematikat

Gjatë vitit 2023, procesi i riorganizimit të sektorit sipas VKM nr.302 të lançuar nga qeveria qendrore në maj të vitit 2022, e cila e agregon sektorin UK në 15 shoqëri UK rajonale nga 58 të fragmentuara që operonin në sektor, hyri në fazë përfundimtare duke krijuar 14 shoqëri UK Rajonale, përkatësisht: *Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Durrës, Fier, Lushnje, Sarandë, Elbasan, Korçë, Pogradec, Berat, Gjirokastër, Vlorë*, 13 prej të cilave e kanë filluar ushtrimin e aktivitetit që në fillim të vitit 2023 ndërsa UK Rajonale Vlorë pritet ta fillojë atë në fillim të vitit 2024. Mbetet akoma pa u krijuar shoqëria Rajonale *UK Tiranë*, e cila përfshin bashkitë: Tiranë, Kamëz, Vorë si rezultat i diskutimeve në vazhdim ndërmjet drejtuesve të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe MIE për disa aspekte teknike të veçanta të procesit si një proces që kryhet me baza vullnetare dhe dakordësie midis palëve.

ERRU ka luajtur një rol proaktiv në procesin e riorganizimit të sektorit duke licencuar në kohë shoqëritë UK Rajonale të krijuara. Deri në fund të vitit 2023 janë licencuar 13 shoqëri UK Rajonale. Riorganizimi i sektorit është një proces kompleks me shumë sfida të një sërë problematikash të diktuar nga auditimi nga ekspertët e pavarur, si më poshtë:

- Mos rakordimi i detyrimeve të prapambetura kontraktuale të shoqërive të mëparshme ekzistuese me institucionet financiare kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat shoqëritë rajonale janë të detyruara ti respektojnë.
- Mos rakordim i numrit të klientëve debitorë në sistem me ato të pasqyruara në bilancet financiare nga UK ekzistuese.
- Mungesa e stafëve të kualifikuara në pozicionet kyçe të shoqërive.
- Bllokimi i llogarive bankare të shoqërive të mëparshme ekzistuese nga detyrimet e prapambetura të cilat ju ngarkuan shoqërisë së re rajonale.
- Në përgjithësi u konstatua mungesë e dokumentacioneve të rregullta nga shoqëritë UK ekzistuese.

Unifikimi tarifor synohet në të gjithë zonën e re të shërbimit. Për disa nga shoqëritë rajonale tarifrat janë të përafërta nga zona në zonë, prandaj unifikimi tarifor është i mundshëm. ERRU inkurajon procesin e unifikimit tarifor për nivel të njëjtë shërbimesh UK, sepse duke patur të dhënat e variablave tekniko financiare të përbashkëta krijohet mundësia e një menaxhimi financiar dhe monitorimi relativisht më të kontrollueshëm dhe efikas, si edhe zbatohet parimi i barazisë të detyrimit financiar ndërmjet klientëve në zonën e shërbimit.

Unifikimi i tarifave në të gjithë zonën e shërbimit për disa shoqëri UK Rajonale, si Durrësi, Korça, etj., duket mjaft i vështirë për shkak të diferencave të mëdha të tarifave të mbartura nga shoqëritë individuale të mëparshme. Për këto shoqëri unifikimi i tarifave është i parakohshëm dhe do të rriste në mënyrë të menjëhershme tarifrat për disa zona, që praktika ka treguar se kjo do të pasohej me ulje të normës së arkëtimit për shkak të refuzimit të pagesës së lartë të faturës nga konsumatorët. Pra në vend që të përmirësonte gjendjen financiare

të shoqërisë, do ta përkeqësonte atë. Në këtë rast unifikimi tarifor duhet të realizohet në mënyrë graduale duke vlerësuar gjendjen rast pas rasti.

Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së

Burimet e financimit të aktivitetit të veprimtarisë së ERRU-së janë pagesat rregullatore vjetore të përcaktuara në kontratat me Shoqëritë UK si dhe pagesat për licencime.

Të ardhurat totale nga ERRU gjatë vitit 2023 janë 57 751 067 lekë dhe përbëhen nga:

- 54 971 067 lekë nga pagesat rregullatore vjetore nga shoqëritë UK;
- 2 780 000 lekë nga pagesat për licencimet e shoqërive UK.

Shpenzimet buxhetore të kryera nga ERRU gjatë vitit 2023, janë realizuar në shumën 59 904 358 lekë nga 65 093 460 lekë të planifikuara, ose 92% e tyre. Shpenzimet kanë rezultuar më të vogla se planifikimi për shkak të shpenzimeve të porealizuara për shpenzimet për pagat dhe sigurimet për punonjësit, si dhe nga disa kursime për shërbimet dhe furniturën.

Në mbyllje të vitit 2023, gjendja e mjeteve financiare të disponueshme në llogarinë bankare të ERRU-së garanton plotësisht realizimin e parashikimit të planit të shpenzimeve të vitit 2024.

Performanca e Sektorit UK dhe Analiza e çdo Treguesi të Veçantë

ERRU, monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme gjendjen dhe performancën e shoqërive UK, mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës, të miratuar nga KKRR. Për vitin 2023 raporti është strukturuar sipas shoqërive të riorganizuara sipas VKM Nr. 302, ku 13 shoqëri nga 15 që parashikon reforma kanë raportuar të dhënat si shoqëri UK Rajonale. Situata e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2023 krahasuar edhe me vitin 2022 jepet në Tabelën nr.1.

Tabela nr. 1. Treguesit Kryesorë të Performancës për Vitet 2022-2023

Nr.	Treguesit Kryesorë të Performancës	Njësia e Matjes	Viti 2022	Viti 2023	Tendenca
1	Uji Pa të Ardhura	%	63.7	64	↘
2	Mbulimi i Kostove O&M	%	90.3	104	↗
3	Norma e Arkëtimit Korrente	%	81.4	83	↗
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	%	97.3	102	↗
5	Niveli i Matjes	%	82.8	86	↗
6	Efienca e Stafit	(staf/1000 lidhje UK)	4.73	4.6	↗
7	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	16.3	16.6	↗
8	Mbulimi i Furnizimit me Ujë	%	78	76.2	↘
9	Mbulimi me Kanalizime	%	54.2	55	↗
10	Efienca e Energjisë FU	kWh/m³	0.65	0.5	↗-
11	Ankesat e Klientëve	%	2.8	3.1	↘

Burimi: ERRU

Vërehet se reforma masive në sektorin UK gjatë vitit 2023, ka dhënë impakt pozitiv në drejtim të përmirësimit të situatës financiare të sektorit krahasuar me vitin 2022, i cili ka qenë një ndër objektivat kryesorë të reformës.

Për këtë ka ndikuar përmirësimi me 13,7% i Mbulimit të Kostove O&M, Normës së Arkëtimit Korrente me 1.6% dhe asaj të Përgjithshme me 4.7%.

Përmirësimet kanë edhe një pjesë të tjerë të performancës, si Niveli i Matjes, Efienca e Stafit, Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë, Mbulimi me Kanalizime dhe Efienca e Energjisë, të cilët kanë ndikuar në përmirësimin e situatës financiare të shoqërive dhe në cilësinë e ofrimit të shërbimit.

Treguesit e Uji Pa të Ardhura dhe Mbulimi i Furnizimit me Ujë kanë një përkeqësim të vogël, si rezultat i gabimeve në raportimet e vitit 2022 nga ish shoqëritë UK përpara reformës, ndërsa për treguesin Ankesat e Klientëve, ishte e pritshme tendenca e përkeqësimit si rezultat i periudhës tranzitore në kuadër të riorganizimit dhe konsolidimit të shoqërive UK Rajonale.

Në detaje, TKP analizohen:

"Uji Pa të Ardhura" për vitin 2023 është përkeqësuar me rreth 0.3% krahasuar me një vit më parë, përkatësisht nga 63,7% në 64%. Përkeqësimi i këtij treguesi ka ardhur si rezultat i rritjes së volumit të ujit të prodhuar me rreth 7 milion m³ përkundrejt volumit të faturuar me vetëm 0.65 milion m³, ku përmenden shoqëritë UK, Sarandë me 3.9 milion m³, Durrës me 3.4 milion m³, Vlorë me 3.2 milion m³ dhe Elbasan me 2.5 milion m³.

"Mbulimi i Kostove O&M" është në nivelin e 104% nga 90.3% në vitin 2022. Shoqëritë Berat, Korçë, Pogradec, Sarandë, Tiranë dhe Himarë mbulojnë mbi 100% kostot O&M, 11 shoqëri i mbulojnë ato nga 75% deri 100%, dhe 2 shoqëri Vlorë dhe Vorë performojnë nën nivelin 70%. Mbulimi i Kostove Totale, për vitin 2023, arrihet nga 3 shoqëri UK në sektor, përkatësisht Berat, Tiranë dhe Himarë.

"Norma e Arkëtimit" për vitin 2023 është përmirësuar në 83% nga 81.4%, ku dallohen shoqëritë UK, Tiranë, Kamëz, Durrës, Lezhë, Elbasan, Fier dhe Dibër. Norma e Arkëtimit e Përgjithshme rezultoi 102% nga 97.3% në vitin 2022, ku përmenden shoqëritë UK, Durrës, Dibër, Korçë, Kukës, Lezhë, Gjirokastrë, Berat, Fier, Lushnje, Tiranë dhe Vlorë.

"Niveli i Matjes" prej 86% është përmirësuar me 3.4% krahasuar me 2022, ku janë instaluar rreth 44,511 matës uji, por ende raportohen 133,532 klientë pa matës nga të cilët 5,252 janë të kategorisë jo familjarë.

"Efiçenca e Stafit" me 4,6 staf/1000 lidhje UK ka një përmirësim të lehtë me 0.13%, nga 15,635 lidhje të reja FU dhe 1600 të KUN, pasi edhe stafi është ulur me 104 punonjës.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" raportohet 16,6 orë/ditë me një rritje të lehtë prej 0.3 orë/ditë, ku vetëm shoqëria Rajonale UK Korçë ka 23.5 orë/ditë, pjesa tjetër, me 13-22 orë në ditë, ndërsa Kamëz, Selenicë dhe Vorë nga 4-8 orë /ditë. Riorganizimi i shoqërive UK në shoqëri rajonale ka ndikuar që asnjë prej shoqërive UK të raportojë furnizim me ujë të pandërprerë në 24/7, pasi shoqërive ekzistuese që ofronin furnizim ujë 24/7 u janë bashkuar shoqëri me më pak orë furnizimi duke ulur mesataren e orëve për të gjithë zonën e shërbimit.

"Mbulimi i Furnizimit me Ujë" për vitin 2023 ka pësuar një rënie me rreth 1.8% dhe është në nivelin e 76.2% nga 78% që ishte në vitin 2022. Rënia e këtij treguesi ka ardhur si rezultat i rënies së popullsisë në juridiksion me 58,098 banorë ndërkohë që edhe popullsia e shërbyer ka pësuar rënie me 127,055 banorë. Ndikimi kryesor ka ardhur nga shoqëritë UK Elbasan, UK Korçë, UK Gjirokastrë.

"Mbulimi me Kanalizime" në nivelin 55% ka një përmirësim me 0.8% pasi popullsia me shërbimin e KUN është ulur me 13,525 banorë, ndërkohë që popullsia në juridiksion është ulur me 58,098 banorë. Në sektor janë akoma rreth 33 mijë klientë, të cilët e realizojnë grumbullimin e ujërave të ndotura nëpërmjet gropave septike. Gjithsesi kërkohet rritja e vëmendjes për investimet në këtë sektor.

"Efiçenca e Energjisë" është 0.5 kWh/m³ nga 0.65 kWh/m³ që ishte në vitin 2022. Përmirësimi ka ardhur nga ulja e konsumit të kWh me 11.3 milion si rezultat i rakordimeve me OSHE për faturime të pasakta megjithëse volumi i ujit të prodhuar ka qenë me rritje.

“Ankesat e Klientëve” janë 3.1% nga 2.8 që ishin në vitin 2022, me një rritje prej 2974 ankesash për të gjithë sektorin e pritshme për shkak të problemeve që u shfaqen në fazën e riorganizimit të sektorit. Ndikimin kryesor në përkeqësimin e këtij treguesi e kanë dhënë kryesisht Shoqëritë UK Rajonale Fier, Berat, Dibër, Lushnje si dhe shoqëria UK Vorë.

**Objektivat e
ERRU-së për
Vitin 2024**

- Pas miratimit përfundimtar të ligjit të ri për sektorin UK, të rishikojë të gjitha aktet nënligjore rregullatore në fuqi, të nevojshme për tu rishikuar.
- Në bashkëpunim me AKUK të kontribuojë në ngritjen sa më shpejt të Sistemit të Integruar të të Dhënave dhe Treguesve Kryesorë të Performancës, në kuadër të marrëveshjes mbi “Raportimin e të dhënave të shoqërive UK pranë sistemit të integruar të informacionit të performancës (IPIS)”, i cili do të përdoret nga të dyja palët.
- Të shtojë vëmendjen dhe kontrollin ndaj shoqërive UK për rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave që raportohen, si një ndër problematikat kryesore të sektorit.
- Të ofrojë asistencën e duhur për shoqëritë rajonale në lidhje me problematikat që në mjaft raste pritjet të hasen nga propozimet e tarifave të reja duke zbatuar metodologjinë e re të tarifave të shërbimeve UK.
- Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me AKUK mbi “Hartimin dhe miratimin e modelit të Planeve 5 vjeçare të Biznesit për shërbimet e UK”, në bashkëpunim me konsulentin e përzgjedhur nga procesi i prokurimit të mbikëqyrë përgatitjen dhe miratimin e modelit të unifikuar të Planeve të Biznesit 5 vjeçare, si dhe udhëzuesin përkatës, në përputhje me Termat e Referencës dhe kushtet e parashikuara në kontratën me Konsulentin.
- Të vijojë punën për krijimin e mekanizmave informues për rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve në drejtim të cilësisë së shërbimit UK të ofruar nga shoqëritë, si dhe njohjes së të drejtave dhe detyrimeve të palëve.
- Të nxisë shoqëritë UK për të krijuar standarde eficiente në trajtimin e ankesave si dhe të vijojë procesin e monitorimit mbi procedurat e trajtimit dhe zgjidhjes të ankesave të konsumatorëve nga ana e shoqërive UK.
- Të intensifikojë përpjekjet për rritjen e kapaciteteve të institucionit duke planifikuar ditët e nevojshme përmes trajnimeve, të shkëmbimit të eksperiencave me rregullatorët e Ballkanit Perëndimor, ato Evropianë të WAREG dhe veçanërisht me Rregullatorin e Skocisë (WICS) dhe Hungarisë (MEHK).
- Të vijojë bashkëpunimin veçanërisht me AKUK, me MIE, si dhe aktorët e tjerë kryesorë të sektorit të ujit, si SHUKALB në mbështetje të reformës për përmirësimin e performancës së sektorit UK.
- Të jetë pjesë aktive në të gjithë Grupet e Punës dhe të aktiviteteve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar ku trajtohen dhe diskutohen çështje thelbësore strategjike dhe tematika të veçanta të sektorit UK për përmirësimin e instrumenteve rregullatore gjatë veprimtarisë së tij.
- Në përgjigje të statusit të hapjes së negociatave me BE të kontribuojë në përmbushje të kërkesave të Acquis Communautaire të Shqipërisë në lidhje me Direktivat Evropiane për Ujin e Pijshëm, Ujërat e Ndotura dhe të Llumërave të ITUN.

**Rekomandime
për
Përmirësimin e
Performancës
së Sektorit UK
dhe të ERRU-së**

- Të bëhen përpjekjet maksimale nga ana e AKUK me mbështetjen e duhur financiare dhe asistencë për përballimin e vështirësive që kanë aktualisht shoqëritë rajonale për menaxhimin e aktiviteteve të tyre të përqendruara kryesisht në gjetjet nga auditimi i pavarur, si rakordimi dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura me institucionet financiare kombëtare dhe ndërkombëtare, rakordimi i numrit të klientëve debitorë në sistem me ato në bilancet financiare nga UK ekzistuese.
- Plotësimi sa më parë i pozicioneve kyçe në organogramën e shoqërisë me stafe të kualifikuara, si dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit ekzistues.
- Në vijim të reformës në sektorin UK, të hartohen nga shoqëritë rajonale Planet e Menaxhimit të Aseteve, përfshirë dhe ndërtimin e një sistemi të unifikuar digjital të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së asetëve.
- Në përgjigje të krizës globale energjitike dhe të ndikimit të saj eventual në vendin tonë, të shihet si prioritet hartimi i Planeve të Rritjes së Eficencës së Energjisë për shoqëritë UK dhe fillimi i zbatimit të tyre, përfshirë fondet përkatëse të nevojshme për këtë qëllim, si faktor që ndikon drejtpërsëdrejti në uljen e kostove të O&M.
- Të planifikohen dhe alokohen fondet përkatëse nga AKUK për pajisjen e të gjithë sistemeve të FU, me ujëmatës të mëdhenj në burim, në mënyrë që shoqëritë UK të kenë mundësinë e hartimit të saktë të Bilanceve të Ujit, vlerësimit të humbjeve, si dhe gjendjen reale të kërkesës për ujë.
- Duke marrë në konsideratë ndryshimet klimatike, të planifikojë sa më parë hartimin e Planeve të Emergjencës për shoqëritë UK për masat dhe alternativat e nevojshme për të përballuar kërkesën për ujë në situata emergjence.
- Duke patur parasysh që një pjesë të mirë të kostove të justifikuara që duhet të mbulohen me tarifa e përbëjnë investimet e reja, duhet të krijohet mundësia që ERRU të përfaqësohet për të dhënë rekomandimet e saj në komisionet teknike pranë AKUK për aprovimin e projekteve të reja për investimet.
- AKUK së bashku me ERRU të marrë iniciativën për ndryshimet e nevojshme legjislative për sigurinë e objekteve të sistemeve të FU, të konsideruara si objekte të rëndësishme të veçantë për të mundësuar zgjidhje alternative që reduktojnë kostot mjaft të larta të rojeve, duke konsideruar zgjidhje alternative teknike dhe me anë të digjitalizimit.

1 Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit

1.1 Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) është rregullator i pavarur i sektorit ujësjellës kanalizime në Shqipëri. I krijuar me ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, (ligji nr. 8102) ERRU zhvillon aktivitetin e tij rregullator në sektorin UK prej më shumë se 25 vitesh dhe ka si përgjegjësi kryesore licencimin e shoqërive dhe miratimin e tarifave për shërbimet UK, përcaktimin e standardeve dhe kushteve të shërbimit, si dhe monitorimin e performancës së shoqërive UK.

ERRU, nëpërmjet rregullimit ekonomik dhe procesit të licencimit synon gjetjen e ekuilibrit midis interesave të konsumatorëve dhe operatorëve. E gjithë kjo duhet të arrihet në përputhje me parimet e efikasitetit ekonomik dhe përdorimit racional të burimeve ujore, përballueshmërisë së tarifave, rikuperimit të kostove si dhe mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu në rregullimin e një tregu monopol siç është ai i FU dhe KUN lind natyrshëm nevoja për transparencë dhe nxitje të konkurrencës aty ku është e mundur.

Vitet e fundit është diskutuar gjerësisht mbi nevojën për një qasje dhe një vizion të ri, për mënyrën e administrimit të sektorit, qasje e cila u prezantua nga qeveria në vitin 2022 me miratimin e VKM nr. 302, datë 11.5.2022, "Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të FU dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të UN". Me këtë vendim filloi procesi i riorganizimit të sektorit, i cili ka për qëllim të përmirësojë sigurimin e shërbimeve të FU dhe KUN në të gjithë territorin e vendit, duke plotësuar nevojat e një ekonomie në zhvillim, si dhe duke mbrojtur mjedisin, shëndetin e sigurinë e qytetarëve.

Riorganizimi i sektorit vijoi për gjatë gjithë vitit 2023, vit në të cilin me VKM nr. 448, datë 26.7.2023 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të sektorit të FU dhe KUN 2023–2030", u miratua strategjia kombëtare sektoriale 2023 - 2030. Ky dokument paraqet në mënyrë të qartë vizionin, misionin dhe qëllimin e politikave të sektorit, si dhe planet e veprimit ku përfshihen të gjithë aktorët.

Ky vizion i ri do të pasqyrohet edhe në kuadrin ligjor nëpërmjet rishikimit të ligjit nr. 8102 që është i përfshirë tek ligji i ri për sektorin e FU dhe largimit e përpunimit të UN. Ligji i ri do të përbëjë kornizën kryesore të funksionalitetit të sektorit. Referuar urdhrit të MIE nr. 581, datë 18.07.2018, ERRU është pjesë e grupit të punës për hartimin e projektligjit bashkë me institucione dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm në sektor.

Në muajin korrik të vitit 2023, MIE ka përcjellë draftin e ligjit për komente dhe sugjerime nga grupi i punës. Në muajin nëntor të vitit 2023 u publikua për konsultim publik projektligji "Për sektorin e FU të pijshëm, largimit, grumbullimit e trajtimit të UN urbane". ERRU shqyrtoi projektaktin dhe depozitoi disa komente dhe propozime për ndryshime në draftin e publikuar.

1.2 Detyrime ndaj Rekomandimeve të "Progres-Raportit të BE-së për Shqipërinë"

Si pjesë raportuese e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për Nën kapitullin 28 “Mbrojtja e Konsumatorit”, gjatë vitit 2023, ERRU ka kontribuar në hartimin e Progres Raportit për Shqipërinë për vitin 2023 për këtë kapitull mbi harmonizimin e akteve tona rregullatore me direktivën 2013/11/EU “Zgjidhja alternative të mosmarrëveshjeve” si dhe krijimit të mekanizmave lehtësuese dhe sa më efikase në trajtimin e ankesave të konsumatorëve.

Gjithashtu, ERRU ka qenë pjesë e takimeve bilaterale të raportimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR) të Bashkimit Evropian për të raportuar mbi përmbushjen e detyrimeve të institucionit tonë në drejtim të trajtimit të ankesave të konsumatorëve.

Gjatë vitit 2023 gjithashtu, ERRU është angazhuar për të dhënë kontributin e saj në fillimin e procesit për hartimin e Programit Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) 2024-2030 dhe të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2024 – 2026 (PKIE) po për kapitullin 28 “Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik”, proces i cili do të vijojë edhe për vitin 2024.

1.3 Struktura Organizative e ERRU-së

Forma organizative, struktura dhe organika e ERRU-së rregullohen në përputhje me ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”. Si institucion i pavarur, i krijuar me ligj, struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të nëpunësve të Entit Rregullator të Ujit, miratohen me vendim të Kuvendit.

Struktura dhe organika e ERRU-së janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 33/2022, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të FU dhe Largimit e Përpunimit të UN (ERRU)". Me miratimin e kësaj strukture, për Entin u mundësua realizimi i përmirësimeve dhe ndryshimeve të nevojshme në kuadër të ristrukturimit të sektorit UK.

Ndryshimi gjithashtu erdhi edhe si përpjekje e ERRU-së për përmirësimin e kapaciteteve të tij. Në përbërje të strukturës së ERRU-së janë gjithsej 29 punonjës, nga të cilët 5 anëtarë komisioni, 1 Sekretar i Përgjithshëm, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës, struktura organizative e së cilës, jepet në figurën 1 të mëposhtme.




Figura nr.1. Struktura e Entit Rregullator të Ujit

Kjo strukturë ka për qëllim rritjen e efikasitetit, profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të rregullatorit duke forcuar bashkërendimin dhe koordinimin e punëve midis strukturave, përshtatjen e tyre me detyrat dhe sfidat që ERRU ka përballë reformës së sektorit UK që burojnë edhe nga objektivat strategjike të institucionit.

1.4 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese

1.4.1 Licencimi i Operatorëve UK

Sektori i ujit, prej vitit 2022 është në proces reformimi, ku në zbatim të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit të FU dhe të Largimit, Trajtimin dhe Përpunimit të UN”, nga 58 shoqëri UK ekzistuese që operojnë në sektor të riorganizohen në Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta (SKP) duke krijuar 15 shoqëri Rajonale UK, ku deri në përfundim të vitit 2023 vetëm 13 prej tyre janë licencuar nga ERRU.

Në sektorin UK shërbimi i "grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik" kryhet nga 13 Shoqëri Rajonale ose ndryshe SKP të licencuara nga ERRU dhe 6 shoqëri UK ekzistuese individuale si UK Tiranë, Vorë, Kamëz, Vlorë, Selenicë, Himarë, të cilat ende nuk janë rajonalizuar sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022.

Shërbimin e "përpunimit të ujit të pijshëm për konsum publik" e kryejnë 2 (dy) shoqëri, UK Tiranë me impiantin e trajtimit të ujit të pijshëm të Bovillës dhe Shoqëria Rajonale UK Durrës, me impiantin e Ujit të pijshëm të Maskurisë (Kavajë), që është jashtë funksionit. Shërbimi i "grumbullimit e largimit të UN" ofrohet nga të gjitha shoqëritë ndërsa përpunimi i tyre arrihet të kryhet vetëm nëpërmjet 6 impianteve të ndërtuara pjesë e shoqërive Rajonale Durrës (ITUN Durrës dhe Kavajë), Shkodër (ITUN Velipojë dhe Shirokë), Lezhë dhe Korçë, të cilat janë të pajisur me licencë nga ERRU. Mbeten 3 (tre) prej tyre që ende nuk plotësojnë kërkesat ligjore për licencim për këtë kategori shërbimi si Shoqëria Rajonale UK Sarandë (ITUN Sarandë) dhe UK Vlorë (ITUN Vlorë dhe Orikum), e cila është ende e pa rajonalizuar. Në vend ekzistojnë edhe disa impiante me kapacitete relativisht të vegjël si, në Gjirin e Lalëzit, Durrës, në Fshatin SOS, Tiranë, si edhe disa të këtij niveli në zonën e bregdetit të jugut të Shqipërisë që operohen privatisht për nevoja hotelerie.

Shoqëritë UK, në momentin që përfundojnë procedurat e riorganizimit në formën e SKP dhe procesit e transferimit, duhet të aplikojnë pranë ERRU brenda tre muajve për pajisjen me licencë të re shërbimi rajonale.

Gjatë vitit 2023, pas përfundimit të procedurave të riorganizimit, aplikuan për licencim për herë të parë dhe u licencuan 11 shoqëri të reja rajonale. Këto shoqëri rajonale së bashku me shoqëritë rajonale UK Korçë dhe Lezhë, të cilat u licencuan brenda vitit 2022, e çojnë në 13 numrin e shoqërive rajonale që janë licencuar nga ERRU, nga 15 të tilla që parashikon reforma për të gjithë sektorin.

Shoqëri rajonale të parashikuara që janë ende të pa riorganizuar janë shoqëria rajonale UK Vlorë, ku do të përfshihen shoqëritë ekzistuese UK Vlorë, UK Selenicë dhe UK Himarë (është në përfundim të procesit), si dhe Shoqëria Rajonale UK Tiranë, ku do të përfshihen shoqëritë ekzistuese UK Tiranë, UK Kamëz dhe UK Vorë, e cila ka akoma disa probleme të karakterit teknik për të filluar dhe përfunduar procesi i agregimit. Theksohet fakti që VKM nr. 302 nuk është detyruese për riorganizimin në SKP, por me vullnetin e lirë të palëve për të hyrë në marrëveshje, konkretisht të Pushtetit Vendor si pronarë të shoqërive UK dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, gjatë vitit 2023, pranë Enti Rregullator të Ujit, kanë paraqitur dokumentacionin të aplikimit për licencë apo rinovim licence, 16 shoqëri UK.

Këto aplikime kanë qenë për efekt të:

- *Licencim për herë të parë* 11 shoqëri të reja Rajonale (UK Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Kukës, Lushnje, Pogradec, Sarandë dhe Shkodër),
- *Përfundim afati i licencës*, 1 shoqëri ekzistuese (UK Tiranë),
- *Ndryshim drejtuesi ligjor* 2 shoqëri ekzistuese (UK Shkodër, UK Vlorë) dhe 1 (një) shoqëri rajonale (UK Kukës),
- *Ndryshim drejtuesi teknik* 1 shoqëri ekzistuese (UK Malësi e Madhe).

ERRU ka marrë në shqyrtim të gjitha aplikimet e mësipërme, të cilat më pas kanë kaluar për vendimmarrje dhe janë miratuar në KKRR.

Në përfundim, gjatë vitit 2023, KKRR ka miratuar licencimin apo rinovim licence për 12 (dymbëdhjetë) shoqëri Rajonale, ku shoqëria Rajonale UK Kukës, ka aplikuar dy herë brenda vitit dhe 4 (katër) UK ekzistuese. (aneksi 1 tabela 1).

Situata e licencimit deri në fund të vitit 2023 për shoqëritë UK ekzistuese dhe të ndara sipas shoqërive të reja rajonale paraqitet si më poshtë (aneksi 2 tabelë 2):

1.4.2 Tarifat dhe Procesi Tarifor

Në vijim të miratimit të dokumentit “Metodologjia dhe procedura për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”, sipas vendimit të KKRR nr. 539 datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve UK”, viti 2023 konsiderohet si fillimi i zbatimit dhe implementimit të saj bazuar në të gjitha kriteret dhe përcaktimet e parashikuara në metodologjinë e tarifave gjatë aplikimeve të shoqërive UK për nivel të ri tarifor.

Metodologjia e tarifave përcakton rregullat dhe procedurat që duhen ndjekur për llogaritjen e tarifave të shitjes me shumicë e pakicë të ujit për konsum publik, të ujërave të ndotura dhe trajtimit të tyre si dhe afatet dhe kushtet e shërbimit për çdo veprimtari të ushtruar nga operatorët në sektorin e FU dhe KUN, në mënyrë që të arrihet një performancë e qëndrueshme teknike e financiare me në fokus mbrojtjen e klientëve nga çmimet monopol.

Viti 2023 gjithashtu konsiderohet edhe si viti i parë i implementimit të reformës në sektorin UK ku sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022 u krijuan 14 shoqëri UK si SKP nga 15 që parashikon reforma. Si rezultat i reformës, shoqëritë e reja SKP të krijuara nuk arritën që të aplikonin në kohë sipas përcaktimeve të metodologjisë së tarifave ku afati përfundimtar për aplikim është data 30 qershor i çdo viti, kjo si rezultat i problematikave të hasura nga shoqëritë e reja të krijuara si SKP, e cila përkoi edhe me periudhën zgjedhore ku duhej pritur edhe konstituimi i këshillave bashkiakë përkatës, pasi opinioni i tyre është edhe një ndër dokumentet bazë që kërkohet në rastin e aplikimit për nivel të ri tarifor.

Në këtë situatë, ERRU, duke marrë në konsideratë problematikat përkatëse si dhe kërkesën e ardhur nga AKUK si aksionari kryesor me 51% të aksioneve të shoqërive SKP të krijuara, përjashtimisht për vitin 2023, mori dy vendime për shtyrjen e afatit të aplikimeve për nivel të ri tarifor, përkatësisht vendimin nr. 28, datë 23.06.2023 për shtyrje të afatit deri më 31 Gusht 2023 dhe vendimin nr. 32, datë 13.09.2023 për shtyrje të afatit deri më 30 shtator.

Në përfundim të afatit të përcaktuar nga KKRR për aplikimet e shoqërive UK për nivel të ri tarifor për vitin 2023, pranë ERRU aplikuan 7 shoqëri UK, nga të cilat 6 shoqëri të riorganizuar si shoqëri UK Rajonale përkatësisht **UK Rajonale Shkodër, Lezhë, Durrës, Elbasan, Berat dhe Fier** dhe një shoqëri ekzistuese individuale, **UK Vlorë**.

Mbas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të aplikimeve për 7 shoqëritë UK, KKRR mori vendim për refuzimin e 3 aplikimeve përkatësisht shoqëritë Rajonale **UK Shkodër** për arsye se nuk dispononte një licencë të lëshuar nga ERRU, (kushti i domosdoshëm për aplikim për tarifa) dhe UK Rajonale **Elbasan dhe Berat** të cilat kishin mangësi të dokumentacionit sipas parashikimeve të nenit 10 të metodologjisë së tarifave, sidomos të përmbushjes së kushtit për organizimin e seancave dëgjimore me publikun. Në përfundim, KKRR mori vendimin për fillimin e procedurës së analizës për aplikimet për nivel të ri tarifor për shoqëritë Rajonale **UK Durrës, Lezhë dhe Fier** si dhe për shoqërinë **UK Vlorë**. Deri në fund të vitit 2023 ka përfunduar analiza tekniko-ekonomike dhe është marrë vendimi përfundimtar nga KKRR për tarifa vetëm për shoqërinë UK Vlorë ndërsa 3 shoqëritë Rajonale UK Lezhë, Fier dhe Durrës janë akoma në proces të analizës tekniko-ekonomike, për të cilat është parashikuar që vendimet e tyre të mbyllën brenda 3 mujorit të parë të vitit 2024 sipas tabelës së mëposhtme nr.2.

Tabela nr.2 . Shoqëritë për të cilat KKRR ka marrë vendim dhe parashikimi i vendimeve për shoqëritë akoma në proces analize.

Nr.	Shoqëria	Numri i Vendimit të KKRR	Data e Vendimit/Parashikimi
1	UK Vlorë	58	27.12.2023
2	UK Rajonale Lezhë		Shkurt 2024
3	UK Rajonale Fier		Mars 2024
4	UK Rajonale Durrës		Mars 2024

Metodologjia e tarifave konsiston në dy metoda të përcaktimit të tarifave, metoda “Kosto Plus” për shoqëritë që mbulojnë deri në 100% kostot operacionale dhe metoda “Çmimi Tavan” për shoqëritë që mbulojnë mbi 100% kostot operacionale. Shoqëritë e mësipërme, të cilat kanë aplikuar për nivel të ri tarifor gjatë vitit 2023 bëjnë pjesë në grupin e shoqërive që nuk arrijnë të mbulojnë kostot e O&M mbi 100%, si rrjedhojë këto shoqëri kanë aplikuar referuar metodës “Kosto Plus”.

Arsyet kryesore të aplikimeve për tarifa të reja nga shoqëritë e mësipërme kanë qenë:

- Përbushja e detyrimit ligjor nga shoqëritë UK të aplikimit për tarifa të reja sipas vendimit nr. 302 datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të FU dhe KUN” me tendencë unifikimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit.
- Përbushja e detyrimit ligjor për shoqëritë UK për të aplikuar tarifa të miratuara nga ERRU, në përputhje me nenin 14 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të FU dhe KUN ", si autoritet i vetëm që miraton tarifën e shërbimeve UK.
- Aplikimi për tarifa të reja për të rritur qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë, në përputhje me nenin 22, Ligji nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të FU dhe KUN ", për mbulimin 100% të kostove operacionale me qëllim përmirësimin e shërbimit të ofruar, mirëmbajtjen e rrjetit, stacioneve të pompimit, makinerive etj.
- Aplikim për tarifa të reja për shkak të rritjes së çmimeve/njësi sidomos të energjisë elektrike dhe materialeve për shoqëritë që prodhojnë ujë me ngritje mekanike si edhe të pagës minimale në shkallë vendi.

Më poshtë jepen detaje të aplikimeve të mësipërme për secilën shoqëri UK:

UK Vlorë ka aplikuar në shtator të vitit 2023 pas një periudhe 5 vjeçare nga aplikimi i fundit për tarifa. Shoqëria UK Vlorë referuar metodologjisë së tarifave, për herë të parë ka kërkuar nivel të ri tarifor edhe për shërbimin e përpunimit të ujërave të ndotura (ITUN), por duke qenë se shoqëria nuk është e licencuar nga ERRU për kategorinë D (për trajtimin e UN), propozimi i shoqërisë për nivel të ri tarifor për këtë shërbim nuk është marrë në konsideratë. Me tarifën e reja të miratuara synohet mbulimi deri rreth 90% i kostove të O&M si dhe janë vendosur objektiva agresive për treguesit kryesorë të performancës.

UK Rajonale Lezhë ka aplikuar për herë të parë në shtator 2023 pas licencimit si SKP në zbatim të VKM nr.302, me qëllim unifikim e tarifave në zonën e shërbimit, si dhe për vendosjen e tarifës fikse për të gjithë klientët në zonën e shërbimit. Tarifën e reja të propozuara synojnë mbulimin 100% të kostove operative me fokus përmirësimin e treguesve financiarë të shoqërisë .

UK Rajonale Fier ka aplikuar për herë të parë në shtator 2023 pas licencimit si SKP në zbatim të VKM nr.302, me qëllim unifikimin e tarifave volumetrike për të gjithë kategoritë e klientëve në zonën e shërbimit për periudhën 3-vjeçare, pa përfshirë tarifën fikse. Tarifën e reja të propozuara synojnë përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë me qëllim mbulimin 100% të kostove operative.

UK Rajonale Durrës edhe kjo shoqëri ka aplikuar për herë të parë në shtator 2023 pas licencimit si SKP në zbatim të VKM nr.302. Tarifën e reja të propozuara nga shoqëria janë të diferencuara pasi ka diferenca të mëdha të tarifave ekzistuese ndërmjet bashkive përbërëse të SKP-së. Rritja e menjëhershme e tarifave duke i unifikuar ato për të gjithë zonën e shërbimit duket e pamundur edhe për shkak të diferencës në nivelet e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve. Me tarifën e propozuara UK Rajonale Durrës synon përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë me qëllim mbulimin sa më afër 100% të kostove të O&M duke qenë se është edhe shoqëria me kostot më të larta të energjisë elektrike.

Nisur nga nivelet e ndryshme të tarifave që ekzistojnë ndërmjet bashkive që janë bërë pjesë e një SKP-je si rezultat i riorganizimit, si në rastin e shoqërisë Rajonale UK Durrës, ERRU ka përshtatur modelin e aplikimit (Excel) që të pranojë deri në 3 nivele të tarifave të ndryshme të propozuara brenda zonës së shërbimit, krahasuar me 2 nivele që parashikohesh më parë.

Gjatë analizës së propozimeve për tarifa të reja, konstatohen probleme lidhur me raportimin e të dhënave kryesisht për numrin e lidhjeve të reja që nuk përputhen me planifikimin e vëllimeve të parashikuara për faturim, të bilancit të ujit, si edhe konsumi i parashikuar i energjisë elektrike dhe kosto e parashikuar për paga e sigurime, të cilat nuk kanë rezultuar të llogaritura saktë. Në zbatim të metodologjisë së re të aplikimit, shoqëritë rajonale, duhet të krijojnë dhe mirëmbajnë sistemet e informacionit për të dhënat pasi ERRU do të vlerësojë cilësinë e të dhënave të raportuara, të cilat do të ndikojnë në vendimin përfundimtar të tarifave të aprovuara prej saj si bonus apo penalitet.

ERRU, në kuadër të mbrojtjes së klientëve nga tarifën e larta të pajustificuara në analizën dhe vendimmarrjen për tarifa të reja vlerëson kriterin e përbalueshmërisë së faturës së llogaritur për shërbimet e ofruara për konsumatorët familjarë. Fatura e llogaritur me tarifën e miratuara nga ERRU nuk e kalon nivelin prej 5% të shpenzimeve mujore të Njësisë Ekonomike Familjare (NJEF), që INSTAT publikon çdo vit në dokumentin "Anketa e Buxhetit të familjes për vitin 2022" e publikuar në vitin 2023 për të gjitha qarqet e Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu ERRU i kushton një rëndësi të veçantë zhvillimit të seancave dëgjimore me publikun si kusht i domosdoshëm për tu realizuar nga shoqëritë UK, të cilat shërbejnë si instrument transparence ndaj konsumatorëve për të justifikuar përpara tyre tarifën e reja që shoqëria synon të aplikojë. Gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore konsumatorët kanë mundësinë të shprehin kërkesat e tyre në drejtim të masave të nevojshme që duhen ndërmarrë nga shoqëritë UK për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar. ERRU ndjek nga afër dhe merr pjesë në zhvillimin e seancave dëgjimore të organizuara nga shoqëritë UK me qëllim monitorimin dhe organizimin e tyre sipas parashikimeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

Të gjithë projektvendimet për miratimin e tarifave, përpara se të marrin formë përfundimtare nga ERRU, dërgohen për komente në Shoqërinë UK dhe Bashkinë përkatëse, si edhe tek Autoriteti i Konkurrencës.

Rritja e vazhdueshme e kostove kryesisht atyre të energjisë elektrike, të punës dhe të materialeve dikton akoma nevojën për mbështetjen e shoqërive UK me subvencione nga qeveria qendrore deri sa gradualisht nëpërmjet kostove efektive dhe planifikimit afatgjatë të arrihet të mbulohen me të ardhura të gjitha kostot operacionale në sektorin UK. Pritet që agregimi i shoqërive UK në shoqëri rajonale të formuara në zbatim të reformës në sektorin e ujit të ketë ndikim pozitiv në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të tyre dhe të sektorit në përgjithësi.

1.4.3 Statusi i Ankimeve Gjyqësore

Gjatë vitit 2023 ERRU ishte palë në 5 procese gjyqësore civile dhe administrative, statusi i të cilave paraqitet si më poshtë:

1. Enti Rregullator i Ujit – Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Palë Padiçese: Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Palë e Padiçur: UK Tiranë

Këshilli Bashkiak Tiranë

Komisioni Kombëtar Rregullator, ERRU

Objekti: Konstatimin absolutisht të pavlefshëm të:

1. Propozimit për rritjen e tarifave të ujit drejtuar ERRU-së për rishikimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura nr. prot. 13132, datë 29.06.2017 dhe shkresën me nr. prot. 14275, datë 20.07.2017 me lëndë "Kërkohet mendimi i Këshillit Bashkiak për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm";
2. Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 79, datë 26.07.2017 "Për dhënie mendimi për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm";
3. Vendimit e Këshillit Kombëtar Rregullator, ERRU nr. 47, datë 07.11.2017, "Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për shoqërinë UK Tiranë sh.a.";
4. Rregullimin nga gjykata të pasojave të derivuara nga aktet e përmendura më sipër (absolutisht të pavlefshme);
5. Ndalimi për të ardhmen i efekteve (pasojave) të akteve administrative të sipërcituara, absolutisht të pavlefshme".

Në muajin dhjetor të vitit 2023 kjo çështje u gjykua nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, me anë të të cilit është vendosur nga gjykata rrëzimi i padisë së ngritur nga padiçesi.

2. ERRU – UK Krujë

Palë padiçese: ERRU

Palë e padiçur: UK Krujë sh.a

Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "UK Krujë" sh.a. të shlyejë shumën 997 167 (nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë ndaj ERRU-së, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vendosur të pranojë kërkesëpadinë e ERRU-së por vendimi ende nuk është zbardhur.

3. ERRU - UK Tropojë sh.a

Palë paditëse: ERRU
Palë e paditur: UK Tropojë sh.a
Objekti: Detyrimi i të paditurit Shoqëria "UK Tropojë" sh.a. të shlyejë shumën 463 750 (katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë ndaj ERRU-se, si detyrim i pa përmbushur kontraktual.

Kjo çështje është në proces shqyrtimi nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

4. L.B. - ERRU

Palë Paditëse: L.B
Palë e Paditur: ERRU
Objekti:

1. Shfuqizim i vendimit nr. 15, datë 25.03.2019 "Për zgjidhjen e Kontratës Individuale të Punës";
2. Detyrimin e palës së paditur të paguajë dëmshpërblimin me 12 muaj pagë pune, për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara , përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;
3. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 3 muajve për mos respektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi page;
4. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e 2 muajve për mos respektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë;
5. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagën e një 15 ditësh-i për çdo vit vjetërsi në punë, konkretisht 9 vjet vjetërsi në punë, e barabartë me 4 paga e gjysmë shpërblim, përfshirë sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe shtesat mbi pagë.

Kjo çështje është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ky vendim është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ende nuk e ka shqyrtuar çështjen.

5. A. G. - ERRU

Palë Paditëse: A.G
Palë e Paditur: ERRU

Objekti: Detyrimi i palës së paditur ERRU që të paguajë shpërblimin për vjetërsi në punë për periudhën 21.08.2006 deri më 03.08.2014 periudhë gjatë së cilës kam ushtruar detyrën e Anëtarit të KKRR në masën e 4 pagave mujore referuar pagës mujore në momentin e përfundimit të marrëdhënies së punës e cila është 146,150 lekë.

Kjo çështje është në shqyrtim nga Gjykata e Lartë e cila nuk ka dhënë akoma vendimin përfundimtar.

6. K. R. – ERRU

Palë Paditëse: K.R

Palë e Paditur: ERRU

Objekti:

1. Detyrimin e palës së paditur për të dëmshpërblyer paditësen me:
 - i. Pagën e 1 viti për zgjidhje të kontratës pa shkaqe të justifikuara;
 - ii. Pagën e 2 muajve për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës;
 - iii. Pagën e 4 pesëmbëdhjetë ditëshave ose pagën e 2 muajve si shpërblim për vjetërsi në punë prej 4 vitesh;
 - iv. Pagën e 2 muajve për mosrespektimin e afatit të njoftimit.
2. Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile.
3. Detyrimin e palës së paditur të paguajë shpenzimet gjyqësore.

Kjo çështje është duke u shqyrtuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

1.4.4 Mbrojtja e Konsumatorëve

ERRU, në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të FU dhe KUN”, i ndryshuar, ushtron aktivitetin e tij rregullator duke pasur në fokus mbrojtjen e konsumatorit dhe jep rekomandimet e duhura në drejtim të përmirësimit të menaxhimit dhe respektimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Edhe gjatë vitit 2023, ERRU si pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës ka vijuar punën për të përcjellë me kontributin e saj në finalizimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2023 – 2030, nismë e ndërmarrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në përmbushje të identifikimit të të gjithë mekanizmave të mbrojtjes së konsumatorit që mungojnë, ose që duhet të forcohen, në kuadër të procesit të integritimit evropian, përfaqësues të Drejtorisë Juridike dhe Konsumatorit janë angazhuar në mënyrë periodike në hartimin e dokumentit strategjik dhe planin e veprimit për mbrojtjen e konsumatorit, në drejtim të zbatimit të të drejtave të konsumatorëve dhe zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorëve dhe shoqërive UK.

Angazhimi i ERRU-së, si pjesë e procesit drejt integritimit evropian dhe përafrimi i direktivave për mbrojtjen e konsumatorit në sektorin e ujit, ka sjellë një qasje sa më afër konsumatorit, jo vetëm në mënyrën e zgjidhjes së ankesave, por edhe të krijimit të mekanizmave lehtësuese dhe sa më efikase në trajtimin e ankesave të konsumatorëve. Harmonizimi me Direktivën 2013/11/EU “Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve” të Parlamentit Evropian ka qenë në fokusin e punës së ERRU-së për vitin 2023 si pjesë raportuese e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integritimin Evropian (GNPIE) për

nën kapitullin 28 “Mbrojtja e Konsumatorit” pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR) të Bashkimit Evropian. ERRU në raportimin e saj në Bruksel përçolli informacion mbi përmbushjen e këtij detyrimi të institucionit tonë duke theksuar rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit të konsumatorit për mundësinë dhe mekanizmat e reja sa më efektive për zgjidhjen e ankesave nëpërmjet kësaj strukture.

Në përmbushje të objektivave institucionale për mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet monitorimit apo krijimit të mekanizmave për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve në drejtim të ofrimit të shërbimit UK, ERRU i ka kushtuar një vëmendje të veçantë krijimit nga ana e shoqërive rajonale UK, të strukturave përkatëse të kujdesit ndaj klientit nga këto shoqëri rajonale. Këto struktura në përbërje të tyre duhet të kenë këndin e informimit të publikut për çdo nevojë që kanë konsumatorët për shërbimin UK.

- **Trajtimi i Ankesave të Konsumatorëve**

Një nga mekanizmat kryesorë të mbrojtjes së konsumatorit është sigurimi që nëpërmjet trajtimit të ankesave, konsumatorët të trajtohen në mënyrë të drejtë e të barabartë në zgjidhjen e ankesës së tyre.

Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, ERRU fillon procedurën e trajtimit të një anese, pasi verifikon se kërkesa e paraqitur plotëson kriteret minimale për t’u trajtuar, dhe pasi konstaton se ankesa që paraqitet për shqyrtim përfshin një shoqëri UK. Pasi analizon dokumentacionin e vënë në dispozicion nga konsumatorët, ERRU adreson ankesën tek shoqëria për marrjen e informacionit e dokumentacionit plotësues të nevojshëm që i shërbejnë procesit të trajtimit të ankesës, dhe më tej jep rekomandimet e duhura për zgjidhjen e saj. Gjithashtu, nëpërmjet shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave, ERRU evidenton problematikat që kanë shoqëritë UK në lidhje me ofrimin e shërbimit.

Gjatë vitit 2023, pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorit janë depozituar 16 ankesa të ardhura si nga konsumatorë familjarë dhe privatë nga Tirana, Durrësi, Vlora, Elbasani, Kamza etj. ERRU për këto ankesa ka vijuar me procedurat e komunikimit zyrtar me shoqëritë UK për të evidentuar mënyrën e trajtimit të tyre nga shoqëria dhe respektimin e akteve nënligjore të cilat rregullojnë marrëdhënien shoqëri UK - Konsumator.

Trajtimi i disa ankesave nga ERRU gjatë vitit 2023 duke zhvilluar takime me shoqëritë UK dhe verifikimeve përkatëse në terren është kryer nëpërmjet strukturës së ngritur pranë ERRU-së për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve.

Natyra e ankesave edhe për këtë vit ka qenë në tre kategori “faturimi aforfe”, “cilësia e shërbimit të ofruar nga shoqëritë UK” dhe “zbatueshmëria e kushteve të kontratës për shërbime UK”. Referuar tabelës së mëposhtme, nga totali i të gjithë ankesave, shtatë prej tyre kanë pasur një zgjidhje përfundimtare dhe të kënaqshme në favor të konsumatorit.

Tabela nr. 3 Ankesat e trajtuara nga ERRU gjatë vitit 2023

Nr.	Objekti i Ankesës	Nr. Ankesave	Nr. Ankesave të Zgjidhura
1.	Faturimi Aforfe	6	2
2.	Zbatueshmëria e Kushteve të Kontratës	4	2
3.	Cilësia e shërbimit	6	3
TOTALI		16	7

Rastet e faturimit aforfe ku konsumatorët faturohen më shumë se norma e konsumit mujor për person kur konsumatori nuk ka ujëmatës, vijnë të jenë objekt i ankesave pranë ERRU. Janë evidentuar raste problematike të faturimit aforfe për shume vite për konsumatorë të cilët nuk kanë qenë në dijeni të ekzistencës së kontratave në emër të tyre. Për këto lloj ankesash, ERRU ka rekomanduar saktësimin dhe rregullimin e këtyre lloj kontratave dhe hartimin e planeve të veprimit konkrete nga ana e shoqërive UK për eliminimin e këtij lloj faturimi.

Kontrata për shërbimet UK përcakton të drejtat dhe detyrimet e marrëdhënies konsumator – shoqëri UK, ndaj respektimi i tyre është kusht kryesor për sigurimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit. *“Respektimi dhe zbatueshmëria e të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në kontratën për shërbime UK”* ka qenë objekt ankimi për 4 ankesa pranë ERRU-së, për të cilat dy prej tyre kanë gjetur një zgjidhje të kënaqshme për konsumatorët.

Objektet e ankimit për *cilësinë e ofruar të shërbimit* kanë qenë të fokusuar në probleme teknike për të cilat shoqëritë UK nuk kanë dhënë asnjë zgjidhje ose nuk i janë përgjigjur konsumatorëve, ndaj për këto lloj ankesash ka qenë i nevojshëm verifikimi në terren nga ana ERRU-së për të garantuar angazhimin e shoqërive UK.

Përveç ankesave të paraqitura në mënyrë zyrtare (shkresë zyrtare), ERRU ka vijuar komunikimin dhe ka ofruar asistencë për të gjithë konsumatorët që i janë drejtuar ERRU-së nëpërmjet konsultimeve verbale apo telefon për zgjidhjen e problemeve të tyre. Nga ana tjetër, mekanizmi më i ri i pranimit të ankesave të konsumatorëve, sistemi online nëpërmjet faqes zyrtare të ERRU-së www.erru.al ka sjellë risi në lehtësimin e procedurave për konsumatorët për të drejtuar një ankesë pranë institucionit tonë, i aksesueshëm dhe pa kosto shtesë.

1.4.5 Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Shoqërive UK

Raporti Vjetor i Performancës së Sektorit UK paraqet ecurinë e performancës së këtij sektori krahasuar me vitin paraardhës, me qëllim paraqitjen në mënyrë transparente të gjendjes së sektorit për të gjitha palët e interesuara. Gjithashtu në raport pasqyrohen problematikat për sektorin në tërësi, si dhe për secilën shoqëri UK në veçanti, ku jepen dhe rekomandimet në nivel strategjik për përmirësimin e performancës së sektorit në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

ERRU i kushton një rëndësi të veçantë monitorimit dhe vlerësimit të performancës së operatorëve UK dhe sektorit në tërësi duke synuar nxitjen e përmirësimit të performancës së tij, referuar cilësisë së shërbimeve të ofruara për konsumatorët edhe qëndrueshmërisë financiare të vetë sektorit. Kjo arrihet duke kryer një vlerësim korrekt të performancës së çdo operatori dhe vendosjen e objektivave sfiduese dhe të arritshme, shoqëruar me plane veprimi për arritjen e tyre.

Gjatë vitit 2023, në sektor kanë ndodhur ndryshime thelbësore, të cilat kanë filluar që në vitin 2022, si rezultat i reformës së miratuar nga qeveria qendrore. Në vijim të forcimit të rolit të tij monitorues, ERRU grumbullon të dhënat sipas formatit të miratuar të bazës së të dhënave, të cilat përdoren edhe për hartimin e Raportit Vjetor 2023. Në përputhje me planet e miratuara dhe kur vihen re problematika, ERRU kryen gjithashtu monitorime në terren tek shoqëritë UK për një vlerësimin real të performancës, si dhe me njohjen e vështirësive dhe problematikave që hasin shoqëritë UK.

Duke qenë se viti 2023 ka qenë vit tranzicioni (rajonalizimi), ERRU ka ndjekur me përparësi procesin e mbajtjes dhe raportimit të të dhënave nga shoqëritë UK duke komunikuar intensivisht me to në mbështetje të këtij procesi. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2023 janë realizuar takime dhe vizita monitoruese në vend me të gjitha shoqëritë UK rajonale të krijuara të cilat kanë patur në thelb mbarëvajtjen e operimit të tyre në zbatim të ligjit të ERRU-së nr. 8102 dhe vendimit nr.302, datë 11.05.2022 për riorganizimin e sektorit në drejtim të licencimit, problematikave mbi nivelet e ndryshme tarifore, pagesat rregullatore të tyre, identifikimi i problematikave në mbajtjen dhe bashkimin e të dhënave të ish shoqërive UK në ato rajonale, pengesat në përmirësimin e performancës së shoqërive rajonale dhe situatës së tyre financiare si rezultat i ndryshimeve në sektor.

Gjithashtu, një nga problematikat që konstatohet në mënyrë të vazhdueshme është saktësia e të dhënave të raportuara nga shoqëritë UK. Monitorimi nga ERRU, me ndryshimet sipas reformës, ku qeveria qendrore ka 51% të aksioneve të shoqërive rajonale UK (SKP), merr një rëndësi të veçantë për objektivitetin dhe transparencën e vlerësimit të performancës së sektorit UK.

Për përmirësimin dhe minimizimin e kësaj problematike në nëntor të vitit 2023 ERRU nënshkroi me AKUK marrëveshjen e bashkëpunimit për rregullimin e përdorimit të një sistemi të integruar mbi të dhënat dhe treguesit kryesorë të performancës (IPIS), që mbahen dhe raportohen nga shoqëritë UK. Ky sistem pritet të ketë impakt pozitiv në zgjidhjen përfundimtare të problematikës së raportimit të të dhënave të sakta dhe të besueshme.

1.5 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERRU-së

Bashkëpunimi me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare që operojnë në fushën e ujit dhe përfaqësimi sa më dinjitoz i institucionit në aktivitetet që organizohen prej tyre është një ndër prioritetet e veprimtarisë së ERRU, si një element kryesor drejt forcimit institucional dhe rritjes së kapaciteteve të stafit. Në të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2023, konferenca, seminare, workshop-e, ERRU është angazhuar në mënyrë aktive, duke asistuar jo vetëm me pjesëmarrje, por edhe prezantime apo moderime në sesione të veçanta.

1.5.1 Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare

1.5.1.1 Me Kuvendin e Shqipërisë

Bashkëpunimi me Kuvendin e Shqipërisë gjatë vitit 2023 ka konsistuar në informimin periodik të gjendjes në sektorin e UK, takimeve zyrtare mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të parashtruara në rezolutë, raportimit në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit (KVPTM), si dhe në Kuvendin e Shqipërisë. Në përmbushje të detyrimit ligjor, me 16 mars është zhvilluar seanca dëgjimore mbi Raportin Vjetor të ERRU-së në KVPTM, ndërsa dy javë më vonë është raportuar në Kuvendin e Shqipërisë mbi veprimtarinë 1-vjeçare të institucionit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023, ERRU ka qenë subjekt i monitorimit që KVPTM zhvilloi në institucionet e pavarura, ku në tetor 2023 u zhvillua një vizitë pranë zyrave të ERRU nga disa deputetë, anëtarë të këtij Komisioni me qëllim informimin dhe diskutimin mbi stadin aktual të përmbushjes së detyrave ligjore dhe rekomandimeve të dhëna në rezolutën e miratuar nga Kuvendi për vitin 2023.

1.5.1.2 Me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Edhe gjatë vitit 2023, ERRU ka vijuar bashkëpunimin me MIE në kuadër të reformës së ndërmarrë për riorganizimin e sektorit UK. Si një prej aktorëve kryesorë në sektor dhe pjesë e grupit të punës, ERRU ka dhënë kontributin e tij në hartimin e Projektligjit “Për sektorin e FU dhe largimin, grumbullimin e trajtimin e UN urbane”, përmes komenteve, takimeve dhe konsultimeve të organizuara. Po ashtu, ka qenë pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e “Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2023-2030”, publikuar në korrik 2023.

1.5.1.2.1 Me AKUK (Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve)

Në vijim të forcimit të bashkëpunimit me AKUK, veçanërisht në kuadër të implementimit të politikave kombëtare për riorganizimin e sektorit UK, ERRU ka bashkëpunuar ngushtësisht me takime pune dhe konsultime të shpeshta me qëllim realizimin me sukses të riorganizimit të sektorit. Bashkëpunimi i këtij viti është konkretizuar gjithashtu edhe me nënshkrimin e dy marrëveshjeve të bashkëpunimit midis AKUK dhe ERRU, të cilat i shërbejnë përmirësimit të performancës operacionale dhe financiare të shoqërive UK dhe rritje së aksesit në shërbimet e FU, konkretisht marrëveshja “Mbi raportimin e të dhënave të shoqërive UK pranë sistemit të integruar të informacionit të performancës (IPIS)”, dhe ajo “Mbi hartimin dhe miratimin e modelit të planeve pesëvjeçare të biznesit për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve”.

Marrëveshja e parë konsiston në krijimin dhe përdorimin, nga të dy palët, të një sistemi të integruar mbi të dhënat dhe treguesit kryesorë të performancës, të mbledhura nga shoqëritë UK, ndërsa e dyta lidhet me përdorimin e një modeli dhe udhëzuesi të unifikuar për Planet 5 Vjeçare të Biznesit. Referuar dokumentit të firmosur nga drejtuesit e dy institucioneve, ERRU është përgjegjëse për përgatitjen dhe miratimin e modelit Planit të Biznesit 5 vjeçar dhe Udhëzuesit përkatës që do të përdoren nga shoqëritë UK.

1.5.1.2.1 Me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)

Në vijim të bashkëpunimeve institucionale në sektorin e ujit, në vitin 2023 i është kushtuar vëmendje marrëdhënies me AMBU, e cila konsiston në kontributin e ERRU-së për përgatitjen e “Kartelës së Rezultateve për Qasje të Barabartë”. Aktualisht AMBU është përfshirë në procesin e përgatitjes së politikave që sigurojnë qasje të barabartë në FU dhe KUN për të gjithë, projekt i asistuar nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara dhe OBSH për Evropën (UNECE/OBSH-Evropë). Në këtë kuadër, në tetor u zhvilluan një cikël seminaresh mbi projektin e vetëvlerësimit në akses të barabartë në FU dhe KUN, pjesë e të cilave ishte edhe ERRU. Në vijim të këtij procesi, përfaqësuesit e projektit zhvilluan edhe një takim pranë zyrave të ERRU, ku informuan mbi qëllimin e këtij projekti dhe nevojën për përfshirjen dhe kontributin institucional në këtë projekt.

1.5.1.3 Me Autoritetin e Konkurrencës

Në vijim të zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me Autoritetin e Konkurrencës, ERRU edhe përgjatë vitit 2023 ka vijuar bashkëpunimin me këtë institucion, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive dhe garantimin e mbrojtjen e interesave publike në sektorin e ujit. ERRU ka kërkuar vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për një projektvendim, “Për Miratimin e Tarifave të Shërbimit të Furnizimit me Ujë dhe Largimin e Ujërave të Ndotura për Shoqërinë Ujësjetës Kanalizime Vlorë Sh.a”.

1.5.1.4 Me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Në kuadër të projektit “Transparenca pro aktive e institucioneve të pavarura”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) përzgjodhi ERRU-në si një ndër institucionet e pavarura me një praktikë mjaft transparente me publikun në zbatim të legjislacionit “Për të Drejtën e Informimit”. Në vijim të kësaj, në tetor 2023 KDIMDP zhvilloi një vizitë në ambientet e ERRU për të prezantuar ndryshimet në ligjin nr.11/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, teksa vlerësoi punën e rregullatorit në trajtimin e kërkesave për informim dhe transparencën e të dhënave si dhe forcimin e rolit të koordinatorit si një mekanizëm për të rritur përgjegjësinë e institucionit në ushtrimin e funksionit të tij.

1.5.2 Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare

Gjatë vitit 2023, ERRU ka vijuar intensifikimin e marrëdhënieve me organizatat ndërkombëtare si: Shoqata Ndërkombëtare e Ujit (IWA), Shoqata e Rregullatorëve Evropianë të Ujit (WAREG), Rrjetit të Rregullatorëve Ekonomikë të OECD (NER) e të tjera duke qenë pjesë aktive në veprimtaritë e organizuara nga ata, por edhe si bashkë organizatore e seminareve që kanë si qëllim njohjen dhe shkëmbimin e modeleve dhe praktikave më të mira rregullatore.

1.5.2.1 ERRU Anëtare e Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare

Si anëtare me të drejta të plota në Shoqatën Evropiane të Rregullatorëve të Ujit (**WAREG**) prej vitit 2014, ERRU ka ndjekur me interes katër mbledhjet e Asamblesë të mbajtura në vitin 2023, si më poshtë:

- Asambleja e 27-të e WAREG e zhvilluar në muajin mars, në Lisbonë, në të cilën u zgjodh Bordi i ri i WAREG, u miratua plani 3-vjeçar i veprimit si dhe projekt udhëzimi drejtuar Komisionit Evropian mbi Direktivën për Ujin e Pijshëm dhe Kanalizimet. Me rëndësi, takimi midis rregullatorëve ekonomikë të vendeve të Ballkanit Perëndimor për të çuar më tej marrëveshjen e nënshkruar në 18 maj të vitit 2022 në Shqipëri.
- Asambleja e 28-të e WAREG organizuar në muajin qershor në Kosovë, me fokus në çështje që lidhen me rregullimin e ujit në Evropë dhe promovimin e bashkëpunimit rajonal midis vendeve që synojnë t’i bashkohen unionit evropian, ku Shqipëria është përfituese e drejtpërdrejtë. Gjatë asamblesë u prezantua Raporti mbi Treguesit Kryesorë të Performancës ku ERRU ka qenë pjesë e Grupit të Punës, si dhe u bë një përditësim mbi Direktivën e BE-së për Trajtimin e Ujërave të Ndotur Urbane, bazuar në raportet e Parlamentit Evropian.
- Asambleja e 29-të e WAREG e zhvilluar në Malin e Zi në shtator, ku u diskutua në lidhje me zbatimin e programit të punës së WAREG mbi marrëdhëniet me BE-në dhe rritja e bashkëpunimit rajonal midis rregullatorëve përmes projekteve të financuara nga BE. Pjesë e diskutimit ishin edhe ndikimet e pritshme ekonomike të propozimit të BE-së për një Direktivë të re për Trajtimin e Ujërave të Ndotura.
- Asambleja e 30-të në Bruksel përmbledhi arritjet e aktiviteteve vjetore dhe projektet e planifikuara për vitin pasues. Gjithashtu u diskutua mbi Forumin Evropian për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit si dhe “Axehtënda e Gjelbër”, pjesë e axhendës së Rrjetit të Rregullatorëve Ekonomikë (NER) të OECD si kontribuues në ruajtjen e mjedisit.

Angazhimi në WAREG ka vijuar me pjesëmarrjen në **Forum in e 3-të Evropian për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit**, i cili përpos të tjerave shërbeu edhe si një pikë takimi për vendet që janë pjesë e shoqatës së rregullatorëve evropianë dhe ndodhen në proces përafrimi të standardeve mjedisore me BE-në, siç është vendi ynë.

Si pjesë e Rrjetit të Rregullatorëve Ekonomikë (NER), të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim në Evropë (OECD) një platformë ku rregullatorë nga e gjithë bota ndajnë praktikatat më të mira, idetë dhe zgjidhjet inovatore, ERRU mori pjesë në dy takimet vjetore, të mbajtura përkatësisht në 27 prill dhe 1 dhjetor 2023. Sesioni i 20-të i NER kishte në fokus treguesit me të cilët operojnë rregullatorët, rritjen e performancës së tyre përmes të dhënave të sakta. Ndërsa në sesionin e 21-të u prezantuan rezultatet paraprake të Treguesve të GSR 2023 (Governance of Sector Regulation – Qeverisja e Rregullatorëve) që lidhen me tre komponentë: pavarësia, llogaridhënia dhe fusha e veprimtimit.

Si anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (**IWA**), ERRU mori pjesë në konferencën e zhvilluar në Vjenë nga 31 maj deri 2 qershor me temë: “Mënyra të reja për kapërcimin e sfidave në sektorin e ujit”, në të cilën u diskutuan alternativat për tejkalimin e sfidave me të cilat po përballen si pasojë e pandemisë, krizës energjetike dhe veçanërisht ndryshimeve klimatike.

Po ashtu, në 14 - 16 nëntor ERRU mori pjesë në *Samitin Digjital të Ujit*, në Bilbao nën organizimin e IWA, një platformë të përbashkët globale drejt shfrytëzimit të instrumenteve të digjitalizimit për të rritur kapacitetin dhe performancën në sektor. Samiti mbuloi një gamë të gjerë temash thelbësore nga analizimi i të dhënave, matjet inteligjente, modelin “digjital twin” në monitorimin dhe menaxhimin e sektorit e deri tek zgjidhjet teknologjike për ruajtjen e ujit.

1.5.2.2 Bashkëpunimi me Donatorë dhe Aktorë Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë

Ndër donatorët kryesorë që kontribuojnë në fushën e ujit në Shqipëri dhe me të cilët ERRU bashkëpunon është Banka Botërore. Në 7 shkurt, së bashku me ekspertë, donatorë e përfaqësues nga institucionet qeveritare, ERRU u bë pjesë në workshopit të **Bankës Botërore (BB)** “*Siguria e Ujit*” për hartimin e plan veprimeve konkrete për një ujë të sigurt. Qëllimi kryesor i projektit është identifikimi i zonave ku siguria e ujit përbën shqetësim për tu shoqëruar më tej me investimet e nevojshme.

Në qershor, ERRU mori pjesë gjithashtu në seminarin e organizuar nga BB dhe IFC “*Paraqitja e sfidave dhe vlerësimi i mundësive për të realizuar për të gjithë akses të sigurt të ujërave të ndotura*”, në të cilin ERRU mbajti prezantimin me temë: “Rregullatori i Ujit, Situata dhe Sfidat e Sektorit të Ujit në Shqipëri”.

Në vitin 2023, nën koordinimin dhe organizimin e WAREG, ERRU ka përfituar nga programi TAIEX i **Komisionit Evropian**, që konsiston në ofrimin e asistencës teknike për institucionet publike në lidhje me përafrimin, aplikimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE për ujërat.

Në 2023, ERRU është edhe bashkë organizatore me WAREG edhe të dy seminareve rajonale, me mbështetjen e Programit të BE-së. Seminari i parë u zhvillua në qershor, me autoritetet rregullatore të Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut, duke u fokusuar në tematikën e Treguesve Kryesorë të Performancës (KPI) me fokus të veçantë në qasjen e “*Sunshine regulation*” për rregullimin e sektorit UK në Ballkanin Perëndimor.

Seminari i dytë i Programit TAIEX u zhvillua në 21 nëntor me fokus hartimin e planeve të biznesit për shoqëritë UK, si dhe duke dhënë një panoramë të përgjithshme me objektivat kryesorë dhe monitorimin e vlerësimin e performancës; agregimi i sektorit me avantazhet dhe vështirësitë etj.

Një tjetër cikël prej tre seminaresh të rëndësishme të zhvilluara gjatë vitit 2023 ishin për ngritjen e kapaciteteve të stafëve rregullatore ("Capacity Building"), financuar nga **Nisma e Evropës Qendrore (CEI)** nën koordinimin dhe organizimin e Shoqatës Evropiane të Rregullatorëve të Ujit (WAREG) të vendeve të Ballkanit Perëndimor, kandidatë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, si më poshtë:

- Seminari i I-rë u mbajt në Bruksel, në të cilin u trajtua tematika e përballueshmërisë së tarifave të shërbimit të ujit në metodologjitë përkatëse.
- Seminari i II-të në Budva në datën 20 shtator, në të cilin u shkëmbyen përvoja specifike dhe njohuri që rrisin efektivitetin e kompetencave të rregullatorëve në vendosjen e tarifave si dhe në mbështetje të strategjive kombëtare në zbatimin e Direktivës së BE për ujërat.
- Seminari i III-të në Shkup më 16 tetor ku u trajtua roli i TKP në caktimin e tarifave nëpërmjet treguesve për kostot e operim mirëmbajtjes, kostot totale, normën e arkëtimit, UPA me raste konkrete studimore nga rregullatori portugez, ERSAR si dhe ARERA në Itali.

Këto seminare midis rregullatorëve në Ballkanin Perëndimor janë vijimësi e Marrëveshjes së Bashkëpunimit nënshkruar në maj të vitit 2022 në Shqipëri, e cila shënjoji fillimet e një bashkëpunimi për shkëmbimin e eksperiencave mbi sfidat e përbashkëta dhe analizimin e veprimeve specifike për të qenë më eficientë në caktimin e tarifave, e veçanërisht në drejtim të përafrimit të legjislacionit me Direktivën e Bashkimit Evropian për Trajtimin e Ujërave.

Një tjetër aktor i rëndësishëm në fushën e ujit që ERRU bashkëpunon ngushtësisht është **SHUKALB** dhe **SHUKOS**. ERRU ishte pjesë aktive e Konferencës dhe Ekspozitës së 11-të e Përbashkët Ballkanike "Të përshpejtojmë ndryshimin: Drejt Shërbimeve të Sigurta, të Besueshme dhe të Qëndrueshme", zhvilluar në datat 7-9 nëntor. ERRU dha kontributin e saj përmes pjesëmarrjes dhe angazhimit të stafit duke bashkë moderuar një prej sesioneve teknike, ndërsa kryetari i ERRU, në një prej sesioneve mbajti një prezantim me temën: "Amortizim i aseteve si kosto e justifikuar për tarifën e ujit".

Krahas dy shoqatave të mësipërme, ERRU ka bashkëpunuar edhe me **Shoqatën e Shoqërive UK të Maqedonisë së Veriut (ADKOM)**. Kjo e fundit organizoi në muajin tetor Konferencën e 11-të Ndërkombëtare "Shërbimet e Shoqërive UK në Qytete", në të cilën mori pjesë edhe ERRU në panelin "Eksperienca dhe roli i rregullatorit në transformimin digjital", në të cilin prezantoi gjendjen aktuale të digjitalizimit në sektor, si dhe rolin e rregullatorit për përmirësimin e digjitalizimit të shërbimeve.

Në muajin prill, ERRU si pjesë e Konferencës së Ujit organizuar nga **Bashkia e Tiranës** dhe **UK Tiranë**. ERRU u prezantua me temën "Performanca dhe Objektivat e UK Tiranë", në të cilën u paraqiten ecuria dhe problematikat e performancës së UKT-së vitet e fundit nga pikëpamja e rregullatorit.

1.5.2.3 Artikuj Studimorë, Botimet

Gjatë vitit 2023 ERRU ka botuar disa artikuj studimorë me tematika mjaft aktuale për sektorin e ujit. Në muajin shtator në botimin e përmuajshëm të WAREG, si dhe tek "Burimi" i SHUKALB u botua artikulli i kryetarit të ERRU, Z. Ndiriçim Shani: "Parimet e Vendosjes së Tarifave në Evropë dhe Shqipëri", i cili fokusohet në parimet bazë për mbulimin e kostove në fushën e sektorit të FU dhe KUN, bazuar në legjislacionin e BE-së dhe zbatimin e këtyre parimeve në Shqipëri për të përmbushur kushtet e "Acquis Communautaire".

Në muajin tetor u publikuan në të njëjtat të përmuajshme artikulli "Amortizimi i aseteve si kosto e justifikuar për tarifën e shërbimeve të UK", po nën autorësinë e kreut të ERRU Z. Shani, i cili trajton

rëndësinë e vlerësimit të komponentëve të amortizimit në sistemet e FU dhe KUN për efikasitetin e investimeve dhe zëvendësimin e aseteve të vjetruara.

Në muajin dhjetor u dërgua për botim, gjithashtu artikulli *“Transformimi dixhital në sektorin e UK”* me bashkautor kreun e ERRU-së Z. Ndrëçim Shani dhe Z. Klevis Jahaj, Drejtor i Përgjithshëm i AKUK, ku theksohet rëndësia, vlerësohet gjendja e dixhitalizimit në sektor, si dhe jepen rekomandime për të ardhmen.

1.6 Transparenca dhe Marrëdhëniet e ERRU-së me Publikun dhe Median

Gjatë procesit të zbatimit të reformës që agregon 58 shoqëri UK në 15 shoqëri rajonale, çdo vendim apo veprimtari e ERRU-së, si një ndër institucionet e ngarkuara për zbatimin e saj, ka marrë vëmendje mediatike. Ato kanë gjetur pasqyrim në shtypin e shkruar dhe elektronik, kryesisht në mediat me profil ekonomik. Po ashtu, edhe raportet që publikon institucioni, Raporti Vjetor dhe Raporti i Performancës janë analizuar e përcjellë në media, përmes artikujve në portale apo shtypin e shkruar.

Në lidhje me komunikimin me mediat, ERRU iu ka dhënë përgjigje në rrugë zyrtare interesit të tyre mbi zhvillimet në sektorin të ujit, si dhe përmes intervistave televizive. Në një intervistë për *“Vizion +”*, kryetari i ERRU, Z. Ndrëçim Shani ka sqaruar efektet e pritshme të reformës së agregimit të shoqërive UK në shoqëri rajonale si dhe procesin e unifikimit të tarifave, i cili kërkon kohë dhe një analizë të thelluar bazuar në raste konkrete.

Transparenca dhe llogaridhënia ndaj publikut vijon të mbetet një ndër shtyllat kryesore të veprimtarisë, të cilën ERRU e respekton me përpikëri duke publikuar në kohën e duhur në faqen e website erru.al të gjitha vendimet, aktet nënligjore e çdo informacion në interes të konsumatorëve. Të njëjtat parime zbatohen edhe në postimet e saj në rrjetet sociale: *“LinkedIn”*, *“Facebook”* e *“Instagram”* që pasqyrojnë ecurinë e punës së rregullatorit pranë zyrave si dhe në terren.

Gjithë informacionet e prodhuara nga institucioni dhe në interes të qytetarëve gjenden të përmbledhura te *“Programi i Transparencës”* në faqen zyrtare të ERRU. Gjatë vitit 2023 kanë ardhur dy kërkesa për informacion, të cilat kanë marrë përgjigje brenda afateve ligjore e gjithashtu janë publikuar bashkë me përgjigjen e kthyer nga institucioni në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.

1.7 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së

1.7.1 Të Ardhurat

Burimi i financimit të veprimtarisë së ERRU janë pagesat rregullatore të shoqërive UK, si dhe pagesat për licencimin e tyre, sikurse përcaktohet në ligjin 8102 datë 28.03.1996 *“Për kuadrin rregullator të sektorit të FU dhe largimit e përpunimit të UN”*, i ndryshuar. ERRU ka nënshkruar kontrata me shoqëritë UK për aplikimin e tarifave të miratuara, ku është përcaktuar tarifa rregullatore vjetore dhe afatet e pagesës.

Detyrimi vjetor i pagesave rregullatore për vitin 2023, mbështetur në kontratat me 13 shoqëritë rajonale dhe 5 Shoqërive UK është në shumën 54 971 067 lekë, ndërsa detyrimi i pagesës rregullatore i mbartur nga vitet paraardhëse është 41 180 459 lekë.

Arkëtimet totale të ERRU të realizuara gjatë vitit 2023 janë në shumën totale 73 338 203 lekë nga të cilat nga pagesat rregullatore janë 70 558 203 lekë dhe nga licencimet 2 780 000 lekë, që jepen të detajuara në Tabelën 4.

Tabela nr.4. Realizimi i Arkëtimeve sipas zërave

Nr.	Arkëtime gjatë vitit 2023	Vlera/ lekë
1	Nga pagesat rregullatore të prapambetura	27, 712, 984
2	Nga pagesat rregullatore të vitit 2023	42, 845, 219
3	Nga pagesat e licencimit	2,780, 000
Totali		73, 338, 203

Për mbledhjen e detyrimeve të papaguara shoqërive UK gjatë vitit 2023 u është kërkuar përmbushja e detyrimit si dhe janë nënshkruar aktmarrëveshje për shlyerjen me këste, kryesisht brenda një viti. Disa shoqëri të cilat nuk kanë paguar vullnetarisht detyrimin sipas vendimit gjyqësor janë në proces për mbledhjen me forcë të tij nga zyra e përmbarimit.

Shlyerja e detyrimeve të pagesës ndaj ERRU-së për licencimin ka qenë e rregullt duke qenë se është detyrim paraprak i shoqërive UK për t'u licencuar.

Likuiditetet në vitin 2023 garantojnë tërësisht mbështetjen financiare për ushtrimin e aktivitetit të ERRU-së për vitin 2024, duke mbuluar tërësisht shpenzimet e parashikuara vjetore.

1.7.2 Shpenzimet Operative


Administrimi i vlerave materiale e monetare në ERRU kryhet në përputhje të plotë me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik" dhe rregullores së brendshme të ERRU "Për menaxhimin e aktiveve".

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së propozohet nga ajo vetë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të FU dhe largimit e përpunimit të UN", i ndryshuar.

Plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU-së, për vitin 2023, është miratuar me VKM nr. 884, datë 27.12.2022, "Për miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2023, për ERRU-në, që është ndryshuar dhe miratuar më pas me VKM nr. 599 datë 18.10.2023 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 884 datë 27.12.2022". Fondi i miratuar për shpenzimet operative është 65.093.460 lekë.

KKRR me vendimin nr. 1, datë 17.01.2023, ka detajuar planin vjetor të miratuar nga Këshilli i Ministrave në artikuj të shpenzimeve në përputhje me nevojat e domosdoshme për të garantuar mbështetjen logjistike për përmbushjen e objektivave vjetorë të ERRU-së, zhvillimin e veprimtarive të parashikuara dhe funksionimin normal të veprimtarisë së përditshme.

Plani vjetor është detajuar në katër zërat kryesorë: paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, shërbime e furniturë dhe investime sipas raporteve në përqindje që paraqiten në Grafikon 1, si më poshtë:




Grafiku nr.1. Struktura e Planit të Shpenzimeve Operative të Vitit 2023

Shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të veprimtarisë vjetore të ERRU-së gjatë vitit 2023, janë në shumën 59 904 358 lekë, ose 92% të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative. Realizmi i shpenzimeve në zëra dhe në vlera paraqiten si më poshtë:

- 41 020 627 lekë / 96%, shpenzime për pagat e punonjësve;
- 6 452 675 lekë / 95% shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore;
- 11 931 057 lekë / 78% shpenzime për shërbime e furniturë;
- 499 999 lekë / 100% shpenzime për investime.

Plani i miratuar i shpenzimeve operative të ERRU krahasuar me shpenzimet e realizuara paraqitet në vijim në formë grafike:



Grafiku nr.2. Plani i Shpenzimeve të miratuara nga KM krahasuar me shpenzimet e realizuara

Shpenzimet kanë rezultuar me të vogla se planifikimi për shkak të shpenzimeve të porealizuara për shpenzimet për pagat dhe sigurimet për punonjësit, si dhe nga disa kursime për shërbimet dhe furniturën.

2 Zbatimi i Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për Vitin 2023

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2023, referuar Raportit të Aktivitetit të Entit Rregullator të Ujit (ERRU), për vitin 2022 përcakton angazhimet në drejtim të institucionit të ERRU-së për vitin 2023, realizimi i të cilave cituar sipas numrit rendor përkatës në të, rezulton si më poshtë:

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2023 ka rekomanduar :

1. *ERRU në kuadër të reformës rrënjësore në sektorin UK, e cila agregon sektorin UK në 15 shoqëri, të ketë prioritet në punën e saj bashkëpunimin me MIE, AKUK, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të bërë të mundur implementimit me sukses të kësaj reforme të rëndësishme.*

Ecuria:

- Aktualisht janë formuar dhe licencuar nga ERRU 13 shoqëri rajonale (SKP) nga 15 shoqëri që ka planifikuar reforma e agregimit për të gjithë sektorin. ERRU ka zhvilluar vazhdimisht takime pune me AKUK për problemet që janë hasur gjatë implementimit të reformës. Nga problemet kryesore që janë diskutuar kanë qenë procesi i licencimit të SKP-ve, si dhe tarifat që këto të fundit duhej të zbatonin për konsumatorët gjatë fazës tranzitore. Më tej me rëndësi të veçantë ka qenë diskutimi mbi përgatitjen e propozimit për tarifa të reja si një nga elementët kyç të reformës për përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të sektorit.

Janë sqaruar mjaft çështje mbi principet e përgatitjes së propozimit të tarifave bazuar në veçoritë e sistemit të FU në zonën e shërbimit përkatësisht me ngritje mekanike dhe/ose me vetërrjedhje (Korça). ERRU ka argumentuar dhe bindur shoqëritë se kjo skemë, pavarësisht logjikës në dukje nuk mund të aplikohet për përgatitjen e propozimit për tarifa të reja. Propozimi për tarifa të reja duke patur parasysh unifikimin e tarifës për të gjithë zonën e shërbimit të SKP-së, kushtëzohet edhe nga faktorë të tjerë, si diferencat e konsiderueshme aktuale për njësi (qytete) të ndryshme brenda zonës së shërbimit etj. Në këtë kuadër, ERRU ka përshtatur modelin e aplikimit (Excel) që të pranojë nga maksimumi 2 në 3 nivele të tarifave të ndryshme të propozuara brenda zonës së shërbimit (Durrësi).

Në mbështetje të procesit të aplikimit për tarifa të reja, ERRU është angazhuar për të nxitur aplikimet, si një nga elementët kyç për përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive. Konkretisht KKRR ka marrë vendime për shtyrjen e afateve të pranimit të propozimeve për tarifa të reja nga 30 qershori, në 30 gusht dhe më tej me kërkesën e AKUK përfundimisht ky afat u shty deri më 30 shtator 2023. Si përfundim, pranë ERRU-së aplikuan për nivel të ri tarifor 7 shoqëri UK nga të cilat 6 të organizuara si shoqëri UK rajonale. KKRR pasi shqyrtoi aplikimet mori vendim për refuzimin e aplikimeve për shoqëritë UK Rajonale Berat, Elbasan dhe Shkodër për mungesa të theksuara dokumentacioni, si dhe vendosi për fillimin e procedurës për shoqëritë UK Rajonale Durrës, Fier, Lezhë dhe UK Vlorë. Ndërsa për tre shoqëritë e para aplikimet e tyre janë

në proces analize, për shoqërinë UK Vlorë ky proces ka përfunduar dhe KKRR me vendimin nr. 58, datë 27.12.2023, vendosi “Për miratimin e tarifave të shërbimit të FU dhe largimin e UN për shoqërinë UK Vlorë sh.a”. Vendimi ndryshon nivelin tarifor për tarifatat variabël, por jo në nivelet e propozuara nga shoqëria.

Gjatë gjithë kësaj periudhe ERRU ka kryer vizita në vend dhe ka vënë në dispozicion të gjithë stafin e saj në ndihmë të shoqërive rajonale për përgatitjen e propozimeve për tarifa të reja. Në këto vizita, krahas ndihmës për konceptimin dhe përgatitjen e aplikimit, është vënë theksi në zbatimin me rigozitet të seancave dëgjimore me publikun në komunikimin dhe diskutimin e tarifave të reja me to.

2. *ERRU, në kuadër të reformës në sektorin UK, të marrë masat e nevojshme për t’ju përgjigjur në kohë pajisjes me licencë shoqërive rajonale të reja të krijuara nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, në përputhje me kategorinë përkatëse të shërbimit të ofruar dhe rishikimin e tarifave ekzistuese.*

Ecuria:

- Deri në fund të vitit 2023, kanë aplikuar pranë ERRU 11 shoqëri UK Rajonale dhe janë licencuar 11 prej tyre përkatësisht, UK Rajonale Kukës, Durrës, Gjirokastrë, Berat, Fier, Lushnje, Pogradec, Elbasan, Sarandë, Dibër, Shkodër, që duke i shtuar dhe dy shoqëritë e licencuara gjatë vitit 2022 (Korçë dhe Lezhë), në total janë licencuar 13 shoqëri rajonale. Gjithashtu pritet që në fillim të vitit 2024 të aplikojë edhe UK Rajonale Vlorë.

3. *ERRU duke qenë pjesë e grupit ndërinstucional të punës të ngritur nga MIE sipas urdhrin nr. 165, datë 08.09.2022 për “Hartimin e strategjisë sektoriale të shërbimeve të FU dhe KUN 2020-2030, të projektligjit dhe rregullores së standardeve të shërbimit të FU dhe KUN në Shqipëri”, të ndikojë në rishikimin e ligjit nr. 8102 duke patur parasysh forcimin e rolit të rregullatorit si institucion i pavarur dhe të performancës së tij në shërbim të rritjes së performancës së sektorit në përgjithësi.*

Ecuria:

- ERRU ka marrë pjesë aktive në diskutimet dhe ka dhënë rekomandimet e saj për përmirësimin e dokumentit të Strategjisë Sektoriale të Shërbimeve UK 2020-2030, dokument tashmë i aprovuar nga Kuvendi.
Ligji nr. 8102 dt. 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të FU dhe largimit dhe përpunimit të UN”, i ndryshuar daton prej 26 vitesh, në të cilin amendimi i fundit është bërë me ligjin nr. 9915, dt. 12.5.2008, pra rreth 15 vjet më parë. Është evidentuar me kohë nevoja për rishikime të mëtejshme në mënyrë që ky ligj t’i përgjigjet kërkesave të kohës për sektorin e ujit.
Rishikimi i tij ka qenë subjekt i Grupit të Punës ngritur me urdhër të Ministrit Transportit dhe Infrastrukturës, nr. 4284, datë 2.9.2016, si dhe vazhdimisht pjesë e detyrave të Rezolutave të Kuvendit. Ky proces është ndërprerë sepse bazuar në urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 581, datë 18.07.2018, u vendos që të hartohet një ligj i ri për sektorin.
Në lidhje me projektligjin për sektorin UK, janë dhënë sugjerimet tona për forcimin e rolit të rregullatorit si institucion i pavarur, të cilat janë marrë pjesërisht parasysh.

Megjithëse projektligji paraqet përmirësime të dukshme krahasuar me draftin e mëparshëm, kemi insistuar që akoma ky projektligj ka mjaft trajtime të karakterit të përgjithshëm e të panevojshëm, si dhe në mjaft raste ka nene me karakter teknik që për shkak të dinamizmit të tyre në kohë nuk duhet të jenë pjesë e ligjit, por që duhet të jenë subjekt i kompetencave të institucioneve të tjera, kryesisht të ERRU-së. Theksohet si mjaft e rëndësishme që të merren parasysh rekomandimet e ERRU-së në lidhje me profilet që duhet të kenë anëtarët dhe Kryetari i Komisionit Rregullator të ERRU-së. Projektligji është në përfundim të procesit të konsultimit publik, si dhe me të gjithë aktorët kryesorë të sektorit (ministritë përkatëse) përpara se të ndjekë hapat e mëtejshme institucionale deri në miratimin e tij në Kuvend.

Në lidhje me draft *regulloren e standardeve të shërbimit të FU dhe KUN*, akoma nuk është organizuar mbledhje për GP për të diskutuar mbi draftin e ri të saj. Gjithsesi ERRU insiston fort që ky dokument kryesisht teknik që rregullon marrëdhëniet shoqëri UK-konsumator duhet të jetë kompetencë për rishikim dhe aprovim nga ERRU, kuptohet në bashkëpunim me aktorët e tjerë të sektorit të ujit. Krahas bazës juridike, argumenti i mësipërm, mbështetet edhe nga rekomandimet që ka dhënë vazhdimisht konsulencia ndërkombëtare për këtë dokument.

4. *Në kuadër të hapjes së negociatave me BE, të kontribuojë dhe të jetë pjesë aktive e grupeve të punës lidhur me kërkesat që Shqipëria duhet të përmbushë në lidhje me Direktivat Evropiane për Ujin e Pijshëm, Ujërat e Ndotura dhe të Llumrave të ITUN .*

Ecuria:

- Në zbatim të nenit 52/2 të ligjit nr. 9908/2008 “Për mbrojtjen e Konsumatorit” i ndryshuar, ERRU-së i është ngarkuar krijimi i një strukture të veçantë për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve për veprimtaritë në fushën e FU dhe KUN si një shërbim me interes të theksuar publik. Ky funksion i rregullatorit është përcaktuar në harmonizim me Direktivën 2013/11/EU “Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve” të Parlamentit Evropian.
Në muajin Shkurt 2023, ERRU ka qenë pjesë raportuese e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për Nën kapitullin 28 “Mbrojtja e Konsumatorit” pranë Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR). ERRU raportoi me informacionin e duhur mbi përmbushjen e këtij detyrimi sipas direktivës Evropiane.

5. *ERRU, gjatë monitorimeve të shoqërive UK në terren si dhe gjatë procesit të miratimit të tarifave ti kushtojë vëmendje të veçantë rritjes së Efiçencës së Energjisë përmes përdorimit të burimeve alternative të rinovueshme nga shoqëritë UK, si një nga sfidat kryesore për përmirësimin e performancës financiare të shoqërive në kushtet kur rritja e çmimit të energjisë elektrike ka patur ndikim të drejtpërdrejt në përkeqësimin e treguesit të Mbulimit të kostove të O&M.*

Ecuria:

- Për vitin 2022, kostot e energjisë për sektorin përbënin 34% të kostove të O&M, që në fakt patën një rritje me rreth 40% krahasuar me vitin 2021 për shkak të dyfishimit të çmimit të energjisë elektrike.

Qeveria qendrore gjatë vitit 2023 ka luajtur një rol pro aktiv për rishikim të çmimit të energjisë për shoqëritë UK, ku përmes AKUK i ka bërë kërkesë ERE për rishikimin e çmimeve të energjisë elektrike për këto shoqëri. Sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 8 të VKM nr.456/2022 shoqëritë UK janë klientë me status të veçantë. Bordi i ERE, në vijim të kësaj kërkesë, me vendimin nr.16, datë 06.02.2023 vendosi për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2023, prej **9.33 lekë/kWh** për shoqëritë UK të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV dhe **11.77 lekë/kWh** për shoqëritë UK të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 Kv në ndryshim nga çmimi i mëparshëm i vitit 2022 prej 18 lekë/kWh i cili dha impaktin kryesor në rritjen e kostove të energjisë me rreth 40% krahasuar me vitin paraardhës 2021.

Gjithsesi, nisur nga pritshmëria e pranisë së zgjatur të krizës energjitike, metodologjia e re e tarifave ka përfshirë në listën e TKP edhe treguesin e Eficences së Energjisë. Për vitin 2022 ky tregues ka qenë në vlerën 0,65 kwh për çdo m³ ujë të pompuar ndërsa në vitin 2023 rezultoi 0,5 kwh për çdo m³ ujë të pompuar.

ERRU inkurajon shoqëritë UK për gjetjen e burimeve alternative të rinovueshme të energjisë elektrike, por kjo politikë varet kryesisht nga investimet dhe angazhimet e qeverisë qendrore nëpërmjet AKUK, si aksionari kryesor i shoqërive rajonale.

6. *Të vijojë punën për procesin e monitorimit të shoqërive UK për procedurat e trajtimit të ankesave të konsumatorëve, mekanizmeve për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin të konsumatorëve në drejtim të ofrimit të shërbimit UK, duke lenë rekomandime përkatëse për t'u realizuar nga ata.*

Ecuria:

- Në përmbushje të objektivave institucionale për mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet monitorimit apo krijimit të mekanizmeve për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin të konsumatorëve në drejtim të ofrimit të shërbimit UK, ERRU gjatë seancave dëgjimore të zhvilluara me konsumatorët për nivelin e ri tarifor të propozuar nga shoqëritë UK, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë krijimit nga ana e shoqërive rajonale UK të strukturave përkatëse të kujdesit ndaj klientit. ERRU në funksion të trajtimit të ankesave të konsumatorëve ka zhvilluar monitorimin dhe verifikimin në terren të mënyrës së trajtimit të ankesave për shoqërinë Rajonale UK Durrës dhe shoqërinë UK Kamëz.

7. *ERRU në kuadër të reformës rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri, duhet të bashkëpunojë me institucionet kryesore në mënyrë që të ketë një shpërndarje të drejtë të investimeve për shoqëritë UK, duke i parë ato si të lidhura me përmbushjen e objektivave të caktuara nga ERRU dhe duke shërbyer si element nxitës për shoqëritë për përmirësimin e Ujit Pa të Ardhura dhe treguesve të tjerë të performancës. Në të njëjtën kohë, ERRU, gjatë procesit të aplikimit për nivel të ri tarifor nga shoqëritë UK, të kërkojë vendosjen e objektivave konkrete nga shoqëritë UK në reduktimin e humbjeve administrative dhe fizike, si lidhjet e paligjshme, nënfaturime dhe për abuzimet e ndryshme për ujitje etj.*

Ecuria:

- Nga ana ligjore ERRU nuk është e përfshirë në lidhje me shpërndarjen e investimeve për shoqëritë UK. Për këtë janë bërë sugjerimet e nevojshme në draft-ligjin e ri për sektorin UK që ERRU të mund të kontribuojë për një shpërndarje të drejtë të investimeve për shoqëritë. Gjithsesi, në metodologjinë e re të vendosjes së tarifave “Çmimi Tavan”, ERRU mund të vlerësojë efektivitetin e investimeve në drejtim të përmirësimit të TKP që kanë qenë parashikuar në Planin 5 Vjeçar të Biznesit të shoqërisë. Kur shoqëritë aplikojnë për tarifa të reja, ERRU zbaton praktikën e vendosjes së objektivave agresive mbi TKP për të ardhmen, sidomos për reduktimin e humbjeve administrative dhe fizike. Këto objektiva janë pjesë e vendimit të KKRR për miratimin e tarifave të reja, praktikë kjo e ndjekur edhe në rastin e aplikimit për nivel të ri tarifor të shoqërisë UK Vlorë sipas tabelës nr.5 të mëposhtme.

Tabela nr. 5, Treguesi i Ujit Pa të Ardhura

Nr.	Shoqëria	Treguesi i UPA Vitit 2022 (në %)	Objektivi i Shoqërisë UPA ,viti 2024 (në %)	Objektivi nga ERRU UPA, viti 2024 (në %)
1	UK Vlorë	75.16	69.33	65

Siç shihet nga tabela e mësipërme ERRU është treguar dukshëm me agresiv në vendosjen e objektivit të UPA për shoqërinë UK Vlorë krahasuar me atë të parashikuar nga vetë shoqëria, që ERRU e ka mbështetur nga nja analizë e detajuar tekniko - ekonomike të realizuar, e cila ka nxjerrë në pah mundësitë reale që ka kjo shoqëri për përmirësimin e këtij treguesi.

- 8.** ERRU, në kuadër të reformës, të vijojë të luajë një rol pro-aktiv duke ndërmarrë vendimet e nevojshme si dhe duke zhvilluar takime me drejtuesit e rinj të shoqërive UK Rajonale të krijuara, me qëllim diskutimin e pengesave të ndryshme që hasen për zbatimin e reformës gjatë periudhës tranzitore, si dhe rekomandimet për zgjidhjen e tyre në zbatim të ligjit nr. 8102.

Ecuria:

- ERRU vazhdimisht ka mbajtur kontakte me drejtuesit e shoqërive rajonale për të diskutuar dhe zgjidhur problemet dhe pengesat gjatë zbatimit të reformës. Në këtë kuadër janë organizuar vizita në vend për shoqëritë rajonale Durrës, Korçë, Lezhë, Fier, Lushnje, Berat, Pogradec, Sarandë dhe Gjirokastrë. Takimet janë zhvilluar në ambientet e ERRU-së, përfshirë edhe stafin kyç të menaxhimit të këtyre shoqërive. Fokusi kryesor i këtyre takimeve ka qenë, krahas problemeve të licencimit, përgatitja për të përmbushur kërkesat e metodologjisë për propozimet për tarifa të reja pranë ERRU-së. Si kusht i detyrueshëm dhe i pa tolerueshëm nga ana e ERRU-së, është kujdesi i veçantë që shoqëritë rajonale duhet ti kushtojnë organizimit me seriozitet dhe me pjesëmarrje

sa më të gjerë të publikut të seancave dëgjimore që shoqëria duhet të realizojë me aprovimin dhe pjesëmarrjen si dëgjues nga ERRU.

9. *ERRU në kuadër të reformës rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri, të ketë në fokus kryesor të vëmendjes reduktimin e stafit të tepërt të shoqërive UK rajonale kur këto do të aplikojnë për tarifa të reja pranë saj, si dhe të monitorojë dhe rekomandojë nivelin e pagave dhe shpërblimeve që ndikojnë në shpenzime.*

Ecuria:

- Kostot e punës (stafit) për vitin 2023 zënë 53 % të kostove O&M në sektorin UK. Kur shoqëritë rajonale do të aplikojnë për tarifa të reja pranë ERRU-së, ky komponent i kostove është në fokusin e analizës së kostove që ato të jenë të justifikueshme nga ERRU.
ERRU është duke përpunuar një strategji apo metodologji të veçantë për një analizë sa më objektive dhe efikase të organogramës së shoqërisë për specifikat e sektorit në vendin tonë, në mënyrë që të mund të reduktohet sa më shumë të jetë e mundur abuzimet e karakterit të ndryshëm me këtë zë të kostove.

10. *Me hyrjen në fuqi të reformës, ERRU-ja të bashkëpunojë me institucionet përkatëse duke vlerësuar nevojat dhe fondet e nevojshme për realizimin e monitorimeve dhe të sigurisë së veprave të sistemeve të FU dhe KUN, dhe njëkohësisht të bashkëpunojë me MIE për rishikimin e legjislacionit ligjor për të vendosur në baza konkrete dhe me kosto të arsyeshme garantimin e sigurisë së objekteve me karakter strategjik të sistemeve të FU.*

Ecuria:

- Siç është përmendur në të gjithë raportet vjetore të performancës, ERRU do të vazhdojë të nxisë vëmendjen për zgjidhjen e këtij problemi që lidhet ngushtësisht me uljen e kostove të stafit që angazhohet me sigurinë e objekteve (roje), për më tepër kur këto shërbime i nënkontraktohen subjekteve private të licencuara për sigurinë që nënkupton kosto akoma më të mëdha për shoqërinë UK. Krahas rishikimit të legjislacionit, ERRU propozon zgjidhje të karakterit teknik që garantojnë mos aksesin në këto objekte të faktorëve të jashtëm, si dhe të survejimit me mjete dhe metoda të dixhitalizuara.

3 Niveli i Zbatueshmërisë së Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura nga Ekzekutivi

ERRU, si institucion i pavarur dhe aktor kryesor në sektorin UK jep në mënyrë të vazhdueshme kontributin e tij me rekomandime konkrete në adresë të qeverisë qendrore për përmirësimin e sektorit UK. Rekomandimet e kanë bazën në njohjen e thellë që ERRU ka për sektorin UK si edhe në eksperiencën tashmë 25 vjeçare në rregullimin e sektorit të ujit në Shqipëri dhe më gjerë. Në raportin vjetor të aktivitetit të ERRU-së për vitin e mëparshëm 2022 dërguar pranë Këshillit të Ministrave dhe të prezantuar në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë nga Kryetari i ERRU, si dhe në Raportin e Performancës për shoqëritë UK të vitit 2022 janë dhënë disa rekomandime të cilat ERRU i vlerëson si të arsyeshme për tu marrë në konsideratë nga qeveria qendrore, si më poshtë:

- *Në vijim të vendimit të qeverisë qendrore nr.302, datë 11.05.2022 mbi agregimin e sektorit nga 58 shoqëri UK në 15 shoqëri SKP-UK Rajonale, të intensifikohen përpjekjet për përfundimin e agregimit të sektorit me mbështetjen e duhur institucionale, financiare dhe me asistencë për shoqëritë që akoma nuk janë agreguar.*

Gjatë vitit 2023 reforma në sektorin UK nën drejtimin e AKUK, ka ecur me ritme të shpejta ku deri në mbyllje të vitit janë krijuar 14 shoqëri UK Rajonale (13 janë të licencuara) nga 15 që parashikon reforma dhe konkretisht ka mbetur pa u krijuar vetëm shoqëria rajonale UK Tiranë, e cila do të ketë në përbërje të saj bashkitë Tiranë, Kamëz dhe Vorë. Pritet që krijimi i kësaj shoqërie të konkretizohet mbas zgjidhjes së disa problematikave me karakter teknik.

- *Të vijohet sa më parë nga AKUK me një analizë më të thelluar me mbështetje të asistencës edhe të donatorëve në lidhje me hartimin e Planeve 5 Vjeçare të Biznesit për shoqëritë UK të reja rajonale, në të cilat përcaktohen objektivat, nevojat për investime, si dhe dinamika e tarifave drejt mundësisë së unifikimit të tyre për zonën rajonale të shërbimit.*

Qeveria qendrore nën drejtimin e AKUK i ka dhënë një rëndësi të veçantë nevojës për hartimin e planeve të biznesit për të gjitha shoqëritë UK Rajonale të krijuara sipas reformës. Kështu, në kuadër të projektit për "Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të FFU dhe KUN" sipas Ligjit nr. 25/2023, datë 23.03.2023 "Mbi Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim", në nëntor të vitit 2023 ndërmjet AKUK dhe ERRU u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi mbi 'Hartimin dhe Miratimin e Modelit të Planeve 5 vjeçare të Biznesit për Shërbimet e FU dhe KUN'. Qëllimi i kësaj marrëveshje është hartimi nga ERRU i një modeli dhe udhëzuesi të unifikuar për Planet 5 vjeçare të Biznesit të përgatitura nga operatorët e ofrimit të shërbimeve UK i cili do të jetë i detyrueshëm për tu zbatuar nga të gjithë aktorët në sektor si shoqëritë UK, konsulentët dhe donatorët. Kjo përbën një hap të rëndësishëm në cilësinë e hartimit të këtij dokumenti, i cili më tej duhet të shoqërohet me fondet përkatëse për asistencën e nevojshme të konsulentëve që do të ndihmojnë këtë proces në shoqëritë UK. Realizimi i këtij rekomandimi duhet të konsiderohet me prioritet për ato shoqëri rajonale që kërkojnë të aplikojnë për tarifa të reja pranë ERRU-së në vitin 2024 dhe që me tarifat e propozuara synojnë të mbulojnë mbi 100% të kostove të O&M.

- *Nisur nga problematika e kostove të energjisë që aktualisht zënë rreth 50% të kostove operative të sektorit, të realizohet sa më shpejt një analizë "due diligence" për sektorin për strategjinë e*

çmimeve të energjisë elektrike për sektorin UK në drejtim të mundësisë së pagesës së faturës së energjisë elektrike nga shoqëritë rajonale UK dhe ato të parajonalizuara duke marrë parasysh kriterin e përballueshmërisë së pagesës së faturës së ujit nga konsumatorët dhe/ose subvencionimin e tyre.

Në këtë drejtim qeveria qendrore gjatë vitit 2023 ka luajtur një rol pro aktiv ku përmes AKUK i ka bërë kërkesë ERRE për rishikim të çmimit të energjisë për shoqëritë ujësjellës kanalizime, të cilat sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 8 të VKM nr.456/2022 janë klientë me status të veçantë. Bordi i ERRE, në vijim të kësaj kërkesë, me vendimin nr.16, datë 06.02.2023 vendosi për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2023, prej **9.33 lekë/kWh** për shoqëritë UK të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV dhe **11.77 lekë/kWh** për shoqëritë UK të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 Kv në ndryshim nga çmimi i mëparshëm i vitit 2022 prej 18 lekë/kWh, i cili dha impaktin kryesor në rritjen e kostove të energjisë me rreth 40% krahasuar me vitin paraardhës 2021.

- *Në përgjigje të krizës aktuale globale energjitike dhe të elementeve të pasigurisë edhe për vendin tonë, të shihet si prioritet hartimi i Planeve të Rritjes së Eficences së Energjisë për shoqëritë UK, fillimi sa më shpejt i zbatimit të konkluzioneve të tyre, si dhe financimit të nevojave që ato parashikojnë si domosdoshmëri për rritjen e eficences së energjisë elektrike.*

Aktualisht, 21 ish shoqëri UK para rajonalizimit kanë planet e eficences së energjisë të hartuara me mbështetjen financiare të programit të GIZ. Është e nevojshme që studime dhe dokumente të tilla, krahas planeve 5 vjeçare të biznesit, duhet të jenë të hartuara për të gjitha shoqëritë rajonale. Efiçenca e energjisë duhet të jetë në fokus të AKUK, pasi ky zë shpenzimesh mbetet kryesor dhe pritshmëria është që mund të ketë akoma rritje për shkak të situatës energjitike në rang global dhe të ndryshimit të kushteve të klimës. Fokusi duhet të jetë kryesisht në shoqëritë që pjesën më të madhe të sistemeve të FU e kanë me ngritje mekanike. Këto shoqëri duhet të studiojnë mundësitë për burime alternative të pavarura furnizimi me energji elektrike të rinovueshme në mënyrë që të kenë mundësinë për uljen e kostove të këtij zëri. Gjithsesi ky rekomandim mbetet të jetë prioritet për çdo shoqëri rajonale për tu realizuar në vazhdim sa më shpejt të jetë e mundur.

- *Të planifikohen dhe alokohen fondet përkatëse për pajisjen e të gjithë sistemeve të FU, me ujëmatës të mëdhenj në burim, në mënyrë që shoqëritë UK të kenë mundësinë e hartimit të saktë të Bilanceve të Ujit duke njohur kështu gjendjen reale të kërkesës për ujë, si dhe nevojën për uljen e humbjeve fizike dhe administrative në sistemet e furnizimit me ujë.*

Megjithëse pajisja me ujëmatës individualë me qëllim arritjen e objektivit 100% të mbulimit të klientëve me ujëmatës ka patur përmirësim të vazhdueshëm nga investimet e kryera në këtë drejtim, AKUK në kuadër të reformës dhe objektivit për përmirësimin e treguesit të **Ujit Pa të Ardhura**, duhet ti kushtojë një vëmendje të shtuar vendosjes së ujëmatësve të mëdhenj në burim për të gjithë shoqëritë UK rajonale në mënyrë që të përcaktohet realisht kërkesa për ujë dhe hartimi i saktë i bilanceve të ujit. Deri tani nuk është planifikuar ndonjë fond i veçantë nga AKUK vetëm për këtë zë, prandaj mbetet për tu konsideruar në vitin në vazhdim realizimi i këtij rekomandimi.

- *Duke qenë se qeveria qendrore është aksionare e shumicës së aksioneve në të gjitha shoqëritë rajonale UK, duhet të evidentohet më qartë dhe të forcohet roli i ERRU si institucion i pavarur për të monitoruar sektorin UK në mënyrë që vlerësimi i performancës së tij të realizohet në*

mënyrë sa më transparente dhe objektive për të pasqyruar sa më saktë gjendjen e performancës, të problematikave, si edhe të rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e tij.

Në zbatim të Programit Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, ERRU ka nënshkruar në nëntor 2023 një marrëveshje me AKUK, mbi “Raportimin e të dhënave të shoqërive UK pranë sistemit të integruar të informacionit të performancës” (IPIS) e cila konsiston në krijimin dhe përdorimin, nga të dy palët, të një sistemi të integruar mbi të dhënat dhe treguesit kryesorë të performancës, të mbledhura nga operatorët e ofrimit të shërbimeve të UK. Ngritja e këtij sistemi do ti shërbejë përmirësimin të vlerësimit dhe monitorimit të performancës operationale dhe financiare të shoqërive UK në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve.

- *Duke qenë se investimet fizike janë të lidhura ngushtë me tarifën e shërbimeve dhe të cilësisë së shërbimeve UK, duhet të krijohet mundësia e përfshirjes së Rregullatorit (ERRU) në komisionet ad-hoc edhe ato teknike në MIE/AKUM të shqyrtimit të nevojës për investime në sektor, si dhe të vlerësimit të projekteve përkatëse të tyre.*

ERRU, ka bërë sugjerimet e nevojshme në draft ligjin e ri për sektorin UK, i cili nuk është miratuar akoma në mënyrë që ERRU të mund të kontribuojë për një shpërndarje të drejtë të investimeve për shoqëritë.

- *Shoqëritë rajonale duhet të hartojnë Planet e Menaxhimit të Aseteve si instrumenti bazë që justifikon kërkesat dhe nevojat për financimin e investimeve fizike, si dhe efikasitetin e pritshëm të tyre në operimin e shoqërisë dhe uljen e kostove të tyre.*

AKUK, në vijim të reformës për agregimin e shoqërive UK, me qëllim ecurinë sa më efektive të tyre duhet të ketë në vëmendje hartimin e Planeve të Menaxhimit të Aseteve për të gjitha shoqëritë UK Rajonale si një domosdoshmëri për një planifikim sa më të drejtë dhe efikas të investimeve. Gjithsesi ky rekomandim mbetet të jetë prioritet për çdo shoqëri rajonale për t’u realizuar në vazhdim sa më shpejt të jetë e mundur.

4 Ecuria e Reformës në Sektorin UK sipas VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 dhe Problematikat

Reforma në sektorin UK u ndërmor nga qeveria qendrore në maj të vitit 2022 sipas VKM nr.302 e cila e synon agregimin e sektorin UK në 15 shoqëri UK rajonale, nga një sektor i fragmentarizuar në 58 shoqëri UK në 61 bashki të vendit. Objektivi kryesor i reformës ishte që nëpërmjet ekonomisë së shkallës të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve UK.

Ky proces filloi në vitin 2022 me rajonalizimin e dy shoqërive UK Lezhë dhe UK Korçë. Gjatë vitit 2023 procesi i rajonalizimit hyri në një fazë të plotë transformimi të sektorit me formimin e 14 shoqërive UK Rajonale të krijuara nga totali prej 15 të tilla të parashikuara në reformë, konkretisht shoqëritë UK Rajonale *Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Durrës, Fier, Lushnje, Sarandë, Elbasan, Korçë, Pogradec, Berat, Gjirokastër dhe Vlorë*.

Në vitin 2023 kanë filluar ushtrimin e aktivitetit si shoqëri rajonale 13 prej tyre UK Rajonale Vlorë pritet të fillojë aktivitetin në fillim të vitit 2024.

Procesi i riorganizimit është ndjekur me angazhim të plotë nga ERRU e cila ka luajtur një rol pro aktiv gjatë këtij procesi duke licencuar në kohë shoqëritë UK rajonale të krijuara sipas reformës. Si përfundim, deri në mbyllje të vitit 2023 nga ERRU janë licencuar 13 shoqëri UK rajonale nga 14 të krijuara me përjashtim të UK Rajonale Vlorë, e cila pritet të aplikojë akoma pranë ERRU-së në fillim të vitit 2024.

Mbetet akoma pa u krijuar shoqëria Rajonale *UK Tiranë* e cila përfshin bashkitë Tiranë, Kamëz dhe Vorë. Aktualisht nuk janë nënshkruar akoma marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet këtyre shoqërive, por gjithsesi këshillat bashkiake të këtyre bashkive kanë marrë vendimet përkatëse të cilat autorizojnë kryetarët e bashkive për të nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me MIE dhe më pas transferimit drejt shoqërisë UK Rajonale Tiranë. Vonesat në krijimin e shoqërisë UK Rajonale Tiranë sipas parashikimeve të VKM nr.302, vijnë si rezultat i diskutimeve në vazhdim për pika të veçanta të karakterit teknik ndërmjet drejtuesve të pushteteve vendore dhe MIE.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka zhvilluar takime të drejtpërdrejta me drejtuesit e AKUK, drejtuesit e shoqërive UK Rajonale dhe kryetarët e këshillave mbikëqyrëse, me qëllim informimin e tyre mbi hapat që duhen ndjekur në zbatim të reformës sipas VKM nr. 302 duke patur në konsideratë zbatimin e ligjit të ERRU-së nr. 8102 gjatë kësaj periudhe tranzitore. Në to janë diskutuar gjithashtu edhe një sërë problematikash me të cilat po përballen shoqëritë e reja UK rajonale gjatë kësaj faze fillestare.

Riorganizimi i sektorit UK është një proces kompleks i cili ka shfaqur shumë sfida dhe të panjohura në terren gjatë implementimit të tij për realizimin me sukses të reformës. Në këtë kontekst, shoqëritë e reja të krijuara u përballën me një sërë problematikash në drejtim të menaxhimit, operimit, të situatës financiare të shoqërive UK ekzistuese, të cilat u vunë re gjatë auditimit të tyre nga ekspertët e pavarur dhe drejtuesit e shoqërive UK Rajonale, si më poshtë :

- Mos rakordimi i detyrimeve të prapambetura si rezultat i marrëveshjeve dhe detyrimeve kontraktuale me institucionet financiare kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kompanitë kontraktuese për të cilat shoqëritë rajonale të krijuara janë të detyruara t'i respektojnë.
- Mos rakordimi i numrit të klientëve debitorë në sistem me ato të pasqyruara në bilanci financiar nga UK ekzistuese.
- Mungesa e stafëve të kualifikuara në pozicionet kyçe të shoqërive.
- Mungesë e operimit normal të shoqërisë në disa raste si rezultat i bllokimit të llogarive bankare nga detyrimet e prapambetura të cilat ju ngarkuan shoqërisë së re rajonale.
- Në përgjithësi mungesë të dokumentacioneve të rregullta që duhet të dispononin shoqëritë UK ekzistuese

Një tjetër element sfidues me të cilin po përballen shoqëritë UK rajonale si rezultat i agregimit është edhe synimi për të unifikuar tarifat në të gjithë zonën e re të shërbimit. Për disa nga shoqëritë rajonale tarifat janë të përafërta nga zona në zonë, prandaj unifikimi tarifor është i mundshëm. ERRU inkurajon procesin e unifikimit tarifor për nivel të njëjtë shërbimesh UK, sepse duke patur të dhënat e variablave tekniko financiare të përbashkëta krijohet mundësia e një menaxhimi financiar dhe monitorimi relativisht më të kontrollueshëm dhe efikas, si edhe zbatohet parimi i barazisë të detyrimit financiar ndërmjet klientëve në zonën e shërbimit.

Për disa shoqëri rajonale të formuara, Durrësi, Korça, etj, unifikimi tarifor duket i parakohshëm për tu realizuar për shkak të diferencave të mëdha ndërmjet tarifave të mbartura nga njëra zonë në tjetrën, si për shkak të kostove të veprimtarisë edhe të cilësisë së shërbimit. Nëse unifikohen menjëherë tarifat në shoqëri të tilla, praktika ka treguar se nga rritja e menjëhershme e në mënyrë të konsiderueshme e tarifave, shoqëria ndeshet me një rezistencë nga ana e konsumatorëve duke mos paguar faturat e shërbimeve. Pra, si rezultat ulet norma e arkëtimit dhe aftësia likuiduese e shoqërisë, si dhe të treguesve financiarë në përgjithësi.

Në këtë rast duke qenë se, metodologjia ofron mundësinë e planifikimit tarifor me rritje graduale, unifikimi i tyre mendohet të realizohet me faza sipas specifikave të çdo rasti, si dhe duhet shoqëruar me rritje të cilësisë së shërbimit në këto zona. Në këtë rast krijohen kushtet për një nivel të ri tarifor të unifikuar, e cila sjell të ardhura të faturuara më të larta, rrjedhimisht edhe një performancë financiare të përmirësuar dhe të qëndrueshme të shoqërisë rajonale.

Agregimi i sektorit është një proces i cili kërkon vëmendje të vazhdueshme nga qeveria qendrore në drejtim të menaxhimit të asetëve ekzistuese dhe planifikimit sa më të drejtë të subvencioneve dhe investimeve të nevojshme që duhen kryer për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve si synimi final i këtij procesi.

5 Objektivat dhe Planet e Veprimit të Punës së ERRU-së dhe Sektorit të Ujit për Vitin 2024

- Pas miratimit përfundimtar të ligjit të ri për sektorin UK, të rishikojë të gjitha aktet nënligjore rregullatore në fuqi të nevojshme për tu rishikuar.
- Në bashkëpunim me AKUK të kontribuojë në ngritjen sa më shpejt të sistemit të integruar të të dhënave dhe treguesve kryesorë të performancës në kuadër të marrëveshjes mbi “Raportimin e të dhënave të shoqërive UK pranë sistemit të integruar të informacionit të performancës (IPIS)”, i cili do të përdoret nga të dyja palët.
- Të shtojë vëmendjen dhe kontrollin ndaj shoqërive UK për rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave që raportohen, si një ndër problematikat kryesore të sektorit.
- Të ofrojë asistencën e duhur për shoqëritë rajonale në lidhje me problematikat që në mjaft raste priten të hasen nga propozimet e tarifave të reja duke zbatuar metodologjinë e re të tarifave të shërbimeve UK.
- Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me AKUK mbi “Hartimin dhe miratimin e modelit të Planeve 5 vjeçare të Biznesit për shërbimet e UK”, në bashkëpunim me konsulentin e përzgjedhur nga procesi i prokurimit të mbikëqyrë përgatitjen dhe miratimin e modelit të unifikuar të Planeve të Biznesit 5 vjeçare, si dhe udhëzuesin përkatës, në përputhje me Termat e Referencës dhe kushtet e parashikuara në kontratën me Konsulentin.
- Të vijojë punën për krijimin e mekanizmave informues për rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve në drejtim të cilësisë së shërbimit UK të ofruar nga shoqëritë, si dhe njohjes së të drejtave dhe detyrimeve të palëve.
- Të nxisë shoqëritë UK për të krijuar standarde efikente në trajtimin e ankesave si dhe të vijojë procesin e monitorimit mbi procedurat e trajtimit dhe zgjidhjes të ankesave të konsumatorëve nga ana e shoqërive UK.
- Të intensifikojë përpjekjet për rritjen e kapaciteteve të institucionit duke planifikuar ditët e nevojshme përmes trajnimeve, të shkëmbimit të eksperiencave me rregullatorët e Ballkanit Perëndimor, Evropianë WAREG dhe veçanërisht me Rregullatorin e Skocisë (WICS) dhe Hungarisë (MEHK).
- Të vijojë bashkëpunimin veçanërisht me AKUK, me MIE, si dhe aktorët e tjerë kryesorë të sektorit të ujit, si SHUKALB në mbështetje të reformës për përmirësimin e performancës së sektorit UK.
- Të marrë pjesë aktive në të gjithë Grupet e Punës dhe të aktiviteteve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar ku trajtohen dhe diskutohen çështje thelbësore strategjike dhe tematika të veçanta të sektorit UK për përmirësimin e instrumenteve rregullatore gjatë veprimtarisë së tij.
- Në përgjigje të statusit të hapjes së negociatave me BE, të kontribuojë në përmbushje të kërkesave të Acquis Communautaire të Shqipërisë në lidhje me Direktivat Evropiane për Ujin e Pijshëm, Ujërat e Ndotura dhe të Llumrave të ITUN.

6 Gjendja e Performancës së Sektorit UK për Vitin 2023

Pjesa e dytë e raportit vjetor të aktivitetit të ERRU-së trajton ecurinë e Performancës së Sektorit të UK për vitin 2023. Raporti është strukturuar sipas shoqërive të riorganizuar sipas VKM Nr. 302 sipas së cilës kanë zhvilluar aktivitetin e tyre dhe kanë raportuar si shoqëri rajonale 13 nga 15 që parashikon reforma. Për shoqëritë e tjera të parajonalizuara, përkatësisht: UK Tiranë, Kamëz, Vorë, Vlorë, Himarë të dhënat e raportuara dhe vlerësimi i tyre janë bërë të veçanta. Për arsye krahasimore me vitin 2023, të dhënat e raportuara nga 58 shoqëritë UK në vitin paraardhës 2022, janë grupuar sipas shoqërive të riorganizuar.

Të dhënat e raportuara nga shoqëritë UK në këtë raport konsiderohen paraprake, por që priten të jenë mjaft të përafërta me ato që do të certifikohen nga një Ekspert Kontabël Ligjor deri në fund të muajit mars 2023, afat deri në të cilin realizohet edhe mbyllja e bilanceve financiare nga shoqëritë UK.

Grumbullimi i të dhënave dhe raportimi i të dhënave për vitin 2023, ka qenë një sfidë për ERRU-në dhe shoqëritë raportuese për shkak të riorganizimit të sektorit, pasi stafet e shoqërive UK ekzistuese që janë bërë pjesë e shoqërive UK Rajonale kanë qenë mjaft të angazhuara në zbatim të detyrave dhe afateve të përcaktuara sipas VKM nr.302, si edhe për shkak të vështirësive të krijuara nga ndryshimet në strukturat drejtuese të tyre.

Gjithsesi një analizë e plotë dhe më e detajuar e performancës së sektorit të ujit në përgjithësi dhe e çdo shoqërie UK në veçanti për vitin 2023, do të jepet në Raportin Vjetor të Performancës që hartohet dhe botohet çdo vit nga ERRU në fund të Qershorit me të dhëna të plota vjetore të certifikuara nga Ekspertët Kontabël Ligjor.

ERRU, monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme gjendjen dhe performancën e shoqërive UK, mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës, të miratuara në metodologjinë e tarifave. Për vitin 2023, krahasohen për herë të parë dy treguesit e rinj **“Eficenca e Energjisë”** dhe **“Ankesat e Konsumatorëve”**, të cilët u përfshinë dhe u publikuan për herë të parë vitin e kaluar pas miratimit të metodologjisë së re të tarifave.

Në tabelën 6 jepen vlerat e TKP-ve për vitin 2023 dhe tendenca e tyre krahasuar me vitin paraardhës 2022. Në Aneks 4, jepen gjithashtu TKP-të për secilën shoqëri në vete dhe atyre të grupuara sipas shoqërive të riorganizuar.

Referuar kësaj tablele, vërehet se reforma masive në sektorin UK gjatë vitit 2023, ka dhënë impaktin e vet në drejtim të përmirësimit në përgjithësi të situatës financiare të sektorit krahasuar me vitin paraardhës 2022, që ka qenë një ndër objektivat kryesorë të reformës.

Këtë impakt e ka dhënë përmirësimi me 13,7% i Mbulimit të Kostove O&M, Normës së Arkëtimit Korrente me 1.6% dhe asaj të Përgjithshme me 4.7%.

*Gjithashtu, të përmirësuar paraqiten edhe një pjesë e treguesve të tjerë të performancës, si **Niveli i Matjes, Eficenca e Stafit, Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë, Mbulimi me Kanalizime dhe Eficenca e Energjisë**, të cilët gjithashtu kanë patur ndikimin e tyre në përmirësimin e situatës financiare të shoqërive dhe në cilësinë e ofrimit të shërbimit.*

Tabela nr.6. Treguesit Kryesorë të Performancës për Vitet 2022-2023

Nr.	Treguesit Kryesore të Performancës	Njësia e Matjes	Viti 2022	Viti 2023	Tendenca
1	Uji Pa të Ardhura	%	63.7	64	↘
2	Mbulimi i Kostove O&M	%	90.3	104	↗
3	Norma e Arkëtimit Korrente	%	81.4	83	↗
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	%	97.3	102	↗
5	Niveli i Matjes	%	82.8	86	↗
6	Eficienta e Stafit	(staf/1000 lidhje UK)	4.73	4.6	↗
7	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	16.3	16.6	↗
8	Mbulimi i Furnizimit me Ujë	%	78	76.2	↘
9	Mbulimi me Kanalizime	%	54.2	55	↗
10	Efiçenca e Energjisë FU	kWh/m ³	0.65	0.5	↗
11	Ankesat e Klientëve	%	2.8	3.1	↘

Burimi: ERRU

Megjithëse në pamje të parë duket se treguesit e **Uji Pa të Ardhura dhe Mbulimi i Furnizimit me Ujë**, kanë një tendencë të vogël në rënie, kjo vjen si rezultat i gabimeve në raportimet e vitit 2022 nga ish shoqëritë UK individuale, dhe për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion që shoqëritë kanë për raportimin e të dhënave paraprake. Gjithsesi, vlerat e tyre përfundimisht do të saktësohen në raportimet përfundimtare së bashku me të dhënat e certifikuar të bilanceve financiare.

Për treguesin e **Ankesave të Klientëve**, ka qenë e pritshme që ky tregues të kishte tendencë përkeqësimi krahasuar me vitin 2022 si rezultat i problemeve që u shfaqen gjatë riorganizimit dhe konsolidimit të shoqërive UK Rajonale.

Më poshtë jepet në mënyrë të përmbledhur analiza e ecurisë për secilin TKPs.

"Uji Pa të Ardhura", i cili është një nga treguesit më të rëndësishëm që ndikon në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK, për vitin 2023 është përkeqësuar me rreth 0.3% krahasuar me një vit më parë, përkatësisht nga 63,7% në 64%.

Përkeqësimi i këtij treguesi ka ardhur si rezultat i rritjes së volumit të ujit të prodhuar me rreth 7 milion m³ përkundrejt rritjes së volumit të faturuar me 0.65 milion m³.

Ndikimin kryesor në rritjen e volumit të ujit të prodhuar e kanë dhënë kryesisht shoqëritë UK Rajonale Sarandë me rreth 3.9 milion m³, UK Rajonale Durrës me rreth 3.4 milion m³, UK Vlorë me rreth 3.2 milion m³, UK Rajonale Elbasan me rreth 2.5 milion m³ dhe UK Rajonale Lezhë me rreth 1.8 milion m³, të prodhuar më shumë gjatë vitit 2023.

Për **UK Rajonale Sarandë** dhe **Lezhë** rritja e volumit të prodhuar ka ardhur kryesisht nga rritja e numrit të klientëve me rreth +1172 klientë, dhe +1005 klientë. Shoqëritë **Rajonale Durrës** dhe **Elbasan** i justifikojnë diferencat në rritje të prodhimit me saktësinë aktuale të raportimeve nga rritja e volumit të ujit të prodhuar të matur nga investimet në matje të realizuara gjatë vitit 2023 për këtë qëllim.

Për UK Vlorë rritja e prodhimit ka qenë e detyrueshme për të mbajtur cilësinë e shërbimit, ku gjysma e tij furnizohet me ujë nga rrjeti i transmetimit të tubacioneve që duhet të furnizojnë në fakt vetëm depot kryesorë të qytetit, rrjete që janë mjaft të amortizuara dhe pritet të rinovohen sipas investimeve të planifikuara për këtë qëllim.

Ky amortizim justifikon edhe faktin që megjithëse prodhimi i ujit për këto shoqëri rezultoi në rritje, kjo nuk shoqërohet me rritje të kohëzgjatjes mesatare të furnizimit me ujë ndaj konsumatorëve krahasuar me vitin paraardhës

Në përfundim, treguesi i **Ujit Pa të Ardhura** vijon të mbetet përsëri në nivele mjaft të larta 64%. Objektivi kryesor për shoqëritë UK për përmirësimin e këtij treguesi duhet të shoqërohet me investimet përkatëse për instalimin e matësve në burim, për një përcaktim më të saktë të sasisë së ujit të prodhuar, plotësimi 100% i klientëve me matësa individuale, si dhe me zbatimin e vazhdueshëm të detyrave nga Task Forcat përkatëse për zbulimin e lidhjeve të paligjshme dhe rritjen e faturimit në përgjithësi.

"Mbulimi i Kostos së Operimit dhe Mirëmbajtjes" është një tregues i performancës financiare i cili paraqet nivelin e menaxhimit të kostove dhe të ardhurave nga shoqëritë UK. Në të përfshihen vetëm kostot që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen dhe përjashtohen kostot e amortizimit, huave dhe kostot financiare. Për vitin 2023 mbulimi i kostove O&M për sektorin UK është në nivelin e 104% nga 90.3% në vitin paraardhës 2022.

Gjatë vitit 2023, në sektor kanë zhvilluar aktivitetin e tyre 13 shoqëri UK Rajonale dhe 6 shoqëri UK të pa rajonalizuara. Referuar raportimeve përkatëse rezulton se 4 shoqëri UK Rajonale, **Berat, Korçë, Pogradec** dhe **Sarandë**, si dhe 2 shoqëri UK individuale, **Tiranë** dhe **Himarë**, kanë performancë të mirë financiare duke mbuluar mbi 100% kostot O&M.

Vërehet se nga shoqëritë e tjera, 9 shoqëri kanë performancë financiare të pranueshme në nivelin 75% deri 100%, ndërsa 2 shoqëritë e fundit, **Vlorë** dhe **Vorë** performojnë dobët nën nivelin 70% të këtij treguesi me vështirësi të theksuara financiare për ushtrimin e aktivitetit

"Mbulimi i Kostove Totale", pra ku përfshihen dhe kostot e amortizimit, huave dhe kostot financiare, për vitin 2023, realizohet vetëm nga 3 shoqëri UK në sektor, përkatësisht **UK Rajonale Berat dhe UK Tiranë** dhe **UK Himarë**.

Tabela 7 jep në detaje kostot për sektorin e Ujësjellës Kanalizime për dy vitet, ku përfshihen kostot përbërëse të O&M dhe ato Totale.

Tabela nr.7. Kostot e O&M, Kostot Totale dhe të Ardhurat për vitet 2022 dhe 2023

Nr.	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2023	Diferenca
		<i>Kostot e Shërbimit UK</i>	<i>në 000 lekë</i>	<i>në 000 lekë</i>
1	Kosto e punës	4,894,508	5,393,211	498,703
2	Kosto e energjisë së konsumuar	3,906,757	2,351,124	(1,555,633)
3	Kosto e riparim/mirëmbajtjes	487,514	417,234	(70,280)
4	Kosto e shërbimeve të kontraktuara	676,928	559,939	(116,989)
5	Kosto e materialeve kimikate	277,142	266,956	(10,187)
6	Kosto të tjera	1,151,388	1,164,703	13,315
<i>Kostot Operim & Mirëmbajtjes</i>		11,394,237	10,153,168	(1,241,070)
1	Kostot e amortizimit	3,170,328	2,631,381	(538,947)
2	Kostot financiare taksa tatime	830,392	679,453	(150,939)
<i>Kostot Totale</i>		15,394,957	13,464,002	(1,930,956)
<i>Të Ardhurat:</i>				
1	Nga shërbimet UK	9,909,324	10,317,343	408,019
2	Të ardhura të tjera lidhje, rilidhje etj.	381,673	286,388	(95,285)
<i>Të Ardhurat Totale</i>		10,290,997	10,603,731	312,734
<i>Niveli i Mbulimit të Kostove</i>				
Mbulimi i Kostove të O & M		90.3%	104%	13.7%
<i>Mbulimi i Kostove Totale</i>		67%	79%	12%

Sipas të dhënave, konstatohet se për vitin 2023, shoqëritë UK kanë zhvilluar aktivitetin e tyre me kosto operative rreth 11% më të ulëta se në vitin 2022 (-1.24 miliard lekë), ndërkohë edhe të ardhurat në sektor janë rritur me 3% krahasuar me vitin paraardhës (+312.7 milion lekë), që si rezultat ka dhënë një rritje të performancës financiare në drejtim të mbulimit të kostove.

Referuar uljes në total të kostove, energjia elektrike përbën zërin kryesor me 40% të tij ose me rreth 1.5 miliard lekë më pak se në vitin 2022. Përfundimisht bën Kosto e Punës që është rritur me 10% ose me rreth 498.7 milion lekë që është shkaktuar nga rritja e pagës minimale gjatë vitit 2023.

Kostot e Energjisë janë ulur ndjeshëm krahasuar me vitin 2022 për shkak të rishikimit të çmimit për njësi të energjisë elektrike nga ERE në fillim të vitit 2023, sipas vendimit nr.16, datë 06.02.2023 ku vendosi çmimin prej **9.33 lekë/kWh** për shoqëritë UK të lidhura në nivelin e tensionit 35 KV dhe **11.77 lekë/kWh** për shoqëritë UK të lidhura në nivelet e tensionit 20/10/6 KV, krahasuar me çmimin prej 18 lekë/kWh gjatë vitit 2022, i cili ishte rreth 100% më i lartë se çmimi i aprovuar së fundmi nga ERRE.

Gjithashtu, me rënie ka qenë edhe konsumi i energjisë me rreth (-11.3 milion kWh) krahasuar me vitin 2022. Ndikimin kryesor në uljen e konsumit të energjisë kanë dhënë **UK Rajonale Durrës** (-3.9 milion kWh), **UK Tiranë** (-1.9 milion kWh), **UK Rajonale Fier** (-1.78 milion kWh) dhe **UK Rajonale Elbasan** dhe **UK Rajonale Fier** me rreth (-1.1 milion kWh). Kjo ulje ka ardhur kryesisht si rezultat i rakordimeve që shoqëritë kanë bërë me OSHE në drejtim të konsumit të faturuar nga ana e tyre kryesisht për njësitë që i janë bashkuar shoqërive UK Rajonale.

Kostot e Punës janë rritur për shkak të rritjes së nivelit të pagës minimale sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 1.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” nga 34,000 lekë në 40,000 lekë në muaj e cila ka hyrë në fuqi në datën 1 prill 2023.

Numri i punonjësve në sektor ka rënë me 104 punonjës që ka balancuar disi rritjen e kostove të punës nga rritja e pagës minimale. Pritet që me riorganizimin e sektorit numri i punonjësve të reduktohet më tej akoma sidomos të stafit administrativ.

Kostot e Riparimeve për vitin 2023 rezultojnë të ulura me (-70 milion lekë) edhe pse çmimet e materialeve dhe shërbimeve janë rritur gjatë këtij viti. Kjo pasi numri i defekteve të raportuara në rrjetin shpërndarës ka rënë krahasuar me vitin 2022.

Kostot e Shërbimeve të Kontraktuara janë në rënie me (-117 milion lekë) ku ndikimin kryesor e kanë dhënë kryesisht shoqëritë **UK Tiranë, UK Rajonale Shkodër, Elbasan, Gjirokastrë, Durrës dhe Dibër**. Në këto kosto peshën më të madhe e zënë shërbimet e kontraktuara për rojet private. Shoqëritë UK që investojnë në monitorimin e objekteve nëpërmjet sistemeve të sigurimit me kamera operojnë me kosto të reduktuar lidhur me kostot e shërbimeve për roje, eksperiencë e cila duhet të shtrihet në të gjitha shoqëritë në sektor shoqëruar me planifikimin dhe implementimin e fondeve përkatëse për këtë qëllim.

Kosto të tjera Operacionale Përfshihen kostot e qerave për zyrat, vendimet gjyqësore, detyrimet ndaj institucioneve si ERRU, SHUKALB, Agjencive të Baseneve Ujore etj. Ky zë shpenzimesh raportohet me rritje prej +13 milion lekë krahasuar me vitin 2022 për shkak të rritjes së çmimeve në vitin 2023.

Kostot Kapitale përfshijnë kostot e amortizimit, të cilat kanë rënë me (-539 milion lekë) ku ndikimin kryesor e ka dhënë **UK Kamëz** e cila ka bërë një rivlerësim të amortizimit të aseteve në bazë vjetërsie, ndërsa kostot financiare taksa tatime rezultojnë të ulura me (-151 milion lekë). Ulja në total prej 690 milion lekë e këtyre kostove ka ndikuar në përmirësimin e treguesit të mbulimit të kostove Totale me 12% krahasuar me vitin 2022.

Të Ardhurat nga Aktiviteti i UK për vitin 2023 janë rritur me 3% (+312.7 milion lekë), e cila ka ardhur kryesisht nga influenza e rritjes së numrit të lidhjeve të reja të FU me +15,635, që kanë ndikuar në rritjen e nivelit të faturimit (me +408 milion lekë). Volumi i ujit të faturuar për sektorin UK, është rritur me 651 mijë m³ edhe për shkak se disa shoqëri kanë përmirësuar treguesin e Vazhdimësisë së Furnizimit me Ujë në krahasim me vitin 2022.

Gjithsesi raportimet e vlerave të mësipërme duhet të konsiderohen paraprake sepse një analizë e detajuar e treguesve të Mbulimit të Kostove O&M dhe të Kostove Totale për vitin 2023, do të jepet në Raportin e Performancës së Sektorit UK, i cili publikohet në fund të muajit qershor 2024. Në këtë raport realizohet verifikimi dhe rakordimi i të dhënave duke iu referuar Bilanceve Kontabël të certifikuara nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar.

"Norma e Arkëtimit" është një nga treguesit më të rëndësishëm të performancës financiare të shoqërive e cila lidhet me qëndrueshmërinë financiare dhe me aftësinë paguese të tyre. Aktualisht monitorohen dy tregues, përkatësisht Normën e Arkëtimit të Përgjithshme (NAP) dhe Normën e Arkëtimit Korrente (NAK). NAP, në përlogaritjen e saj përfshin të gjitha arkëtimet e kryera nga shoqëria, përfshirë edhe debitë e vjetra, ndërsa NAK i përjashton këto të fundit. Shoqëritë duhet të rrisin raportin aktual të arkëtimit dhe të ulin periudhat e arkëtimit të debive.

Norma e Arkëtimit Korrente për sektorin UK në vitin 2023 rezulton të jetë përmirësuar në nivelin 83% krahasuar me 81.4% që ishte në vitin 2022. Ndër shoqëritë që kanë ndikuar në përmirësimin e këtij

treguesi mund të përmendim shoqëritë **UK Tiranë, UK Kamëz** si dhe **shoqëritë Rajonale UK Durrës, Lezhë, Elbasan, Fier dhe Dibër.**

Norma e Arkëtimit e Përgjithshme në nivelin 102%, paraqitet e përmirësuar me 4.7% krahasuar me vitin 2022 që ishte 97.3%. Kjo ka ardhur kryesisht si rezultat i aksioneve të ndërmarra nga shoqëritë UK Rajonale nën drejtimin e AKUK me Task Forcat përkatëse për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura nga debitorët për shlyerjen e borxheve në disa raste sipas marrëveshjeve me këste. Shoqëritë me performancë të përmirësuar për Normën e Përgjithshme të Arkëtimit, janë **UK Rajonale Durrës, Dibër, Korçë, Kukës, Lezhë, Gjirokastrë, Berat, Fier, Lushnje**, si dhe shoqëritë individuale **UK Tiranë dhe Vlorë.**

Gjithsesi në sektor ka edhe shoqëri që kanë arkëtuar më pak debi të vjetra krahasuar me vitin 2022, si: **UK Rajonale Pogradec, Sarandë, Shkodër** si dhe shoqëritë individuale **UK Vorë, Kamëz, Himarë dhe Selenicë.** Gjithsesi, një pasqyrë më e saktë e këtij treguesi do të jepet në Raportin e Performancës së Sektorit UK për vitin 2023 pasi të jenë bërë rakordimet me bilancet financiare të certifikuara për secilën shoqëri UK.

"Niveli i Matjes" është një tregues i rëndësishëm pasi është e drejtë e konsumatorit që të faturohet me sasinë reale të ujit të konsumuar prej tyre dhe që ndihmon në një përcaktim më të saktë të treguesit të UPA. Nga ana tjetër për konsumatorët e zonave rurale dhe atyre me shtëpi private instalimi i matësve individualë ndikon direkt në uljen e nivelit të shpërdorimit të ujit të përdorur prej tyre, kryesisht për ujitje. Për vitin 2023, ky tregues për sektorin rezulton 86% i përmirësuar me 3.4% krahasuar me vitin 2022.

Gjatë vitit 2023, në krahasim me vitin e kaluar janë instaluar në të gjithë sektorin rreth 44,511 matës uji, por ende raportohen 133,532 klientë pa matës, nga të cilët 5,252 janë të kategorisë jo familjarë. Referuar VKM nr. 96, datë 21.02.2007, klientët jo familjarë (subjektet private) janë të detyruar të instalojnë ujëmatës me shpenzimet e tyre, vendim që akoma nuk është zbatuar plotësisht nga ana e shoqërive UK për këtë kategori klientësh.

Në vijim të reformës pajisja e të gjithë klientëve me matës, duhet të jetë një nga objektivat kryesorë të shoqërive UK Rajonale si një element që përmirëson dhe lehtëson menaxhimin e kërkesës për ujë, uljes së shpërdorimeve të mbikonsumit të tij, në mënyrë që ti jepet fund abuzimit nga klientët e papërgjegjshëm.

"Eficenca e Stafit" është një tregues që lidhet direkt me kostot e punës, të cilat së bashku me energjinë elektrike zënë peshën kryesore ndaj totalit të kostove të operimit të shoqërisë. Ky tregues krahasohet me vitin paraardhës duke marrë në konsideratë vetëm punonjësit sipas organogramës së shoqërive UK pa përfshirë personelin roje të nënkontraktuar me subjektet private. Ky tregues luhetet në varësi të dy variablave që janë numri i stafit të shoqërive dhe numri i lidhjeve UK.

Treguesi i efencës së stafit për vitin 2023, ka një përmirësim të lehtë dhe rezulton në nivelin e 4.6 punonjës për 1000 lidhje UK nga 4.73 punonjës për 1000 lidhje që ishte në vitin paraardhës. Përmirësimi i lehtë i efencës së stafit për vitin 2023, vjen si rezultat i rritjes së numrit të lidhjeve të ujit me rreth 15,635 lidhje dhe atyre me kanalizime me rreth 1600 lidhje, ndërkohë që edhe numri i stafit është ulur me 104 punonjës.

ERRU i kushton një rëndësi të veçantë analizës së këtij treguesi duke analizuar punonjësit sipas organogramës së shoqërisë, e cila është edhe një nga dokumentet që ERRU i kërkon shoqërive në momentin që aplikojnë për nivel të ri tarifor dhe mbi të cilën vendosen edhe objektivat e këtij treguesi.

Në shumë shoqëri ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të kërkesës në plotësimin e detyrimit ligjor për garantimin e sigurisë së veprave me personel roje të komponentëve të sistemeve të FU dhe KUN. Në ato zona shërbimi ku numri i depove, puseve dhe stacioneve të pompimit është i madh, shoqëritë janë të detyruara që të kenë një numër të konsiderueshëm punonjësish për të mbuluar shërbimin e sigurisë në këto objekte, çka krijon përshtypjen e një treguesi të ulët të Eficencës së Stafit. Gjithashtu evident mbetet fakti i punësimeve mbi nevojat e shoqërisë për arsye të pajustificuara.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" shpreh mesataren e orëve të furnizimit me ujë në ditë për konsumatorët. Ky tregues shpreh cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve që ato të kenë një regjim furnizimi me ujë pa ndërprerje, i cili kur është i tillë garanton dhe cilësinë e ujit nga ana sanitare ndaj ndotjes eventuale nga përzierja me ujërat e ndotura në rrjetet e kanalizimeve që kalojnë pranë tyre. Faktorët kryesorë që shkaktojnë këtë vazhdimësi të ulët të kohës së furnizimit me ujë janë humbjet e ujit nga mbikonsumi i pamatur si pasojë e faturimit aforfe, nga lidhjet e paligjshme dhe nga humbjet teknike në rrjete si rezultat i gjendjes së amortizuar të thellë të tyre.

Ky tregues në vitin 2023 ka qenë në nivelin e 16,6 orë/ditë, pra ka patur ecuri pozitive relativisht të lehtë me mesatarisht 0,3 orë në ditë krahasuar me vitin 2022. Përmirësimi i këtij treguesi lidhet direkt me investimet e nevojshme dhe rritjen e nivelit të matjes në sektor.

Nga të gjitha shoqëritë rajonale dhe individuale që operojnë në sektor gjatë vitit 2023 rezultojnë në avangardë shoqëria **UK Korçë** me një regjim furnizimi me ujë mesatarisht 23.5 orë në ditë, 15 shoqëri raportojnë se ofrojnë furnizimin me ujë mesatarisht në nivele nga 13 deri 22 orë në ditë, ndërsa 3 shoqëri raportojnë, përkatësisht **UK Kamëz** me 8 orë/ditë, **Selenicë** me 7 orë/ditë dhe **Vorë** me 4 orë/ditë, që konsiderohen shërbim furnizimi me ujë i cilësisë së ulët.

Në fakt, riorganizimi i shoqërive UK në shoqëri rajonale ka ndikuar që asnjë prej shoqërive UK të raportojë furnizim me ujë të pandërprerë në 24/7, pasi shoqërive ekzistuese që ofronin furnizim ujë 24/7 u janë bashkuar shoqëri me më pak orë furnizimi dhe mesatarja e orëve për të gjithë zonën e shërbimit të tyre ka pësuar rënie.

"Mbulimi i Furnizimit me Ujë" për vitin 2023 është në nivelin e 76.2% nga 78% që ishte në vitin 2022, pra ka pësuar një rënie me rreth 1.8%. Rënia e këtij treguesi ka ardhur si rezultat i rënies së popullsisë në juridiksion me 58,098 banorë ndërkohë që popullsia e shërbyer ka pësuar rënie me 127,055 banorë. Ndikimi kryesor ka ardhur nga shoqëritë **UK Elbasan, UK Korçë** dhe **UK Gjirokastër**, të cilat kanë raportuar rënie të numrit të popullsisë në zonën e juridiksionit krahasuar me vitin paraardhës. Këto shoqëri së bashku edhe me shoqëritë e tjera si **Durrës, Shkodër, Berat, Lushnje, Lezhë, Kukës** dhe shoqëria individuale **Vlorë**, kanë raportuar rënie të popullsisë së shërbyer, si rezultat i saktësimin të të dhënave.

Gjithsesi, Mbulimi i Furnizimit me Ujë nga shoqëritë UK është e lidhur drejtpërsëdrejti edhe me investimet e nevojshme fizike që kërkohen të kryhen në sektor për të mbuluar të ashtuquajturat "zona të bardha" të pa shërbyera më parë me shërbim të furnizimit me ujë nga shoqëritë UK ekzistuese.

"Mbulimi me Kanalizime" në nivelin e 55% vijon të ketë një trend rritës edhe për vitin 2023 me një përmirësim të vogël me 0.8% krahasuar me vitin 2022. Kjo shpjegohet me faktin se popullsia me shërbimin e KUN është ulur me 13,525 banorë, ndërkohë që popullsia në juridiksion është ulur me 58,098 banorë.

Në sektor janë akoma rreth 33 mijë klientë, të cilët e realizojnë grumbullimin e ujërave të ndotura nëpërmjet gropave septike kundrejt 708 mijë klientëve që shërbehen nga shoqëria me kanalizime. Zgjidhja me gropa septike është zgjidhje e pranueshme për zona rurale me popullsi relativisht të rrallë, por problem për to mbetet respektimi i kushteve teknike të zbatimit të tyre për të garantuar impaktin negativ që ato mund të japin për ambientin pritës.

Rritja e cilësisë së shërbimit të kanalizimeve si dhe përmirësimi i këtij treguesi është i domosdoshëm dhe lidhet me nevojën e investimeve të konsiderueshme që kërkohen për këtë qëllim. Niveli i investimeve në drejtim të mbulimit me KUN nuk ka qenë i mjaftueshëm, sepse në fakt investimet kanë qenë të orientuara kryesisht në drejtim të shërbimit të furnizimit me ujë.

Nga ana tjetër, duhet që fokusi i investimeve të jetë edhe në drejtim të rritjes së popullsisë së shërbyer me ITUN bazuar edhe në kërkesat e BE-së ku Shqipëria aderon të jetë pjesë.

"Eficienca e Energjisë" është një tregues i cili analizohet për herë të parë gjatë këtij viti si një tregues shumë i rëndësishëm i performancës financiare të shoqërive UK. Për vitin 2023 eficienca e energjisë për furnizimin me ujë në sektor është 0.5 kWh/m³ nga 0.65 kWh/m³ që ishte në vitin 2023. Përmirësimi i këtij treguesi vjen kryesisht nga ulja e konsumit të kWh me 11.3 milion, krahasuar me vitin 2022, kjo për shkak të rakordimeve të bëra nga shoqëritë UK me OSHE për faturime të pasakta në disa raste dhe jo për shkak të uljes së volumit të ujit të prodhuar i cili ka rezultuar në rritje.

Shoqëritë UK duhet domosdoshmërisht të gjejnë mundësinë për të realizuar një studim mbi eficientë e energjisë në sistemet e furnizimit me ujë dhe KUN.

"Ankesat e Klientëve" edhe ky tregues analizohet për herë të parë si një tregues që demonstroi nivelin e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve, si dhe mbrojtjen e interesave të tyre. Ky tregues nga ana e ERRU-së lidhet direkt edhe me angazhimin e ERRU-së në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit nga shërbime të karakterit monopol siç janë ato të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Ankesat e klientëve në raport me numrin total të lidhjeve të sektorit UK për vitin 2023 janë 3.1%, nga 2.8% që ishin në vitin 2022, me një rritje prej 2974 ankesash për të gjithë sektorin. Ndikimin kryesor në përkeqësimin e këtij treguesi e kanë dhënë kryesisht shoqëritë **UK Rajonale Fier, Berat, Dibër, Lushnje** dhe **shoqëria UK Vorë**.

Investimet në Sektorin e Ujësjetës Kanalizimeve

Investimet në fushën e UK që realizohen nëpërmjet agjencisë zbatuese AKUK ndahen në :

- I. Të financuara nga buxheti i shtetit, përkatësisht:
 - a) investime fizike në sistemet e FU dhe KUN
 - b) Investime për studim-projektim-mbikëqyrje punimesh të investimeve fizike
 - c) Kontributet lokale në zbatim të projekteve të financuara nga donatorë të huaj, dhe,
- II. investime të projekteve të financuara nga donatorët e huaj sipas marrëveshjeve përkatëse me qeverinë shqiptare.

Referuar të dhënave nga AKUK për vitin 2023, në total investimet sipas specifikave të mësipërme jepen në Tabelën 8, ku vihet re se për vitin 2023 për investime në sektorin UK nga buxheti i shtetit dhe donatorët janë alokuar fondet në vlerën e rreth 15,572,246,000 Lekë (ose rreth 141.6 milion Euro) dhe janë disbursuar 15, 482,103,766 lekë (ose rreth 140.7 milion Euro), pra rreth 99.6% të planifikuara.

Nga totali i investimeve prej 15,482,103,766 lekë, janë financiar nga Qeveria Shqiptare 13,938,972,000 Lekë (ose rreth 89,5% të totalit), si edhe 1,633,274,000 Lekë nga donatorët e huaj (rreth 10,5% të totalit).

Pjesa më e madhe e financimit në vitin 2023 ka qenë për objektet në vazhdim dhe vetëm 660.2 milion lekë (rreth 6 milion euro) janë financiar për objekte të reja me financim të brendshëm nga buxheti i shtetit.

Investimet me financime të huaja kanë qenë kryesisht nga KfW në vazhdimësi të Programit të Infrastrukturës Bashkiake IV dhe V, Banka Botërore, AFD, SECO dhe SIDA, nga të cilat është disbursuar pothuajse e gjithë vlera (97.5%). Vlera e disbursuar nga investimet e huaja ka qenë vetëm për objektet në vazhdim.

Theksohet fakti se investimet fizike janë të orientuara drejt reformimit të sektorit UK në përmbushje të Strategjisë Kombëtare në plotësim të nevojave të një ekonomie në zhvillim. Në tabelën nr.8, jepen të detajuara zërat e buxhetit të planifikuara dhe të disbursuar për vitin 2023 sipas objekteve në proces dhe ato të reja.

Tabela nr.8. Financimi i projekteve në vazhdim dhe të reja nga AKUM dhe burimet e huaja- Viti 2023

Përshkrimi	Vlera e Planifikuar (në lekë)	Vlera e Financuar (në lekë)	Realizimi (në %)
Investimet nga AKUM	13,938,972,000	13,889,571,591	99.6
Objektet në vazhdim me financim të brendshëm	12,796,572,995	12,755,923,128	99.2
Objektet e reja të vitit 2023 me financim të brendshëm	660,220,024	660,220,024	100
Supërvizim punimesh	109,395,799	100,645,257	92
TVSH	266,529,411	266,529,411	100
Kosto Lokale	106,253,771	106,253,771	100
Investimet e Huaja (Objekte në vazhdim)	1,633,274,000	1,592,532,175	97.5
TOTALI	15,572,246,000	15,482,103,766	99.4
	(eq.141.6 mln euro)*	(eq.140.7 mln euro)*	

Burimi: AKUK

*** 1 euro = 110 lek**

Një informacion më i detajuar me emërtime të objekteve dhe vlera mbi investimet e realizuara në sektorin UK për vitin 2023, do të jepet në raportin e veçantë të performancës së sektorit UK, që ERRU paraqet në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave mbasi ka marrë të dhëna të certifikuara nga të gjitha shoqëritë UK, raport i cili publikohet çdo vit në fund të muajit qershor 2023.

Subvencionet

Qeveria qendrore për vitin 2023 ka shpërndarë subvencione në vlerën e 310 milionë lekë vetëm për gjashtë Shoqëri Rajonale UK, respektivisht, *Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Shkodër, Vlorë*.

Shpërndarja e subvencioneve është realizuar referuar udhëzimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr.12, datë 26.09.2023 “Për miratimin e metodologjisë, për kriteret dhe procedurat, për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për ofruesit e shërbimeve në sektorin e UK për vitin buxhetor 2023”.

Referuar këtij udhëzimi, në pikën 4 (a) citohet se shoqëritë e reja rajonale të krijuara brenda vitit 2023 të subvencionohen me 30,000,000 lekë që është zbatuar për shoqëritë UK Rajonale *Shkodër dhe Vlorë*, si shoqëri rajonale që janë regjistruar dhe krijuar gjatë vitit 2023.

Në pikën 4 (b), të po këtij vendimi citohet se pjesa e mbetur e fondit të subvencionit do të përdoret për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për shoqëritë që e kanë mbi 75% të prodhimit me ngritje mekanike si dhe ato shoqëri që kanë krijuar detyrime të reja për energjinë gjatë vitit 2023 për shkak të kostove të larta të energjisë, kriter i cili është zbatuar për të subvencionuar shoqëritë Rajonale UK *Durrës, Elbasan, Fier dhe Lezhë*.

Referuar vlerës totale të subvencioneve për vitin 2023 rezulton se 90.8% janë shpërndarë për kostot e energjisë elektrike, 4.6% janë shpërndarë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore të papaguara, 4.5% janë shpërndarë për paga të papaguara dhe 0.1% për tatime e taksa të papaguara.

Shpërndarja e subvencioneve në detaje për vitin paraardhës 2022 dhe vitin 2023 sipas zërave të mësipërm në përqindje jepet në tabelën 9, ndërsa në Aneks 3 jepet e detajuar shpërndarja e subvencioneve për vitin 2022 dhe 2023 për secilën shoqëri rajonale UK.

Tabela nr.9. Shpërndarja e subvencioneve për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

Shpërndarja e Subvencioneve	Viti 2022 Shpërndarja		Viti 2023 Shpërndarja	
	(në Lekë)	(në %)	(në Lekë)	(në %)
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	139,906,339	38.90	14,288,043	4.6
Tatim Taksa të papaguara	48,815,235	13.60	170,684	0.1
Paga të papaguara	17,334,619	4.80	14,091,049	4.5
Energji Elektrike	93,943,807	26.10	281,450,224	90.8
Performancë	60,000,000	16.70		
Totali	360,000,000	100	310,000,000	100

Për shoqëritë të cilat nuk e kanë përfunduar procesin e rajonalizimit të parashikuara në VKM nr. 302, përkatësisht: *UK Tiranë, UK Kamzë, UK Vorë* që priten të rajonalizohen si SKP UK Tiranë, nuk janë shpërndarë subvencione. Kjo lidhet edhe me strategjinë e qeverisë qendrore, e cila i ka dhënë prioritet me mbështetje financiare shoqërive UK të cilat janë bërë pjesë e reformës sipas VKM nr. 302 ku MIE/AKUM është aksionare me 51% të aksioneve.

7 Rekomandime për Përmirësimin e Performancës së ERRU-së dhe të Sektorit të Ujit

- Të bëhen përpjekjet maksimale nga ana e AKUK me mbështetjen e duhur financiare dhe asistencë teknike për përballimin e vështirësive që kanë aktualisht shoqëritë rajonale për menaxhimin e aktiviteteve të tyre të përqendruara kryesisht në gjetjet nga auditimi i pavarur, si rakordimi dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura me institucionet financiare kombëtare dhe ndërkombëtare, rakordimi i numrit të klientëve debitorë në sistem me ato në bilancet financiare nga UK ekzistuese.
- Plotësimi sa më parë i pozicioneve kyçe në organogramën e shoqërisë me stafe të kualifikuara, si dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit ekzistues.
- Në vijim të reformës në sektorin UK, të hartohen nga shoqëritë rajonale Planet e Menaxhimit të Aseteve, përfshirë dhe ndërtimin e një sistemi të unifikuar digjital të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së asetëve.
- Në përgjigje të krizës globale energjitike dhe të ndikimit të saj eventual në vendin tonë, të shihet si prioritet hartimi i Planeve të Rritjes së Eficencës së Energjisë për shoqëritë UK dhe fillimi i zbatimit të tyre, përfshirë fondet përkatëse të nevojshme për këtë qëllim, si faktor që ndikon drejtpërsëdrejti në uljen e kostove të O&M.
- Të planifikohen dhe alokohen fondet përkatëse nga AKUK për pajisjen e të gjithë sistemeve të FU, me ujëmatës të mëdhenj në burim, në mënyrë që shoqëritë UK të kenë mundësinë e hartimit të saktë të Bilanceve të Ujit, vlerësimit të humbjeve, si dhe gjendjen reale të kërkesës për ujë.
- Duke marrë në konsideratë ndryshimet klimatike, të planifikojë sa më parë hartimin e Planeve të Emergjencës për shoqëritë UK për masat dhe alternativat e nevojshme për të përballuar kërkesën për ujë në situata emergjence.
- Duke patur parasysh që një pjesë të mirë të kostove të justifikuara që duhet të mbulohen me tarifa e përbëjnë investimet e reja, duhet të krijohet mundësia që ERRU të përfaqësohet për të dhënë rekomandimet e saj në komisionet teknike pranë AKUK për aprovimin e projekteve të reja për investimet.
- AKUK së bashku me ERRU të marrë iniciativën për ndryshimet e nevojshme legislative për sigurinë e objekteve të sistemeve të FU, të konsideruara si objekte të rëndësishme të veçantë për të mundësuar zgjidhje alternative që reduktojnë kostot mjaft të larta të rojeve duke konsideruar zgjidhje alternative teknike dhe me anë të digjitalizimit.

Aneks 1 - Aplikimet e Shoqërive dhe Situata e Licencimit për Vitin 2023**Tabela 1. Aplikimet e shoqërive që kanë kaluar për vendimmarrje**

Kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR							
Nr.	Shoqëritë që kanë aplikuar	Mbarim afati	Ndryshim Drejtuesi Ligjor	Ndryshim Drejtuesi Teknik	Ndryshim Zone Shërbimi	Licencim për herë të parë si SKP	Shtim kategori shërbim
1	Sh. R UK Berat					X	
2	Sh. R UK Dibër					X	
3	Sh. R UK Durrës					X	
4	Sh. R UK Elbasan					X	
5	Sh. R UK Fier					X	
6	Sh. R UK Gjirokastrë					X	
7	Sh. R UK Kukës*		X			X	
8	Sh. R UK Lushnje					X	
9	Sh. R UK Pogradec					X	
10	Sh. R UK Sarandë					X	
11	Sh. R UK Shkodër					X	
12	Sh. UK Tiranë	X					
14	Sh. UK Malësi e Madhe (Ekzistuese)			X			
15	Sh. UK Shkodër (Ekzistuese)		X				
16	Sh. UK Vlorë		X				
	Nëntotali	1	3	1		11	
	Totali				16		

Burimi: ERRU

* UK Rajonale Kukës ka aplikuar dy herë gjatë vitit 2023.

Tabela 2. Situata e Licencimit të Shoqërive UK për Vitin 2023 sipas Reformës

Nr.	Ndarja e Shoqërive Rajonale	Shoqëritë UK Ekzistuese	Statuti i shoqërisë	Mbarimi i afatit të licencimit	Licencimi i Shoqërive UK ekzistuese/rajonale
1	Sh. R UK Shkodër	Shkodër	Riorganizuar	26.12.2027	Me licencë
		Fushë Arrëz			
		Pukë			
		Vau i Dejës			
		Malësia e Madhe			
2	Sh. R UK Kukës	Kukës	Riorganizuar	29.01.2027	Me licencë
		Tropojë			
		Has			
3	Sh. R UK Lezhë	Lezhë	Riorganizuar	01.12.2026	Me licencë
		Mirditë			
		Kurbin			
4	Sh. R UK Dibër	Dibër	Riorganizuar	22.06.2027	Me licencë
		Mat			
		Bulqizë			
		Klos			
5	Sh. R UK Durrës	Durrës	Riorganizuar	21.02.2027	Me licencë
		Krujë			
		Kavajë			
		Rrogozhinë			
6	Sh. R UK Fier	Fier	Riorganizuar	02.03.2025	Me licencë
		Patos			
		Roskovec			
		Mallakastër			
7	Sh. R UK Lushnje	Lushnje	Riorganizuar	02.03.2027	Me licencë
		Divjakë			
8	Sh. R UK Elbasan	Elbasan	Riorganizuar	27.04.2027	Me licencë
		Cërrik			
		Belsh			
		Librazhd			
		Gramsh			
		Peqin			
9	Sh. R UK Sarandë	Sarandë	Riorganizuar	27.04.2027	Me licencë
		Finiq			
		Konispol			
		Delvinë			
10	Sh. R UK Berat	Berat - Kuçovë	Riorganizuar	02.03.2027	Me licencë
		Ura Vajgurore			
		Poliçan			
		Skrapar			
11	Sh. R UK Korçë	Korçë	Riorganizuar	01.12.2024	Me licencë
		Devoll			
		Maliq			
		Kolonjë			
		Pustec			
12	Sh. R UK Pogradec	Pogradec	Riorganizuar	27.04.2027	Me licencë
		Prrenjas			
13	Sh. R UK Gjirokastrë	Gjirokastrë	Riorganizuar	21.02.2027	Me licencë
		Tepelenë			
		Këlcyrë			
		Përmet			
		Libohovë			
		Dropull			
Memaliaj					
14	Sh. R UK Vlorë	Vlorë	Pa riorganizuar	01.06.2026	Me licencë
		Selenicë		08.07.2025	Me licencë
		Himarë*		19.09.2023	Pa licencë
15	Sh. R UK Tiranë	Tiranë	Pa riorganizuar	21.02.2027	Me licencë
		Kamëz		27.02.2026	Me licencë
		Vorë		10.11.2024	Me licencë

Burimi: ERRU

* Shoqërisë UK Himarë i ka përfunduar afati i licencës, por nuk ka aplikuar për rinovim sepse është në proces riorganizimi në shoqërinë Rajonale UK Vlorë.

Aneks 2 - Tarifet për Shërbimin e FU dhe Largimit të UN - Viti 2023

Nr.	Emri i shoqërisë rajonale	Data e hyrjes në fuqi të vendimit	2023								
			Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm			Shërbimi i largimit të ujrave të ndotur			Tarifë fikse		
			Tarifë variabël			Tarifa variabël					
			Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat	Familjar	Buxhetor	Privat
1	Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a										
	Njësia Korçë **	01.01.2018	72/38/28	117/110	140/100	42	64	64	140	140	140
	Njësia Devoll	01.01.2012	38	100	110				50	50	50
	Njësia Maliq **	01.03.2018	45/22.5	100	105				54/50 */27	54/50 *	54/50 *
	Njësia Pustec										
	Njësia Kolonjë	01.04.2015	38	100	110	10	13	18	100	100	100
2	Shoqëria Rajonale UK Pogradec sh.a										
	Njësia Pogradec **	01.10.2020	60/30	111/100	111/100	30/15	40/30	40/30	200/100	300/100	300/100
	Njësia Prrrenjas	01.12.2018	42	100	100	15	25	26	100	100	100
3	Shoqëria Rajonale UK Durrës sh.a										
	Njësia Durrës	01.09.2017	70	120	130	50	60	60	150	150	150
	Njësia Kavajë	01.07.2010	38	80	100	15	20	20			
	Njësia Shijak										
	Njësia Krujë	01.12.2019	35	80	100	8	12	12	100	200	200
	Njësia Rrogozhinë	01.01.2013	48	90	100	10	12	12	50	100	100
4	Shoqëria Rajonale UK Lezhë sh.a										
	Njësia Lezhë	01.01.2014	58	135	145	18	22	27	200	200	200
	Njësia Mirditë	01.01.2012	30	100	115	10	15	15			
	Rubik	01.10.2008	30	70	100	7	10	15			
	Njësia Kurbini	01.01.2011	30	80	120				50	50	50
5	Shoqëria Rajonale UK Dibër sh.a										
	Njësia Dibër	01.01.2010	27	65	85						
	Njësia Bulqizë **	01.10.2022	25	75/55	83.3	10	17	17	100	100	100
	Njësia Mat	01.01.2006	23	60	80	2	4	6			
	Njësia Klos										
6	Shoqëria Rajonale UK Kukës sh.a										
	Njësia Kukës	01.10.2022	30	80	100	10	20	30	50	100	100
	Njësia Tropojë **	01.08.2019	30/40	80	80	13	22	22	100	100	100
	Njësia Has										
7	Shoqëria Rajonale UK Elbasan sh.a										
	Njësia Elbasan	01.01.2023	40	130	130	9	30	30	200	400	400
	Njësia Librazhd **	01.12.2018	42/26	100/60	100	15	25	26	100	100	100
	Njësia Gramsh	01.06.2018	32	90	90				60	150	180
	Njësia Cërriq										
	Njësia Belsh										
	Njësia Peqin	01.12.2020	48	120	120	12	16	16	100	200	200
8	Shoqëria Rajonale UK Fier sh.a										
	Njësia Fier	01.01.2021	52	105	125	13	18	20	200	200	200
	Njësia Patos	01.04.2021	70	135	135	20	20	20	200	200	200
	Njësia Mallakastër	01.02.2022	50	100	120	10	10	10	100	200	200
	Njësia Roskovec	01.02.2020	52	105	125	15	20	20	100/50*	100/50*	100/50*
9	Shoqëria Rajonale UK Gjirokastrë sh.a										
	Njësia Gjirokastrë **	01.04.2019	46/25	133/60	138/60	11	18	18	100/80*	100	100
	Njësia Tepelenë	01.01.2014	33	100	120	12	20	20	90	400	250
	Njësia Këlcyrë										
	Njësia Përmet	01.01.2013	40	110	120				100	100	200
	Njësia Libohovë										
	Njësia Dropull										
	Njësia Memaliaj										
10	Shoqëria Rajonale UK Lushnjë sh.a										
	Njësia Lushnjë **	01.10.2019	62	110/130	110/130	17	21	24	100	100/200	100/200
	Njësia Divjakë										
11	Shoqëria Rajonale UK Berat sh.a										
	Njësia Berat **	01.11.2019	50/40	130	130	14	24	24	100	200	200
	Njësia Kuçovë	01.11.2019	50	130	130	14	24	24	100	200	200
	Njësia Dimal	10.01.2007	40	90	100						
	Njësia Skrapar	01.06.2018	35	100	110	10	10	10	100	100	100
	Njësia Poliçan	01.04.2019	50	100	110	12	15	15	100	100	100
12	Shoqëria Rajonale UK Sarandë sh.a										
	Njësia Sarandë	01.07.2021	60	140	140	25	45	45	200	200	200
	Njësia Finiq										
	Njësia Konispol **	01.10.2022	50/66.7	83.3	83.3						
	Njësia Delvinë	01.05.2019	58	120	120	18	35	35	167	200	200
13	Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a										
	Njësia Shkodër	01.01.2012	40	110	110	15	20	20	100	100	100
	Njësia Fushë Arrëz										
	Njësia Pukë	01.01.2014	35	130	140	8	16	16	100	100	100
	Njësia Vau Dejës	01.12.2018	42	120	120	7	20	20	83	167	167
	Njësia Malësi e Madhe	01.03.2018 01.08.2019	50	120	120	12	15	15	167	167	167
14	Shoqëria Rajonale UK Tiranë sh.a										
	Njësia Tiranë	01.01.2018	65	140	155	11	30	35	200	200	200
	Njësia Kamëz										
	Njësia Vorë	01.02.2020	65	140	155	15	30	35	200	200	200
15	Shoqëria Rajonale UK Vlorë sh.a										
	Njësia Vlorë	01.12.2019	45	100	100	15	25	25	100	150	150
	Njësia Selenicë	01.07.2010	30	80	100						
	Njësia Himarë	01.12.2019	55	100	100	30	50	50	200	200	300

Burimi: ERRU

- Shoqëritë që nuk kanë tarifa të miratuara nga ERRU
- * Tarifa fikse të ndara për ujë dhe kanalizime
- ** Tarifa të ndryshme për qytetin dhe zonën rurale

Aneks 3 - Subvencionet e Shoqërive UK, Vitet 2022-2023 (në lekë)

Burimi: AKUM

Nr.	Emri i shoqërisë rajonale	Subvencionet 2022						Subvencionet 2023				
		Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore të papaguara	Tatim Taksa të papaguara	Paga të papaguara	Energji Elektrike	Performancë	Totali 2022	Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore të papaguara	Tatim Taksa të papaguara	Paga të papaguara	Energji Elektrike	Totali 2023
1	SHRUK Korçë	-	-	-	-	30,000,000	0,000,000	-	-	-	-	-
	Njësia Korçë	-	-	-	-	30,000,000	30,000,000	-	-	-	-	-
	Njësia Devoll	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Maliq	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Pustec	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Njësia Kolonjë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	SHRUK Pogradec	-	-	-	-	30,000,000	30,000,000	-	-	-	-	-
	Njësia Pogradec	-	-	-	-	30,000,000	30,000,000	-	-	-	-	-
	Njësia Prrenjas	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	SHRUK Durrës	30,000,000	-	-	-	-	30,000,000	-	-	-	104,604,254	104,604,254
3	Njësia Durrës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Kavajë	17,814,942	-	-	-	-	17,814,942	-	-	-	-	-
	Njësia Shijak	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Krujë	7,296,842	-	-	-	-	7,296,842	-	-	-	-	-
	Njësia Rrogozhinë	4,888,216	-	-	-	-	4,888,216	-	-	-	-	-
4	SHRUK Lezhë	30,000,000	-	-	-	-	30,000,000	-	-	-	47,992,330	47,992,330
	Njësia Lezhë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Mirditë	10,000,000	-	-	-	-	10,000,000	-	-	-	-	-
	Njësia Kurbid	20,000,000	-	-	-	-	20,000,000	-	-	-	-	-
	SHRUK Dibër	798,766	23,649,324	2,386,071	3,165,839	-	30,000,000	-	-	-	-	-
5	Njësia Dibër	798,765	11,539,242	2,386,071	-	-	14,724,078	-	-	-	-	-
	Njësia Bulqizë	-	219,160	-	2,816,059	-	3,035,219	-	-	-	-	-
	Njësia Mat	1	11,890,922	-	349,780	-	12,240,703	-	-	-	-	-
	Njësia Klos	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	SHRUK Kukës	15,222,610	14,777,390	-	-	-	30,000,000	-	-	-	-	-
6	Njësia Kukës	8,062,299	6,961,498	-	-	-	15,023,797	-	-	-	-	-
	Njësia Tropojë	-	6,961,498	-	-	-	6,961,498	-	-	-	-	-
	Njësia Has	7,160,311	854,394	-	-	-	8,014,705	-	-	-	-	-
	SHRUK Elbasan	985,024	7,770,268	8,353,797	12,890,911	-	30,000,000	-	-	-	68,489,900	68,489,900
	Njësia Elbasan	-	-	-	12,890,911	-	12,890,911	-	-	-	-	-
7	Njësia Librazhd	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Gramsh	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Cërrik	985,024	-	2,853,038	-	-	3,838,062	-	-	-	-	-
	Njësia Belsht	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Peqin	-	7,770,268	5,500,759	-	-	13,271,027	-	-	-	-	-
8	SHRUK Fier	30,000,000	-	-	-	-	30,000,000	-	-	-	28,913,516	28,913,516
	Njësia Fier	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Patos	30,000,000	-	-	-	-	30,000,000	-	-	-	-	-
	Njësia Mallakastër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Roskovec	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
9	SHRUK Gjirokastrë	3,467,269	347,312	2,794,751	23,390,668	-	30,000,000	-	-	-	-	-
	Njësia Gjirokastrë	-	-	-	3,341,524	-	3,341,524	-	-	-	-	-
	Njësia Tepelenë	-	112,403	-	3,341,524	-	3,453,927	-	-	-	-	-
	Njësia Këlcyrë	1,869,761	23,220	-	3,341,524	-	5,234,505	-	-	-	-	-
	Njësia Përmet	439,672	179,596	-	3,341,524	-	3,960,792	-	-	-	-	-
10	Njësia Libohovë	912,880	6,600	2,700,159	3,341,524	-	6,961,163	-	-	-	-	-
	Njësia Dropull	-	-	-	3,341,524	-	3,341,524	-	-	-	-	-
	Njësia Memaliaj	244,956	25,493	94,592	3,341,524	-	3,706,565	-	-	-	-	-
	SHRUK Lushnjë	12,672,823	2,270,941	-	15,056,236	-	30,000,000	-	-	-	-	-
	Njësia Lushnjë	-	-	-	15,056,236	-	15,056,236	-	-	-	-	-
11	Njësia Divjakë	12,672,823	2,270,941	-	-	-	14,943,764	-	-	-	-	-
	SHRUK Berat	16,759,847	-	3,800,000	9,440,153	-	30,000,000	-	-	-	-	-
	Njësia Berat	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Kuçovë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Dimal	-	-	3,800,000	1,145,337	-	4,945,337	-	-	-	-	-
12	Njësia Skrapar	9,811,672	-	-	-	-	9,811,672	-	-	-	-	-
	Njësia Polçan	6,948,175	-	-	8,294,816	-	15,242,991	-	-	-	-	-
	SHRUK Sarandë	-	-	-	30,000,000	-	30,000,000	-	-	-	-	-
	Njësia Sarandë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Finiq	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
13	Njësia Konispol	-	-	-	12,913,778	-	12,913,778	-	-	-	-	-
	Njësia Delvinë	-	-	-	17,086,222	-	17,086,222	-	-	-	-	-
	SHRUK Shkodër	-	-	-	-	-	-	9,277,839	-	-	20,722,161	30,000,000
	Njësia Shkodër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Fushë Arrëz	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
14	Njësia Pukë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Vau Dejës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Malësi e Madhe	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	SHRUK Tiranë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Tiranë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
15	Njësia Kamëz	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Vlorë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	SHRUK Vlorë	-	-	-	-	-	-	5,010,204	170,684	14,091,049	10,728,063	30,000,000
	Njësia Vlorë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Njësia Selenicë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Njësia Himarë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
Totali		139,906,339	48,815,235	17,334,619	93,943,807	60,000,000	360,000,000	14,288,043	170,684	14,091,049	281,450,224	310,000,000
Shpërndarja në % sipas qëllimit		38.9%	13.6%	4.8%	26.1%	16.7%	100.0%	4.6%	0.1%	4.5%	90.8%	100%

Aneks 4 - Treguesit e Performancës së Shoqërive UK, Viti 2023

Nr.	Emri i shoqërisë	Mbulimi i Kostos Totale	Mbulimi i Kostos Direkte O&M	Niveli i Matjes	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	Norma e Arkëtimit Korrente	Efiçenca e stafit U+K	Humbjet, Uji Pa të Ardhura	Mbulimi me Kanalizime	Mbulimi me Ujësjellës	Furnizimi me Ujë orë/ditë	Efiçenca Energjisë FU Kw/m ³	Ankesat e klientëve
1	Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a	77.50%	126.70%	96.20%	99.30%	82.60%	2.98	35.90%	58.60%	95.80%	24.00	0.63	0.01%
2	Shoqëria Rajonale UK Pogradec sh.a	54.80%	101.60%	94.00%	94.00%	82.60%	5.13	34.90%	49.30%	87.10%	23.00	0.47	0.03%
3	Shoqëria Rajonale UK Durrës sh.a	71.80%	85.80%	91.80%	106.00%	79.70%	5.25	72.40%	51.70%	83.00%	13.00	1.21	0.02%
4	Shoqëria Rajonale UK Lezhë sh.a	48.30%	87.70%	74.40%	108.20%	89.50%	5.45	70.80%	45.60%	54.30%	18.00	0.83	0.04%
5	Shoqëria Rajonale UK Dibër sh.a	87.30%	96.10%	59.20%	96.90%	87.00%	9.54	36.40%	22.50%	54.20%	13.00	0.02	0.07%
6	Shoqëria Rajonale UK Kukës sh.a	50.00%	83.40%	58.20%	110.60%	54.50%	8.86	51.10%	25.30%	53.60%	13.00	0.08	0.02%
7	Shoqëria Rajonale UK Elbasan sh.a	51.20%	68.90%	89.00%	108.10%	67.50%	6.97	69.30%	41.60%	63.90%	18.00	0.70	0.01%
8	Shoqëria Rajonale UK Fier sh.a	72.10%	85.60%	80.60%	98.90%	74.40%	6.34	65.70%	39.00%	63.90%	16.00	1.02	0.07%
9	Shoqëria Rajonale UK Gjirokastrë sh.a	62.40%	87.80%	70.50%	102.90%	67.40%	6.83	49.30%	30.00%	87.90%	18.00	0.21	0.04%
10	Shoqëria Rajonale UK Lushnje sh.a	58.60%	98.30%	99.60%	100.20%	72.70%	5.34	57.40%	24.30%	62.60%	16.00	0.81	0.03%
11	Shoqëria Rajonale UK Berat sh.a	106.20%	107.00%	90.60%	110.40%	90.40%	5.26	46.70%	48.90%	68.20%	22.00	0.45	0.06%
12	Shoqëria Rajonale UK Sarandë sh.a	92.60%	130.90%	93.40%	84.80%	46.40%	5.71	70.60%	46.40%	83.60%	19.00	0.67	0.02%
13	Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a	47.90%	75.00%	73.20%	89.90%	69.70%	6.19	66.70%	32.30%	53.00%	22.00	0.76	0.08%
14	UK Tiranë	123.70%	153.40%	90.90%	105.60%	97.40%	2.63	59.97%	93.00%	97.30%	17.00	0.21	0.01%
15	UK Kamëz	68.50%	93.10%	85.10%	89.90%	76.70%	4.79	71.50%	78.60%	71.90%	4.00	0.00	0.01%
16	UK Vorë	61.30%	61.60%	79.90%	100.30%	72.90%	11.74	68.00%	54.00%	69.60%	8.00	0.00	0.22%
17	UK Vlorë	46.40%	64.90%	71.20%	92.80%	65.50%	3.77	79.40%	72.40%	86.10%	13.00	0.77	0.08%
18	UK Selenicë	88.80%	90.20%	28.10%	63.00%	59.50%	8.10	63.10%	39.00%	74.60%	7.00	0.75	0.04%
19	UK Himarë	106.20%	131.70%	94.20%	68.00%	55.00%	6.19	47.90%	20.00%	92.60%	18.00	0.86	0.01%
Totali		79%	104%	86%	102%	83%	4.6	64%	55%	76.2%	16.6	0.5	3.1%

Burimi ERRU

Të dhënat e publikuara janë operative pasi ato përfundimtare të certifikuara jepen në Raportin e Performancës së Sektorit UK për vitin 2023 që publikohet nga ERRU në muajin Qershor të vitit pasardhës, pas miratimit të bilanceve financiare nga ekspertët kontabël

Aneks 5 - Mbledhjet dhe Vendimet e KKRR - Viti 2023

Prot.	Nr.	Data e mbledhjes	Vendime
14/1	1	17.01.2023	Vendim për detajimin e planit të shpenzimeve operative të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2023.
13/1	2	17.01.2023	Vendim për miratimin e Programit Vjetor të Shërbimeve jashtë vendit të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2023.
41/1	3	30.1.2023	Vendim për licencimin e Shoqërisë Rajonale UK Kukës.
56/2	4	08.02.2023	Vendim për miratimin e Raportit Vjetor të aktivitetit të ERRU-së për vitin 2022.
106	5	22.02.2023	Vendim mbi aplikimin për licencimin për efekt të përfundimit të afatit për Shoqërinë UK Tiranë.
107	6	22.02.2023	Vendim mbi aplikimin për licencimin për efekt të përfundimit të afatit për Shoqërinë Rajonale UK Durrës.
108	7	22.02.2023	Vendim mbi aplikimin për licencimin për efekt të përfundimit të afatit për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë.
109	8	22.02.2023	Vendim mbi një shtesë në pikën 3 të vendimit nr. 420, dt 29.02.22 për licencat dhe tarifën e shërbimit të operatorëve UK deri në përfundimin e procedurave të riorganizimit dhe transferimit të shoqërive UK në subjekte me kompetenca të përbashkëta.
75/1	9	22.02.2023	Vendim për Z. K.Sh për përfundimin e periudhës së provës.
143	10	03.03.2023	Vendim mbi aplikimin për licencimin për herë të parë të shoqërisë rajonale UK Fier.
141	11	03.03.2023	Vendim mbi aplikimin për licencimin për herë të parë të shoqërisë rajonale UK Berat.
142	12	03.03.2023	Vendim mbi aplikimin për licencimin për herë të parë të shoqërisë rajonale UK Lushnje.
140	13	03.03.2023	Vendim mbi aplikimin për licencimin për herë të parë të shoqërisë UK Shkodër për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor.
14/2	14	31.03.2023	Vendim mbi një ndryshim në vendimin e KKRR-së nr. 1 datë 17.01.2023 për detajimin e planit të shpenzimeve operative të Erru-së për vitin 2023.
203	15	31.03.2023	Vendim mbi organizimin e një feste për daljen në pension të Z. Th.Gj.
204	16	28.04.2023	Vendim për licencimin e shoqërisë Rajonale UK Elbasan.
205	17	28.04.2023	Vendim për licencimin e shoqërisë Rajonale UK Sarandë.
206	18	28.04.2023	Vendim për licencimin e shoqërisë Rajonale UK Pogradec.
207	19	28.04.2023	Vendim për një ndryshim në pikën 2/b të vendimit të KKRR-së nr. 160 datë 30.12.2020 për licencimin e shoqërisë UK Malësi e Madhe për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik.
148/2	20	28.04.2023	Vendim mbi miratimin e dorëheqjes për Znj E.K.
190/2	21	28.04.2023	Vendim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës Z. T.K.
14/3	22	28.04.2023	Vendim për një ndryshim në planin e shpenzimeve operative të Erru-së për vitin 2023.
217	23	15.05.2023	Vendim mbi largimin nga Administrata e Erru-së për Znj. K.R.
242/1	24	23.06.2023	Vendim për licencimin e Shoqërisë Rajonale UK Dibër.
245	25	23.06.2023	Vendim mbi miratimin e raportit të performancës të Shoqërive UK për vitin 2022.
236/3	26	23.06.2023	Vendim për një ndryshim në detajimin e planit të shpenzimeve operative për vitin 2023.
240/1	27	23.06.2023	Vendim për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave.
246	28	23.06.2023	Vendim për shtyrje afati të aplikimit nga shoqëritë UK për tarifa të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura për vitin 2023.
260	29	04.07.2023	Vendim për ngritje në detyrë Znj. F.B dhe vijimi i marrëdhënieve të punës për Znj M.K për një periudhë 6 mujore.
286	30	28.07.2023	Vendim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës për Znj A.I specialist i analizës ekonomike financiare, sektori i tarifave.
289	31	28.07.2023	Vendim për shpallje vendi vakant specialist i analizës teknike -ekonomike.
325	32	13.09.2023	Vendim për një ndryshim në vendimin e KKRR-së nr. 28, datë 23.06 për shtyrje afati të aplikimit të shoqërive për tarifa për vitin 2023.
324	33	13.09.2023	Vendim për caktimin e Zëvendës Kryetarit Z. Namik Simixhiu.
323	34	13.09.2023	Vendim për dhënien e ndihmës në rast fatkeqësie për Znj. M.K.
322	35	13.09.2023	Vendim për shpallje fituese për Znj E.T në pozicionin Specialist i analizës ekonomiko financiare.
326	36	13.09.2023	Vendim mbi miratimin e Projektplanit të shpenzimeve operative të Erru-së për vitin 2024.
320/1	37	13.09.2023	Vendim për shpallje vendi vakant për plotësimin e organikës në pozicionin specialist Arkiv Protokoll.
354	38	05.10.2023	Vendim për një ndryshim në përqindjen e pagesës rregulatore.
353	39	05.10.2023	Vendim për një ndryshim në buxhet.
352	40	05.10.2023	Vendim për emërimin në detyrë Z. E.S në pozicionin Protokoll Arkiv.
358	41	05.10.2023	Vendim për refuzimin e aplikimit për ndryshim të nivelit tarifor të Shoqërisë Rajonale UK Qarku Shkodër.
359	42	05.10.2023	Vendim për refuzimin e aplikimit për ndryshim të nivelit tarifor të Shoqërisë Rajonale UK Elbasan.
360	43	05.10.2023	Vendim për refuzimin e aplikimit për ndryshim të nivelit tarifor të shoqërisë Rajonale UK Berat.
367	44	23.10.2023	Korrigjim vendimi mbi plan buxhetin e vitit 2024.
393	45	10.11.2023	Vendim për një ndryshim në vendimin e komisionit për licencimin e Shoqërisë UK Vlorë për ndryshim të drejtuesit ligjor.
394	46	10.11.2023	Vendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të nivelit tarifor për shoqërinë UK Vlorë.
395	47	10.11.2023	Vendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të nivelit tarifor për shoqërinë Rajonale UK Durrës.
396	48	10.11.2023	Vendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të nivelit tarifor për shoqërinë Rajonale UK Fier.

RAPORTI VJETOR ERRU 2023

399	49	10.11. 2023	Vendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të nivelit tarifor për shoqërinë Rajonale UK Lezhë.
397	50	10.11. 2023	Vendim mbi ndryshimin e pozicionit të vendit të punës për Znj H.I
398	51	10.11. 2023	Vendim për ngritje në detyrë Znj Nevila Saliu nga specialiste e analizës së aseteve në përgjegjëse sektori ekonomik dhe tarifave pranë Drejtorisë Tekniko Ekonomike.
421	52	1.12.2023	Vendim për shpërblimin vjetor të Kryetarit të ERRU-së.
422	53	11.12.2023	Vendim për emërimin në detyrë për Znj. A.K specialist në sektorin ekonomik dhe tarifave pranë Drejtorisë Tekniko Ekonomike.
433	54	11.12.2023	Projekt vendim për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe Largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për shoqërinë UK Vlorë.
434	55	11.12. 2023	Vendim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës Z. I.V
457	56	27.12. 2023	Vendim mbi aplikimin për licencim për herë të parë të Shoqërisë Rajonale UK Shkodër.
458	57	27.12. 2023	Vendim mbi aplikimin për rinovim licence të Shoqërisë Rajonale UK Kukës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor.
459	58	27.12. 2023	Vendim për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe Largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për shoqërinë UK Vlorë.
278	59	17.12. 2023	Vendim për një ndryshim në planin e shpenzimeve operative të Erru-se për vitin 2023.
460	60	27.12. 2023	Vendim për vijimin e marrëdhënieve të punës Znj. E.T
461	61	27.12. 2023	Vendim për vijimin e marrëdhënieve të punës Z. E.S
Total 61 VENDIME KKRR			

Aneks 6 - Referencat Ligjore të Aktivitetit të ERRU-së

- Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102);
- Ligji nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” (ligji nr. 120/2016);
- Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar (ligji nr. 9902);
- Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121);
- Ligji nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë (Kodi i Procedurës Administrative);
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Kodi i Punës);
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (ligji Nr. 10296);
- Ligji nr. 9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” i ndryshuar. (ligji nr. 9584);
- Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” (ligji nr. 8480).
- VKM nr. 958, datë 6.5.2009 "Për Miratimin e Kategorive të Licencimit dhe Procedurave të Aplikimit për Licencë të Operatorëve që Ushtrjnë Veprimtarinë në Sistemet e Furnizimit me Ujë, të Largimit dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotura".
- Rregullore e Licencimit "Për Procedurat e Dhënies dhe Rinovimit të Licencave Profesionale për Subjektet Juridike e Fizike që Ushtrjnë Veprimtari në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura", miratuar me Vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009, e ndryshuar.
- Vendimi i KKRR nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”.
- VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.
- Vendimi i KKRR nr. 420, datë, 29.09.2022 “Për licencat dhe tarifat e shërbimit të operatorëve UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit dhe transferimit të shoqërive UK në subjekte me kompetenca të përbashkëta”.
- Vendim i KKRR nr. 484, datë 14.10.2022 “Për disa ndryshime në rregulloren “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”.